

Annual
REPORT
2024



**TIRANA
BANK**

përmbajtja

LETËR NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV	4
PROFILI I GRUPIT	6
QEVERISJA E KORPORATËS DHE KOMITETET E TIRANA BANK	8
TREGUESIT KRYESORË TË TIRANA BANK	13
Shërbimet bankare për klientët individë Divizioni i banking-ut të korporatave	
PERFORMANCA E LINJAVE TË BIZNESIT	18
MENAXHIMI I RISKUT	28
RRUGËTIMI DIGJITAL I TIRANA BANK	41
PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS	45
BURIMET NJERËZORE	51
Struktura organizative	
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE	61



Leter Nga

Z. DRITAN MUSTAFA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

**Të nderuar Klientë,
Të nderuar Partnerë dhe Bashkëpunëtorë,
Të nderuar Kolegë të Bankës,**

Viti 2024 ishte një vit i jashtëzakonshëm për Tirana Bank, përgjatë të cilit arritëm rezultate rekord dhe forcuar më tej pozicionin tonë si një ndër institucionet financiare më dinamike dhe me rritje të vazhdueshme në tregun shqiptar. Performanca jonë financiare dhe operacionale ishte dëshmi e qartë e strategjisë për rritje të qëndrueshme, të udhëhequr nga angazhimi ynë për të përmbushur në mënyrë cilësore nevojat e klientëve dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit.

Totali i Aseteve të Bankës arriti në vlerën **1.63 miliardë Euro**, me një **rritje vjetore prej 30%**.

Portofoli i Kredisë u zgjerua me 41%, rritja më e lartë në sistemin bankar në vitin 2024, duke arritur vlerën 800 milionë Euro.

Këto arritje nuk përfaqësojnë vetëm suksesin tonë si institucion financiar, por edhe ndikimin tonë real në financimin e ekonomisë lokale përmes mbështetjes ndaj sektorëve dinamikë si tregtia, përpunimi dhe manifaktura, infrastruktura, energjia e rinovueshme, turizmi dhe agrobiznesi, sikurse edhe në financimin e individëve për investime dhe konsum.

Besimi i klientëve tanë u reflektua në rritjen me 22% të depozitave, me një vlerë mbi 1.2 miliardë Euro në fund të vitit 2024, një motiv shtesë për të vijuar me

përkushtim ofrimin e shërbimeve me standarde të larta dhe ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me klientët tanë.

Viti 2024 ishte i rëndësishëm për Tirana Bank edhe në kuadër të transformimit digjital. Me prezantimin e platformës TiStart, ne mundësuam hapjen e llogarive të reja për klientët individë në mënyrë plotësisht online duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të përvojës së klientit dhe një standard të ri në tregun bankar shqiptar. Përmes digjitalizimit të proceseve të brendshme dhe produkteve të reja, konfirmojmë vijueshmërinë e transformimit të Bankës si një institucion financiar që synon infrastrukturë moderne dhe digjitale.

Strategjia e zhvillimit të Tirana Bank mbetet në përputhje me vizionin e Grupit Balfin, duke u mbështetur në katër shtylla kryesore: rritjen e qëndrueshme, zgjerimin në tregje të reja, transformimin digjital dhe fuqizimin e kapaciteteve njerëzore. Këto prioritete kanë udhëhequr vendimmarrjen, duke reflektuar anagazhimin tonë për të ndërtuar një model biznesi modern, efikas dhe të qëndrueshëm.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë për gjithë stafin e Tirana Bank për përkushtimin, profesionalizmin dhe pasionin e treguar gjatë këtij viti. Një falenderim i veçantë shkon për klientët tanë, për besimin dhe bashkëpunimin e pandërprerë dhe për partnerët tanë që na mbështesin në çdo hap të zhvillimit.

Me respekt,
Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Tirana Bank

PROFILI I GRUPIT

Grupi BALFIN është një nga grupet e investimit më të suksesshëm në Ballkanin Perëndimor. I themeluar në vitin 1993, në Vjenë, nga Samir Mane, Grupi është sot i pranishëm në Austri, Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Zvicër, Mal të Zi, Holandë, Kanada dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Grupi ka një portofol të diversifikuar investimesh që përfshin sektorin bankar, zhvillimin e pasurive të paluajtshme, tregtinë me shumicë dhe pakicë, menaxhimin e aseteve, turizmin, energjinë, logjistikën, edukimin dhe sektorin e argëtimit.

Grupi BALFIN ka rreth 5,500 punonjës, përkushtimi dhe pasioni i të cilëve mbeten faktori kyç i historisë së suksesit në më shumë se tri dekada.

Grupi BALFIN është një partner i besueshëm, që kryen aktivitete biznesi në një gamë të gjerë industrish në nivel ndërkombëtar, zbaton standardet më të larta të biznesit dhe etikës, gëzon një kapital të qëndrueshëm financiar, me burime njerëzore të jashtëzakonshme, dhe ka në fokus të veçantë inovacionin.

Që prej vitit 2023, nismat sociale të Grupit janë grupuar dhe konsoliduar brenda Fondacionit Mane, duke kontribuar akoma më mirë dhe më shumë në fuqizimin e komuniteteve.





QEVERISJA E KORPORATËS

Tirana Bank zbaton një Sistem Qeverisje të Korporatës me synimin për të siguruar organizimin, funksionimin dhe menaxhimin efektiv të shoqërisë dhe veçanërisht për të mbrojtur interesat e palëve të interesit. Sistemi i Qeverisjes së Korporatës të Tirana Bank zbaton të gjitha aktet legjislative dhe rregullatore që rregullojnë funksionimin e saj. Konkretisht Tirana Bank, në cilësinë e shoqërisë aksionare, zbaton dispozitat e Ligjit nr. 9901, dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Statutin e saj.

Statuti i Bankës përcakton, ndër të tjera, qëllimin e saj, aktivitetin që do të kryhet, organet e shoqërisë dhe funksionimin e tyre, përgjegjësitë e anëtarëve të Këshillit Drejtues si dhe përcakton rregulloret që do ta udhëheqin.

Tirana Bank, si një institucion bankar, i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë, zbaton dispozitat e Ligjit nr. 9662, dt. 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Rregulloren nr. 63/2012 të Bankës së Shqipërisë “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, e ndryshuar, si dhe Rregulloren nr. 67/2015 të Bankës së Shqipërisë “Për sistemin e kontrollit të brendshëm”, e ndryshuar, në lidhje me parimet e funksionimit të institucioneve bankare dhe kriteret për vlerësimin e Sistemit të tyre të Kontrollit të Brendshëm.

Gjithashtu, Tirana Bank ka krijuar dhe zbaton Rregulloren e Funksionimit të Brendshëm (“Rregullorja”), e cila përbën një dokument të brendshëm të Bankës. Rregullorja përfshin rregullat që rrjedhin si rezultat i kuadrit ligjor të aplikueshëm në nivel institucional. Rregullorja i referohet në detaje fushës së kompetencës dhe përgjegjësisë dhe funksionimit të organeve kyçe të Bankës.

Organet drejtuese dhe mbikëqyrëse të Bankës, si dhe sistemet e Kontrollit të Brendshëm, Administrimit të Rrezikut dhe Përputhshmërisë ekzistojnë dhe funksionojnë në përputhje me kuadrin e lartpërmendur legjislativ dhe rregullator të Qeverisjes së Korporatës, të zbatuar nëpërmjet:

- Statutit;
- Rregullore të Funksionimit të Brendshëm;
- Politikës së Emërimit të Këshillit Drejtues;
- Termave të Referencës të Këshillit Drejtues;
- Kartës së Veprimtarisë të Komitetit të Rrezikut
- Kartës së Komitetit të Kontrollit.

A. ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE

Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të Tirana Bank është organi më i lartë i shoqërisë dhe është përgjegjëse, ndër të tjera, për zgjedhjen e anëtarëve

të Këshillit Drejtues dhe audituesve të jashtëm dhe për miratimin e Pasqyrave Financiare vjetore. Përgjegjësitë e Asamblesë së Përgjithshme janë ato të parashikuara nga dispozitat legjislativë në fuqi dhe nga Statuti i Bankës.

B. KËSHILLI DREJTUES

Këshilli Drejtues është organi vendimarrës dhe mbikëqyrës i Bankës. Këshilli Drejtues është përgjegjës për të vendosur mbi çdo çështje që ka të bëjë me administrimin e Bankës, menaxhimin e aktiveve të saj dhe ndjekjen, në përgjithësi, të qëllimeve të saj.

Këshilli Drejtues nuk ka të drejtë të vendosë për çështje të cilat, sipas ligjit nr. 9901/14.4.2008 ose Statutit, janë në kompetencë të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve.

Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen të paktën një herë në 3 (tre) muaj.

Gjatë vitit 2024, Këshilli Drejtues ka zhvilluar 7 takime nga të cilat 4 janë takime periodike dhe 3 takime me agjendë të limituar.

Në kontekstin e rolit, përgjegjësive dhe kapacitetit të tij për të ofruar udhëheqje, mbikëqyrje dhe qeverisje, Këshilli Drejtues, gjatë mbledhjeve të tij, ka trajtuar rregullisht çështjet e mëposhtme:

- Vendosja dhe miratimi i strategjisë dhe objektivave strategjike të Bankës, duke siguruar që qëllimi, strategjia dhe vlerat e Bankës janë në përputhje me kulturën dhe standardet e Grupit.
- Mbikëqyrja e ndryshimeve në shkallë të gjerë dhe programeve të transformimit dhe i ka kushtuar

vëmendje të veçantë iniciativave që lidhen me përmirësimin e proceseve dhe dixhitalizimin.

- Monitorimin e performancës së Bankës duke u siguruar mbi manaxhimin e kujdesshëm të operacioneve të saj, në përputhje me strategjinë, tolerancën ndaj riskut, planet e biznesit dhe buxhetin.
- Miratimin e kuadrit të tolerancës ndaj rrezikut dhe deklaratës së oreksit për rrezikun.
- Miratimin e planeve financiare të Bankës, duke përfshirë planet e biznesit dhe buxhetin vjetor.
- Analizën e zhvillimeve makro-ekonomike në vend.
- Analizën e rezultateve financiare dhe operacionale të aktivitetit të Bankës.
- Shqyrtimin dhe miratimin e pasqyrave financiare të certifikuar dhe raportit vjetor nën rekomandimin e Komitetit të Kontrollit.
- Monitorimin e profilit të rrezikut dhe strategjive përkatëse, p.sh. Ecurinë e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe skenarët mbi pritshmëritë, analizën e rrezikut të kredisë, tregut, likuiditetit dhe analizat e rrezikut operacional, duke përfshirë rezultatet e testeve të shok-ut, si dhe zhvillimet dhe masat lidhur me strategjinë e rekuperimit të kredive me probleme.
- Kanë marrë raporte të rregullta mbi profilin e rrezikut të Bankës nga Komiteti i Manaxhimit të Rrezikut.
- Rishikimin e aktivitetit të Komitetit të Kontrollit.
- Rishikimin dhe miratimin e Strategjisë dhe Planeve të Kapitalit të Bankës, vlerësimit të brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit si dhe Planeve të Rimëkëmbjes së saj.
- Rishikimin dhe miratimin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Likuiditetit të Bankës dhe deklaratës përkatëse.
- Rishikimin dhe miratimin e qeverisjes korporative

- të Bankës dhe duke u siguruar për zbatimin e saj.
- Mbikëqyr Politikën e Konfliktit të Interesit të Këshillit Drejtues dhe siguron zbatimin e saj.
- Vlerësimin vjetor të performancës dhe efektivitetit të tij.
- Delegimin e menaxhimit dhe drejtimit të përditshëm të Bankës te Drejtorit Ekzekutiv në përputhje me politikat e miratuara.
- Sfidoi, udhëhoqi dhe mbështeti Drejtimin e Bankës për të nxitur krijimin e vlerës së qëndrueshme për klientët, punonjësit dhe aksionarët.
- Promovimin e kulturës së grupit, etikën, qëllimin, vlerat dhe mentalitetin.
- Garantoi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret.
- Siguroi mbikëqyrje përmes Komitetit të Kontrollit të efektivitetit të kuadrit të Kontrollit të Brendshëm dhe Financiar.
- Gjithashtu, Këshilli Drejtues ka ratifikuar vazhdimisht limitet e kredive mbi autoritetet aprovuese të Drejtimit të Bankës si dhe ka aprovuar marrëveshjet e pagesave dhe pastrimin e bilancit nga kredite me probleme.

Aktiviteti i Këshillit Drejtues ka kontribuar gjithashtu në përmirësimin e vazhdueshëm të kuadrit të qeverisjes korporative, si dhe të kuadrit të brendshëm rregullator, nëpërmjet shqyrtimit të operacioneve të komiteteve të ndryshme dhe miratimit të politikave të reja/të rishikuara në fusha të ndryshme të aktivitetit të bankës.

Në përputhje me Nenin 32 të Statutit të saj, siç është në fuqi sot, Banka drejtohet nga një Këshill Drejtues i përbërë nga një numër tek anëtarësh prej jo më pak se pesë (5) dhe jo më shumë se nëntë (9) anëtarësh, numër ky i cili do të përcaktohet me Vendim të Asamblesë së Aksionarëve.

Në bazë të ligjit nr. 9662/18.12.2006, shumica e anëtarëve të Këshillit duhet të jenë të pavarur në kuptimin e Nenit 44, paragrafi 2, të ligjit të lartpërmendur. Gjithashtu, Ligji nr. 9662/18.12.2006 parashikon, ndër të tjera, sa vijon mbi përbërjen e Këshillit Drejtues të Bankës:

- Anëtarët e Komitetit të Kontrollit mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues;
- Një anëtar i Këshillit duhet të jetë Kryetar i Komitetit të Kontrollit;
- Anëtarët e Drejtorisë mund të jenë anëtarë të Këshillit Drejtues por numri i tyre nuk duhet të përbëjë shumicën e numrit të anëtarëve të Këshillit;
- Kryetari dhe zëvendëskryetari i Këshillit Drejtues nuk mund të jenë njëkohësisht edhe anëtarë të Drejtorisë.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Bankës është katër (4) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje për periudha pasuese.

Vihet re se Këshilli Drejtues ka miratuar një Politikë për Emërimin e Anëtarëve të Këshillit Drejtues. Kjo politikë bazohet në detyrimet rregullatore të Bankës dhe përfshin sa më poshtë:

- dispozitat e Ligjit nr. 9662/18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe
- dispozitat e Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 63, datë 14.11.2012 “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, e ndryshuar.

Politika përshkruan parimet e përgjithshme, procedurën dhe kriteret e emërimit të anëtarëve të Këshillit, të cilat përfshijnë, ndër të tjera, sa vijon:

- kriteret e përshtatshmërisë dhe reputacionit të duhur,

- kriteret e shmangies së konfliktit të interesit,
- kriteret e disponueshmërisë dhe përkushtimit për t'i dhënë kohë të mjaftueshme kryerjes së funksioneve të Këshillit Drejtues,
- kriteret në lidhje me përvojën financiare brenda sektorit bankar, angazhimin për zbatimin e praktikave më të mira bankare duke u kujdesur në veçanti për administrimin e rrezikut, përputhshmërisë dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, njohuri të mjaftueshme të mjedisit rregullator dhe të biznesit në të cilin operon Banka si dhe
- kriteret në lidhje me pavarësinë, karakterin dhe personalitetin e kandidatit për anëtar.

Gjithashtu, sipas kuadrit rregullator, çdo anëtar i Këshillit i nënshtrohet një miratimi paraprak të përshtatshmërisë nga Banka e Shqipërisë.

Këshilli Drejtues i Bankës përbëhet nga anëtarë me ekspertizë dhe njohuri drejtuese ndërkombëtare.

Gjithashtu, anëtarët e Këshillit zotërojnë njohuri dhe përvojë të thellë të tregut bankar si dhe kontribuojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e kuadrit të qeverisjes së korporatës.

Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh “diversitetin” e anëtarëve të Këshillit Drejtues, kryesisht në aspektin e aftësive, formimit arsimor dhe eksperiencës profesionale, si dhe origjinës së ndryshme të secilit anëtar, sigurohet shprehja e pikëpamjeve të ndryshme gjatë funksionimit të Këshillit Drejtues, me dialog konstruktiv dhe shmangie të “të menduarit në grup”.

Në çdo rast, Banka njihet dhe përqafton rëndësinë dhe përfitimet nga “diversiteti” për ruajtjen dhe përmirësimin

e konkurrueshmërisë dhe zhvillimit të saj, si dhe për arritjen e efikasitetit dhe efektivitetit maksimal të Këshillit. Në këtë kontekst, gjatë emërimit të anëtarëve të rinj të Këshillit ose të drejtorëve ekzekutivë, merret parasysh një kombinim i elementeve, duke përfshirë ndër të tjera: aftësitë, zotësitë, kualifikimet, njohuritë, përvojën, formimin arsimor dhe eksperiencën profesionale, gjininë, moshën dhe cilësi të tjera, të cilat mund të ndryshojnë në varësi të nevojave të biznesit ose strategjisë së Bankës.

Vihet re se Këshilli Drejtues ka miratuar Termat e Referencës të Këshillit Drejtues që përcaktojnë organizimin dhe procedurat e funksionimit të Këshillit dhe specifikojnë të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të tij. Këto Terma Reference janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9662/18.12.2006, Rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 63/14.11.2012, Ligjin nr. 9901/14.04.2008, Statutin si dhe Rregulloren e Funksionimit të Brendshëm të Tirana Bank.

Këshilli Drejtues ka krijuar si organ këshillues mbi rrezikun Komitetin e Rrezikut, i cili e mbështet ndër të tjera në vendimmarrjen mbi strategjinë, oreksin e rrezikut, sistemin e menaxhimit të rrezikut dhe mbikqyrjen e rrezikut. Komiteti i Rrezikut përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të Këshillit Drejtues, nga të cilët të paktën njëri është i specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Komiteti i Rrezikut mbledhet të paktën 4 (katër) herë në vit.

KËSHILLI DREJTUES



DRITAN Mustafa
Anëtar/CEO

PERIKLIS DROUGKAS
Zëvendëskryetar/Anëtar i
Pavarur

**HUBERT DE SAINT
JEAN**
Kryetar/Anëtar i Pavarur

ERNST WELTEKE
Anëtar i Pavarur

STEVEN GRUNERUD
Anëtar

KOMITETI I KONTROLLIT

PERIKLIS DROUGKAS	Kryetar
STEVEN GRUNERUD	Anëtar
DANIELA HOXHA (MALAJ)*	Anëtare

* Znj. Hoxha është larguar nga Komiteti i Kontrollit më datë 21.03.2024 dhe është zëvendësuar nga z. Hubert DE SAINT JEAN.

KOMITETI I EKZEKUTIV

DRITAN MUSTAFA	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
OLIVIER BAUR	Nëndrejtor i Përgjithshëm
ELVIRA KAPOLI	Drejtuese Financiare
ERALDA TAFAJ	Drejtuese e Operacioneve
LILA CANAJ	Drejtuese e Retail
MANJOLA CAPO	Drejtuese e Riskut të Kredisë
GLENDA KURTI	Drejtuese e Divizionit të Biznesit Korporatë
ELONA GJIPALI	Drejtuese e Divizionit të Rekuperimit Bankar
BRISILDA BALA	Drejtuese e Menaxhimit të Riskut

TREGUESIT KRYESORË TË TIRANA BANK

Sasitë në million lekë

TIRANA BANK	Dhjetor 2024	Dhjetor 2023
TOTALI I AKTIVEVE	159,739	130,437
KREDITË NETO	75,566	56,368
DEPOZITAT	123,380	107,079
FITIMI NETO PAS TATIMIT	2,869	1,941
KTHIMI NGA AKTIVET (ROA)	2.0%	1.6%
KTHIMI NGA KAPITALI (ROE)	19.6%	17.2%
RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT (CAR)	17.3%	17.7%
NPL	3.1%	4.2%
RAPORTI KREDI/DEPOZITA	63.4%	54.7%
RAPORTI KOSTO/TË ARDHURA	40.8%	42.3%
NUMRI I DEGËVE	33	32
NUMRI I PUNONJËSVE	564	508
NUMRI I KLIENTËVE	154,339	138,958

• Treguesit kryesor të paraqitur për vitet e mbyllura më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023, janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR), të nxjerra nga Bordi i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).


Viti 2024 ishte një vit historik për Tirana Bank, me rezultate financiare rekord që shënuan një nga periudhat më të suksesshme në historinë gati 30-vjeçare të Bankës. Banka shënoi rritje të ndjeshme në të gjithë treguesit kryesorë financiarë dhe operacionalë, duke forcuar pozicionin e saj si një nga institucionet financiare më të qëndrueshme dhe të besueshme në Shqipëri. Fokusi ynë i vazhdueshëm në planifikimin strategjik, menaxhimin e kujdesshëm financiar dhe zgjidhjet digjitale të klientëve ka rezultuar në rritje të jashtëzakonshme të volumeve të biznesit si edhe të përfitueshmërisë.

Të ardhurat e Bankës sonë gjatë vitit janë rritur me 31%, duke arritur në nivelin 8,809 milionë lekë (2023: 36%), të nxitura kryesisht nga rritja e të ardhurave nga interesat, komisionet dhe këmbimet valutore. Viti 2024 tregon një përmirësim të ndjeshëm në marzhet e përfitueshmërisë së Bankës, duke reflektuar rritjen e treguesve të biznesit dhe kostot e optimizuara të financimit.

Si rezultat, ne e rritëm fitimin neto me +48% nga viti në vit në rreth 2,9 miliardë lekë (2023: 2 miliardë lekë). Kjo arritje nxjerr në pah forcën dhe qëndrueshmërinë e modelit tonë të biznesit, si dhe angazhimin dhe ekspertizën e ekipit tonë të përkushtuar dhe të vlefshëm.

Duke përjashtuar ndikimin e rivlerësimit nga kursi i këmbimit, Banka ka realizuar një fitim neto prej mbi 29 milionë euro dhe ROA e ROE pozitive në 2024 me përkatësisht 1.9% dhe 19% (2023 me 1.9% dhe 20.4%), më të larta se buxheti, për shkak të përfitueshmërisë së lartë, edhe pse gjatë vitit ka patur një rritje të ndjeshme të totalit të kapitalit neto dhe aktiveve.

Fitimi pas taksave (në milionë Lekë)



Të ardhurat neto nga interesat janë më të larta krahasuar me vitin e kaluar me 17% (851 milionë lekë) (2023: 38.5%). Rritja e ndjeshme e të ardhurave nga interesi vjen kryesisht nga rritja e të ardhurave të portofolit të kredisë (26%) dhe rritja e të ardhurave nga letrat me vlerë të investimeve (20%). Shpenzimet e interesit gjatë vitit 2024 janë më të larta se vitin e kaluar me 58% (2023: 140%), kryesisht për shkak të rritjes së financimit të klientëve dhe terrenit me norma të rritura të interesit.

Të ardhurat nga komisionet për vitin 2024 janë më të larta se e njëjta periudhë e vitit të kaluar me rreth 153 milionë lekë ose 23%. Në përgjithësi, të gjitha llojet e komisioneve janë më të larta krahasuar me vitin e kaluar duke përfshirë komisionet e kartave, tarifave dhe disbursimit, transfertat e parave dhe tarifave të arkëtimit, duke mbetur mbi shifrat e buxhetuara.

Viti 2024, tregon në përgjithësi, përmirësim të marzheve të përfitueshmërisë së Bankës, duke reflektuar rritjen e treguesve të biznesit dhe kostot e optimizuara të

financimit. Shpenzimet operative shfaqin prirje rritëse gjatë viteve të fundit, duke reflektuar tendencat inflacioniste dhe në përputhje me strategjinë e rritjes dhe zgjerimit të Bankës. Raporti kosto/të ardhura është përmirësuar gjithashtu në 40.8% në 2024, (nga 42.3% në 2023).


Banka mbetet e mirëkapitalizuar, në rreth 17.3% në dhjetor 2024 (dhjetor 2023: 17.7%). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit në dhjetor 2024 vlerësohet të jetë rreth 18.7% duke përfshirë kapitalizimin e të gjithë fitimit të vitit 2024.



Më 31 dhjetor 2024, totali i aktiveve të Bankës arriti në rreth 159,738 milionë lekë duke paraqitur një rritje prej rreth 29,302 milionë lekësh (2023: 130,437 milionë lekë) ose rreth 22%, krahasuar me fundvitin 2023. Rritja është nxitur kryesisht nga financimi i klientëve dhe rritja e detyrimeve ndaj bankave për qëllime të administrimit të likuiditetit dhe është vendosur kryesisht në portofolin e kredisë dhe letrat me vlerë të investimeve.

Totali i aktiveve ka arritur një total prej përafërsisht.

1.6 miliardë euro, duke rritur gjithashtu pjesën tonë të tregut për vitet e fundit radhazi dhe duke përfaqësuar një nga rritjet më të mëdha në sistemin bankar shqiptar për këtë vit. Kjo rritje e jashtëzakonshme është një dëshmi e besimit të qëndrueshëm dhe besimit që klientët tanë dhe palët e interesuara kanë dhënë tek ne.



Përpjekjet tona strategjike për diversifikimin e portofolit të kredisë dhe menaxhimin efektiv të normave të interesit rezultuan në një rritje të konsiderueshme të këtij portofoli. Ne përjetuam një rritje të portofolit neto të kredisë me 34% (19,198 milionë lekë), krahasuar me fundin e vitit 2023, duke arritur në rreth 75,566 milionë lekë në fund të muajit dhjetor 2024 dhe duke treguar aftësinë tonë për të gjetur mundësitë e tregut duke ruajtur një marzh interesi të shëndetshëm.

Rritja bruto e huasë për vitin 2024 ka ardhur nga rritja e kredisë për individët 31.5% (5.7 miliardë lekë), rritje e korporatave 45.5% (13.5 miliardë lekë), rritje e SME-ve

me rreth 33% (2,4 miliardë lekë) dhe rritje e biznesit të vogël me 1.3 miliardë lekë.

Banka ka përmirësuar raportin e huave të saj jo-performuese (NPL-ve) gjatë viteve të fundit, duke arritur në nivelin 3.1% në dhjetor 2024 (dhjetor 2023: 4.2%) dhe po ndërton një portofol të performancës, nga pikëpamja cilësore, në përputhje me kushtet mbizotëruese të tregut. Përqëndrimi ynë në praktikat rigoroze të menaxhimit të rrezikut dhe standardet e repta të nënshkrimit na shtynë të arrijmë këtë raport mbresëlënës të ulët të kredive me probleme, i cili mbetet ndër më të ulët në treg. Kjo tregon përkushtimin tonë për të menaxhuar me kujdes rrezikun e kredisë dhe siguron stabilitetin afatgjatë të operacioneve tona.



Financimi i klientëve paraqet një rritje prej 16,301 milionë lekësh gjatë vitit 2024 ose 15% (2023: 9,417 milionë lekë ose 9.6%), duke arritur në nivelin e 123,380 milionë lekëve, duke theksuar besimin e klientëve dhe duke siguruar më shumë fonde për aktivitetet investuese. Banka ka arritur të rrisë burimin kryesor të financimit, me kosto të

optimizuara financimi gjatë viteve të fundit. Ky sukses është një dëshmi e besimit të klientëve dhe imazhit të fortë të bankës në treg dhe i atribuohet gamës sonë gjithëpërfshirëse të produkteve të depozitave, normave dhe ofertave konkurruese të interesit dhe shërbimit të personalizuar ndaj klientit të ofruar nga stafi ynë.

Përveç sa më sipër, fokusi i bankës vijon të jetë edhe depërtimi digjital dhe platforma digjitale e pasuruar për të përmirësuar funksionalitetet dhe performancën si dhe rritjen e transaksioneve përmes kanaleve alternative (transaksionet me Tibank u rritën në 68% nga 55% në vitin 2023). Gjatë vitit, banka vazhdoi investimet në transformimin digjital për të përmirësuar eksperiencën e klientëve dhe efikasitetin operativ. Një arritje kryesore ishte prezantimi i platformës **TiStart**, që lejon hapjen e llogarive bankare online pa qenë nevoja për prezencë fizike në degë. Gjithashtu, Tirana Bank solli në treg **Mastercard World Elite**, një produkt i nivelit të lartë që ofron përfitime ekskluzive për klientët premium.

Strategjia e Bankës sonë flet për rritje në vitet në vijim, duke forcuar praninë tonë në treg, duke zgjeruar gamën tonë të produkteve dhe shërbimeve, si dhe duke përqafuar teknologji inovative për t'u siguruar që përmbushim dhe tejkalojmë nevojat në zhvillim të klientëve tanë.

Performanca e jashtëzakonshme financiare e Tirana Bank në vitin 2024 është rezultat i një strategjie të zhvillimit të qëndrueshëm, inovacionit të vazhdueshëm dhe fokusit të pandërprerë tek klienti. Këto arritje tregojnë rolin e rëndësishëm që banka luan në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe ambicien për të vijuar rritjen në vitet që vijnë.

PERFORMANCA E LINJAVE TË BIZNESIT

A. SHËRBIMET BANKARE PËR KLIENTËT INDIVIDË

Tirana Bank, për të 28-in vit radhazi, vijon me sukses të jetë pranë klientëve të saj me përkushtim maksimal, duke përmirësuar cilësinë e shërbimit me synimin për të forcuar një marrëdhënie të frytshme dhe afatgjatë. Vëmendje kryesore gjatë këtij viti, përpos aktiviteteve qëndrore si rritja e bazës së klientelës dhe klientëve aktivë, rritja e koeficientit të shitjeve të kryqëzuara dhe rritja e kënaqësisë së klientit (duke ofruar një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare me procese të optimizuara), u tregua edhe tek risitë dhe inovacioni.

Me një përkushtim të palëkundur ndaj inovacionit, kemi investuar në teknologji moderne për të ofruar një përvojë të shkëlqyer bankare përmes kanaleve tona digjitale. Aplikacioni ynë i bankikut digjital, TiBank, është përmirësuar me funksionalitete të reja për të plotësuar nevojat e klientëve tanë në çdo moment dhe kudo.

Gjithashtu, kemi nisur projekte të reja që synojnë një përfshirje më të madhe të komunitetit, duke mbështetur iniciativa dhe duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social. Programi ynë i besnikërisë, Happy, është zgjeruar për të ofruar më shumë përfitime dhe shpërblime për klientët tanë të besuar.

Bankingu Digjital është në qendër të përpjekjeve për të sjellë të ardhmen më pranë, duke ofruar shërbime të lehta dhe të shpejta që përmirësojnë përvojën bankare. Projektet e reja përfshijnë zgjidhje inovative që integrojnë teknologjinë më të fundit për të siguruar një përfshirje më të madhe dhe një qasje më të thjeshtë ndaj financave. Me përkushtimin ndaj përmirësimit të vazhdueshëm, synohet krijimi i një mjedisi bankar më të sigurt dhe më të përshtatshëm për të gjithë.

PERFORMANCA E KREDITIMIT PËR KLIENTIN INDIVID GJATË VITIT 2024

Gjatë vitit 2024, aktiviteti i kreditimit në segmentin e Klientit Individ ka reflektuar një rritje të qëndrueshme dhe të strukturuar, duke tejkaluar objektivin vjetor me 108%, ku rëndësi të veçantë mori kredidhënia në produktet konsumatore. Kështu, në linjë me startegjinë tonë drejt transformimit digjital, ne prezantuar sistemin më të ri në origjinimin e kredive konsumatore në tremujorin e dytë të vitit 2024, ku tashmë proceset janë të automatizuara duke filluar nga procesimi i të dhënave, scorecard, vlerësimi i gjendjes financiare të klientit, integrimet në kohë reale me rregjistrin e kredive në BSH, vendimarrje dhe disbursim automatik në llogarinë e klientit.

Ky zhvillim inovator, mundësoi rezultate qenësisht më të mëdha si në volumet e portofolit, kërkesën për kredi të re ashtu edhe në eksperiencën e klientit, konkretisht në 2024 shënuam rritje prej 533% në nivel disbursimesh krahasuar me një vit më parë si dhe rritje prej 231% në rastet e aprovuara krahasuar me fundin e vitit 2023.


Në një vit sfidues për tregun financiar, Tirana Bank ka vijuar të konsolidojë pozicionin e saj si një nga institucionet më aktive në kreditimin e Individëve.

Me një fokus të vazhdueshëm në analizimin e detajuar të profileve të klientëve dhe ruajtjen e cilësisë së portofolit të kredisë, banka ka implementuar strategji të qarta për të lehtësuar aksesin në financim dhe për të përmirësuar përvojën e klientit.

Tendencat Kryesore dhe Dinamika e Tregut

Në përputhje me prirjet e tregut bankar, rritja e kreditimit është përqendruar kryesisht në monedhën vendase, Lek, e cila përfaqëson 72.1% të totalit të portofolit të kredive Retail. Ky orientim ka për qëllim minimizimin e ekspozimit ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të klientëve.

PORTOFOLI PERFORMUES I KREDISË RETAIL 2024



STRUKTURA E PORTOFOLIT TË KREDISË RETAIL 2024



Objektivat Kryesore për Kreditimin e Individëve në 2024:

- Rritja e portofolit të kredive performuese në segmentin e klientëve Individë, duke ruajtur një ekuilibër të shëndetshëm midis rritjes dhe menaxhimit të riskut.

- Monitorimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i portofolit joperformues, me synimin për kufizimin dhe rikuperimin e këtyre kredive, duke punuar aktivisht për kthimin e tyre në kredi me performancë të mirë.
- Thellimi i penetrimit në bazën ekzistuese të klientëve, duke rritur shitjet e kryqëzuara dhe ofruar produkte të personalizuar për pagamarrësit dhe klientët standard.
- Vijimi i orientimit drejt kreditimit në monedhën vendase, për të minimizuar ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit dhe për të garantuar një portofol më të qëndrueshëm.

Përmes këtyre objektivave dhe një strategjie të qartë për përmirësimin e shërbimeve financiare, Tirana Bank do të vijojë të mbështesë rritjen e qëndrueshme dhe të ofrojë zgjidhje të përshtatura për klientët e saj.

PERFORMANCA DHE RITJJA E DEPOZITAVE PËR KLIENTIN INDIVID NË 2024

Ruajtja dhe rritja e ndjeshme e vëllimeve të depozitave në të gjitha monedhat vijon të mbetet një nga objektivat kryesore të Divizionit Retail edhe përgjatë vitit 2024. Gjatë këtij viti, Tirana Bank ka realizuar një rritje të portofolit të depozitave duke tejkaluar targetin me 109%. Kjo ecuri pozitive ka mbështetur strategjinë e bankës për një rritje të qëndrueshme, duke siguruar një nivel të lartë likuiditeti dhe një bazë të fortë financiare për operacionet e saj.

Strategjitë Kryesore dhe Nxitja e Kursimeve

Një faktor kyç në arritjen e objektivave për vitin 2024 ka qenë zhvillimi i suksesshëm i fushatave promovuese për produktet e depozitave me afat, dizajnimi i produkteve të reja, dhe komunikimi shumë aktiv i ofertave në të

gjithat kanalet promocionale. Këto iniciativa kanë pasuruar gamën e shërbimeve bankare të ofruara nga Tirana Bank, duke synuar rritjen e kënaqësisë së klientëve dhe nxitjen e një angazhimi më të madh në kursimet afatgjata.


Tërheqja e Klientëve të Rinj dhe Zgjerimi i Mundësive të Investimit

Fushatat dhe iniciativat e ndërmarra gjatë vitit 2024 kanë rezultuar të suksesshme pasi kanë tërhequr klientë të rinj në bankë, të cilët janë potencial për shitje të kryqëzuara si dhe kanë krijuar më shumë mundësi për klientët ekzistues, duke u ofruar atyre alternativa më të favorshme për investimin e kursimeve të tyre në Tirana Bank. Me një qasje të orientuar drejt klientit dhe një ofertë gjithnjë e më konkurruese, Tirana Bank ka forcuar më tej pozicionin e saj si një nga institucionet financiare më të besueshme dhe të qëndrueshme në treg, gjithashtu me rritjen, ndër më të larta krahasuar me tregun.

PORTOFOLI I DEPOZITAVE RETAIL 2024



STRUKTURA E PORTOFOLIT TË DEPOZITAVE RETAIL



PRODUKTET E KARTAVE TË DEBITIT DHE KREDITIT

Rritja e Përdorimit dhe Zgjerimi i Portofolit të Kartave

Gjatë vitit 2024, Tirana Bank ka pasur në fokus zgjerimin e portofolit të kartave dhe rritjen e përdorimit të tyre, duke ndërmarrë një sërë iniciativash dhe fushatash që kanë sjellë rezultate të dukshme në rritjen e transaksioneve dhe vëllimit të portofolit të kartave.

Këto strategji kanë përmirësuar përvojën e klientëve tanë dhe kanë nxitur adaptimin e pagesave elektronike në tregun shqiptar. Ky angazhim është reflektuar në rezultatet e arritura, ku numri i veprimeve me karta krediti është rritur me **40%**, ndërsa vëllimi i transaksioneve ka shënuar një **ritje prej 26%**. Duke marrë parasysh sfidat e tregut dhe adaptimin e ngadaltë të pagesave me karta, këto rezultate konfirmojnë një trend pozitiv në rritjen e përdorimit të kartave dhe të ardhurave nga ky produkt.

Lancimi i Mastercard World Elite – Karta më Elitare në Treg

Një moment historik i rëndësishëm gjatë vitit 2024 ka qenë **lancimi i kartës së kreditit Mastercard World Elite**, një produkt ekskluziv dhe elitare, i pari në llojin e tij në tregun shqiptar. Me këtë produkt premium, Tirana Bank ka vendosur një standard të ri në shërbimet financiare, duke u ofruar klientëve avantazhe dhe privilegje unike në nivel ndërkombëtar. Kjo kartë ka qenë një hap strategjik në drejtim të diversifikimit të ofertës sonë dhe forcimit të pozicionit të bankës si një lider në inovacionin e shërbimeve financiare.

Strategjitë e Marketingut dhe Ndikimi në Përdorimin e Kartave

Përmes fushatave të ndryshme të marketingut dhe partneriteteve strategjike, Tirana Bank ka nxitur

përdorimin e kartave në përditshmëri, duke ndikuar jo vetëm në rritjen e volumit të transaksioneve, por edhe në zgjerimin e bazës së përdoruesve. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i vazhdueshëm mbi përfitimet dhe lehtësitë e përdorimit të kartave ka luajtur një rol kyç në rritjen e përdorimit të tyre në терминаlet POS dhe në blerjet online.

Ky trend pozitiv ka ndikuar gjithashtu në reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi, duke ndihmuar në formalizimin dhe modernizimin e ekosistemit të pagesave në Shqipëri.

Strategjia për të Ardhmen

Sukseset e arritura gjatë vitit 2024 shërbejnë si një gur themeli për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve të kartave. Në vitin 2025, Tirana Bank do të vazhdojë të investojë në teknologji, të zgjerojë portofolin e produkteve të saj dhe të forcojë marrëdhëniet me klientët, duke qëndruar gjithmonë një hap përpara në përmbushjen e nevojave dhe pritshmërive të tyre.

RRJETI I POS-VE DHE ATM-VE, ZGJERIMI DHE PERFORMANCA NË 2024

Gjatë vitit 2024, Tirana Bank ka ndërmarrë një sërë iniciativash strategjike me një qasje proaktive për të zgjeruar rrjetin e kanaleve të shërbimit për pagesat me karta, si në rrjetin e ATM-ve ashtu edhe të POS-ve. Specifikisht për ATM-të, kjo strategji ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të pranisë së bankës në zona kyçe, rajonet bregdetare dhe destinacionet turistike, duke zgjeruar rrjetin e ATM-ve në një total prej 84 ATM dhe duke rritur numrin e tregtarëve që operojnë me terminale të bankës sonë në një total prej 336 POS. Falë monitorimit të vazhdueshëm të performancës së

kanaleve të pagesave dhe marrëdhënieve me tregtarët tanë, si dhe masave të ndërmarra për optimizimin e tyre, është arritur një rritje e konsiderueshme e aktivitetit në këtë segment. **Volumi i aktivitetit në POS është rritur me 80%, ndërsa volumi i veprimeve në ATM ka shënuar një rritje prej 25% krahasuar me vitin 2022.**

Veç sensibilizimit të kartëmbajtësve vendas, një rol të veçantë në rritjen e pagesave me kartë në ekonominë shqiptare ka patur edhe rritja e dukshme e numrit të turistëve në Shqipëri përgjatë dy viteve të fundit. Kërkesa e vazhdueshme e turistëve për të paguar me kartë për shërbimet e marra ka ndikuar pozitivisht në edukimin e bizneseve tona për të pranuar, pajisur dhe shërbyer klientët e tyre me këtë mjet pagese. Ky fenomen rrjedhimisht ka sjellë një rritje të shtuar të kërkesës për POS nga tregëtarë të ndryshëm, e veçanërisht nga biznese të cilët operojnë në industrinë e turizmit.

PLATFORMA DIGJITALE

Viti 2024 ka qenë një vit i jashtëzakonshëm për Produktet Digjitale, me fokus kryesor në digjitalizim. Fokus i ynë në përmirësimin e përvojës së klientit, funksionalitetet e përmirësuar dhe rritja e angazhimit të klientit kanë sjellë rezultate të shkëlqyera.

Arritjet Kryesore në 2024

- **Digital Onboarding:**
 - Më i Shpejtë, më i Lehtë dhe me Përvojë të Përmirësuar për Klientët.
 - Procesi i hapjes së llogarisë online duke reduktuar kohën dhe përmirësuar përvojën e klientit.
 - Përdorimi i këtij funksionalitet është rritur ndjeshëm,

duke çuar në një numër të konsiderueshëm klientësh të rinj digjitalë.

- **Funksionalitete të Reja**

- Zgjerimi i pagesave digjitale përfshirë pagesat e faturave dhe taksave vendore përmes platformës digjitale.
- Menaxhimi i përmirësuar i transaksioneve dhe funksionalitete të reja sigurie për të rritur besimin e klientëve.
- Histori transaksionesh për kartat e debitit në kohë reale.
- Eksperiençë e personalizuar për klientin.
- Zgjerimi i portofolit të produkteve, duke përfshirë karta të reja debiti dhe MasterCard World Elite në platformën digjitale.

Performanca dhe Progresi

Performanca e produkteve digjitale ka tejkalluar objektivat e vendosura, duke treguar rritje të ndjeshme në adaptimin digjital dhe angazhimin e klientëve:

- Klientët e rinj të platformën digjitale janë rritur duke tejkalluar objektivin 143%.
- Kryerja e transaksioneve në platformë krahasuar me degët fizike është rritur në 82%, një përmirësim që ka tejkalluar objektivin fillestar.
- Numri i klientëve që aksesojnë platformën çdo muaj ka tejkalluar objektivat duke arritur me një realizim 127%.
- Numri total i transaksioneve në platformë është gjithmonë e në rritje, duke treguar dhe kërkesën e lartë të klientëve për të përdorur produkte digjitale.

Viti 2024 ka qenë një vit transformimi dhe suksesi në rrugëtimin tonë digjital. Me adaptimin e fortë të shërbimeve digjitale, funksionalitete të reja dhe oferta

të përmirësuar, jemi në një pozitë të shkëlqyer për të vazhduar këtë rritje. Përkushtimi ynë ndaj inovacionit digjital do të na udhëheqë në drejtim të ekselencës edhe në vitet në vijim.

BANCASSURANCE

Tirana Bank e licensuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare, me vendim të Bordit nr. 76, datë 15.06.2020 ushtron tashmë prej disa vitesh veprimtarinë e ndërmjetësimit në Sigurime për klientët, në klasat e Jetës dhe Jo-Jetës.

Nëpërmjet stafit të bankës licencuar si broker fizik kryhet veprimtaria e brokerimit në sigurime, në emër dhe për llogari të Bankës së Tiranës, në mbrojtje të interesave të të siguarave nëpërmjet administrimit të kërkesës së klientit mbi produktet e sigurimit, të cilat i përkasin dhe ofrohen nga shoqëritë e sigurimit të cilat operojnë në vendin tonë.

Aktiviteti kontribuon në vijimësi në uljen e riskut për portofolin e kredive të siguruar dhe të pasiguar, mbrojtjen e klientëve nga dëme të shaktuara si pasojë e ngjarjeve të paparashikuara si edhe në rritjen e të ardhurave nga komisionet e ndërmjetësimit gjeneruar për segmentet përkatëse.

Aktiviteti i Brokerimit gjatë vitit 2024 ka qenë tepër dinamik dhe produktiv: rimbursim/dëmshpërblim 100% të rasteve të ngjarjeve/dëmeve të reklamuar, rritje të të ardhurave nga aktiviteti rreth 40% krahasuar me periudhat e mëparshme, lancimi i produkteve/paketave të sigurimit me qëllim plotësimin e nevojave/kërkesave të klientëve, rritjen e shitjeve dhe profitalitetit të aktivitetit në tërësi.

Gjatë vitit që lamë pas, banka jonë shënoi një arritje të rëndësishme në fushën e automatizimit duke implementuar me sukses robotin e parë për procesimin e pagesave të policave të sigurimit të lidhura me kreditë. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit dhe rritjes së efikasitetit operacional. Përfitimet kryesore përfshijnë reduktimin e kohës së procesimit, eliminimin e gabimeve manuale, sigurimin e përputhshmërisë me afatet kontraktuale dhe përmirësimin e përvojës së klientit.

B. DEPARTAMENTI I BIZNESIT TË VOGËL

Viti 2024 ka qenë një vit shumë i rëndësishëm për segmentin e Biznesit të Vogël, si në tejkalimin e rezultateve ashtu edhe me krijimin e Departamentit të Biznesit të Vogël me staf të dedikuar në çdo rajon.


Segmenti i Biznesit të Vogël, si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të mëtejshëm të Divizionit Retail në Tirana Bank, vijon me sukses për të 2-in vit radhazi të jetë pranë klientëve të biznesit duke përmirësuar vazhdimisht produktet dhe shërbimet e ofruara dhe në të njëjtën kohë duke siguruar cilësinë e shërbimit me synim forcimin e një marrëdhënie të frytshme dhe afatgjatë.

Vëmendja maksimale gjatë këtij viti, i është kushtuar rritjes së bazës së klientelës, rritjes së portofolit të kredisë, rritjes së koeficientit të shitjeve të kryqëzuara, duke i ofruar një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh bankare konkurruese. Strategjia e zhvillimit e prezantuar në mënyrë sistematike në takimet e drejtpërdrejta po ashtu edhe në rrjetet tona digjitale, ka vijuar të realizohet me sukses, duke


raportuar performancë shumë pozitive në të gjithë indikatorët kryesorë komercialë. Nëpërmjet kësaj përqaasje, Departamenti i Biznesit të Vogël rriti fokusin e shërbimit për këtë grup klientësh e cila do të ndikonte drejtpërdrejtë në rritjen dukshëm të të ardhurave të Bankës nga komisionet dhe interesat krahasuar me një vit më parë.

Procesi i kreditimit në veçanti gjatë vitit 2024, ka qenë tepër dinamik në aktivitetin e Kredihënies duke prezantuar paketën e plotë të shërbimit të mbështetjes financiare të personalizuar për segmentin e Biznesit të Vogël duke realizuar targetin vjetor në masën 143% në portofol kredie dhe 157% në nivel disbursimesh. Prezantimi i Komitetit të Biznesit ka qenë një risi e cila ka kontribuar denjësisht në arritjen e rezultateve duke ulur ndjeshëm kohën e aprovimit të kredive të vogla në volum total prej EUR 3 MLN dhe 150 klientë, si dhe njëkohësisht duke përmirësuar eksperiencën e klientit në Tirana Bank. Gjithashtu vlen të theksohet se ka patur një manaxhim shumë cilësor të portofolit në drejtim të pagesave, duke patur një NPL prej 0.3%, në vlera shumë më të ulëta sesa buxheti.

Ecuria e Disbursimeve (in EUR mln)



Ecuria e Portofolit të Kredisë (in EUR mln)



Në të njëjtën kohë në fokusin e segmentit ka qenë orientimi i klientëve drejt shërbimeve digjitale duke rritur ndjeshëm numrin e transaksioneve me Tibank dhe sidomos ruajtjen me fanatizëm të klientelës ekzistuese dhe në të njëjtën kohë shtimin e klientëve të rinj të Bankës.

Vlen për tu theksuar se i gjithë rezultati i dedikohet punës së Departamentit i cili u ndërtua gjatë vitit 2024 si dhe bashkëpunimit shumë të ngushtë me rrjetin e degëve, të cilët funksionojnë si pjesë komplementare e njëra tjetrës, duke dhënë maksimumin për arritjen e rezultateve.

PËRVOJA E KLIENTIT SI STRATEGJI DIFERENCIMI

Tirana Bank – Duke Dëgjuar, Vepruar dhe Inovuar për Klientë më të Kënaqur

Në Tirana Bank, viti 2024 ka shënuar një etapë të re dhe më dinamike në angazhimin tonë strategjik për përmirësimin dhe avancimin e përvojës së klientit. Në vijim të filozofisë së Grupit BALFIN, kemi vazhduar

të trajtojmë zërin e klientit jo vetëm si një përgjegjësi, por si një pjesë thelbësore e identitetit dhe kulturës sonë institucionale. Kemi investuar intensivisht në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit, duke theksuar veçanërisht rëndësinë e kuptimit të nevojave të klientëve dhe ofrimin e zgjidhjeve konkrete në kohë reale. Përvoja e klientit për ne mbetet një nga shtyllat strategjike më të rëndësishme, që na diferencon dhe na mban në linjë të vazhdueshme me pritshmëritë e klientëve dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

Matja dhe Dëgjimi i Zërit të Klientit

Një nga pikat kyçe të vitit 2024 ka qenë lançimi i platformës së re të feedback-ut, **Tironci**, e cila është platforma e parë gjithëpërfshirëse e këtij lloji në bankë. Kjo platformë inovative na ka mundësuar mbledhjen e reagimeve në kohë reale nga klientët në të gjithë rrjetin e degëve, duke na dhënë mundësinë të analizojmë menjëherë cilësinë e shërbimit dhe të ndërhyjmë aty ku është e nevojshme.

Gjithashtu, për të garantuar një matje objektive dhe gjithëpërfshirëse të standardeve të shërbimit, kemi realizuar cikle të vazhdueshme të **Mystery Shopping**, që na kanë ndihmuar të identifikojmë dhe të korrigjojmë devijimet nga standardet tona të cilësisë. Për të vlerësuar nivelin e kënaqësisë pas ndërveprimeve konkrete me bankën, kemi aplikuar edhe **Post Product Survey**, duke kontaktuar klientët pas shitjes dhe duke matur perceptimin e tyre mbi cilësinë dhe eficiencën e shërbimit të marrë.

Një pikë referimi e rëndësishme gjatë vitit ka qenë edhe kryerja e **Customer Satisfaction Survey**, anketës së madhe vjetore mbi kënaqësinë e klientëve, ku kemi matur detajisht nivelin e përgjithshëm të kënaqësisë,

duke identifikuar qartë pikat e forta si dhe ato që kërkojnë përmirësim.

Përmirësimi i Vazhdueshëm i Shërbimeve

Në vitin 2024, Tirana Bank ka transformuar dëgjimin e zërit të klientit në veprime konkrete për të përmirësuar përvojën e përgjithshme të klientëve në çdo nivel të ndërveprimit. Proceset operationale janë rishikuar dhe optimizuar vazhdimisht, duke u fokusuar në thjeshtësimin e dokumentacionit dhe reduktimin e kohës së pritjes në marrjen e shërbimeve.

Një nga risitë më domethënëse ka qenë implementimi i **platformës së digital onboarding**, që tani mundëson hapjen e një llogarie bankare brenda vetëm 7 minutash pa u paraqitur në degë, duke rritur ndjeshëm kënaqësinë e klientëve dhe duke lehtësuar aksesin në shërbimet tona. Një tjetër sukses i rëndësishëm është optimizimi i **procesit të kredive konsumatore (LOS)**, që tashmë mundëson aprovimin digjital të kredive brenda vetëm 20 minutash, një nga proceset më të shpejta dhe më efikase në tregun bankar shqiptar.

Këto ndryshime thelbësore janë realizuar falë një koordinimi të vazhdueshëm ndërdepartamental dhe përmes një komunikimi të fuqizuar të brendshëm, për të siguruar që çdo punonjës të jetë plotësisht i angazhuar dhe i informuar për rolin e tij në përmirësimin e përvojës së klientëve.

Krijimi dhe Fuqizimi i Kulturës së Shërbimit ndaj Klientit

Në kuadër të forcimit të kulturës organizative me fokus klientin, në 2024 kemi realizuar për herë të parë **Bootcamp-in e dedikuar për Përvojën e Klientit**, një aktivitet i veçantë me pjesëmarrjen e gjerë të stafit nga të gjitha departamentet. Ky aktivitet ka mundësuar

shkëmbimin e ideve inovative, identifikimin e proceseve që kanë nevojë për rishikim dhe ka forcuar më tej ndërgjegjësimin kolektiv për rëndësinë e përvojës së klientit në suksesin e bankës.

Paralelisht, kemi vazhduar të investojmë në formimin e stafit përmes trajnimeve intensive në teknikat e avancuara të shitjes dhe komunikimit efektiv, me qëllim standardizimin e përvojës së klientëve në çdo pikë kontakti dhe përmirësimin e aftësisë së stafit për të identifikuar dhe adresuar nevojat individuale të klientëve.

Segmentimi i Tregut dhe Njohja e Markës

Një tjetër fokus strategjik gjatë vitit 2024 ka qenë segmentimi i thelluar i tregut dhe forcimi i njohjes së markës sonë. Duke njohur më mirë klientët tanë, kemi mundur të personalizojmë më tej ofertën dhe komunikimin tonë, duke rritur ndjeshëm efektivitetin në përgjigjen ndaj nevojave të tyre specifike. Ky proces ka forcuar lidhjen e bankës me klientët tanë dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kënaqësisë dhe besnikërisë së tyre.

Një Vizion i Qartë për të Ardhmen

Për ne në Tirana Bank, përvoja e klientit nuk është një qëllim përfundimtar, por një rrugëtim i vazhdueshëm që evoluon dhe përmirësohet vazhdimisht. Viti 2024 ka dëshmuar se angazhimi ynë në këtë drejtim është serioz dhe i qëndrueshëm. Ne jemi krenarë për hapat e mëdhenj të bërë këtë vit dhe mbetemi të vendosur për të vijuar rrugëtimin tonë, duke e mbajtur klientin gjithmonë në qendër të çdo vendimi, dhe duke investuar vazhdimisht në cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve që ofrojmë. Për ne, çdo klient i kënaqur është një arritje, por edhe një nxitje për të vazhduar me pasion, përgjegjësi dhe përkushtim edhe më të madh

drejt një të ardhme më cilësore për çdo klient të Tirana Bank.

C. DIVIZIONI I BANKINGUT TË KORPORATAVE DHE SME

Përgjatë vitit 2024 sistemi Bankar pati një rol dominues në panoramën e përgjithshme Financiare në Shqipëri. Me gjithë presionet inflacioniste Sektori Bankar pati një rritje të qëndrueshme duke përmbyllur me sukses qëllimet e vendosura.

Përgjatë 2024 kërkesa për kredi ka qenë në nivele të larta nga bizneset në sektor të ndryshëm me qëllim përmbushjen e nevojave për likuiditet.

Shkurtimisht pikat kyçe të ecurisë së Sektorit Bankar përgjatë 2024 mund të përmbliidhen si më poshtë:

- Kërkesë rekord për kreditë e reja Korporative dhe SME duke qenë se bizneset kërkuan fonde për zgjerim dhe stabilitet operacional.
- Rritje e financimeve për sektorin SME, të cilët kanë qenë ndër huamarrësit më aktivë nisur dhe nga normatë qëndrueshme të interesit dhe pritshmëritë pozitive të zhvillimeve makroekonomike.
- Në tërësi u rrit kërkesa për kredi në monedhë të huaj e favorizuar dhe nga ecuria e kursit të këmbimit.

Këto tendenca pozitive përgjatë 2024 tregojnë për një mjedis të qëndrueshëm të kreditimit të Biznesit, ku Bankat luajnë një rol vendimtar në mbështetjen e rritjes së tij.


Tirana Bank gjatë 2024 arriti që të ketë një vit rekord sa i takon kreditimit të Bizneseve Korporatë dhe SME duke ju përgjigjur më së miri tendencës së tregut dhe madje duke e tejkaluar atë.

Projektet e ndryshme të ndërmarra nga Korporatat e mëdha bënë të mundur jo vetëm tejkalimin e objektivave por dhe diversifikim e pasurim të portofolit me larmishmëri produktesh duke rritur kështu prezencën e Bankës në Treg.


Ecuria e treguesve kryesor të kredisë së Divizionit të kredive Korporatë gjatë 2024:

- Në 2024 teprica e portofolit të kredive Korporative u rrit me 48% krahasuar me një vit më parë duke shënuar një rezultat rekord.
- Kjo rritje pasqyron vendimet strategjike në kredidhënie, përmirësimin e manaxhimit të risikut dhe rritjen e kërkesës për financim nga bizneset.
- Në 2024 u disbursuan me sukses 71% më shumë kredi të reja krahasuar me një vit më parë duke shënuar një rritje domethënëse në suportin financiar ndaj klientëve korporatë.


Disbursimet e reja klientë Korporate (Mln EUR) 2024



Teprica e kredisë klientë SME (Mln EUR) 2024



Disbursimet e reja dhe Stoku i kredisë SME (Mln EUR) 2024



Përmbledhje e pikave kryesore të ecurisë së aktivitetit të klientëve Korporatë dhe SME:

- Gjatë 2024 janë realizuar disbursime të reja EUR 192 Mln për klientët korporatë dhe EUR 40 Mln për klientët SME.
- Portofoli është rritur me ritme rekord duke shënuar EUR 422 Mln për portofolin korporatë dhe EUR 94 Mln për portofolin SME.
- Rritje e qëndrueshme e bazës së klientelës me fokus kryesor jo vetëm në klientët ekzistues por vjelja e klientëve të rinj.
- Diversifikim i Portofolit të kredisë duke u fokusuar përveç biznesit të përditshëm dhe në financimin e Projekteve, Financimin e kredisë së gjelbër (penele fotovoltaike), rritje e kredisë Leasing.
- Rritje e të gjithë treguesve kryesorë komercialë si: të ardhura nga Interesat dhe Komisionet, Tranferta Hyrëse dhe Dalëse, Këmbime valutore, numri i klientëve që kreditojnë pagën në Tirana Bank.
- Gjatë 2024 në linjë dhe me kërkesat e tregut Tirana Bank dhe divizioni i Korporatës dhe SME ka ndërmarrë nisma të ndryshme lidhur me digjitalizimin e shërbimit dhe produkteve të ofruara që mbetet një fokus thelbësor në përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit dhe efijensës në Tirana Bank.
- Mund të theksojmë projektet: Credit Lens (automatizim i procesit të kredidhënies), Business Credit Card, Business ATM Cash In etj

Prioriteti i Divizionit të Korporatës dhe SME mbetet ofrimi i një larmishmërie produktesh dhe shërbimesh me qëllim përmbushjen e të gjitha kërkesave të klientit në një kohë sa më të shkurtër dhe me kualitet maksimal.

MENAXHIMI I RISKUT

“Në Tirana Bank, angazhimi ynë për ekselencë shtrihet në menaxhimin efektiv të rreziqeve, duke garantuar sigurinë dhe stabilitetin e operacioneve tona. Misioni ynë në menaxhimin e rrezikut është të identifikojmë në mënyrë proaktive, të vlerësojmë dhe të lehtësojmë rreziqet e mundshme për të mbrojtur interesat e klientëve, aksionarit dhe punonjësve tanë. Nëpërmjet monitorimit, analizës dhe zbatimit të strategjive për lehtësimin e rrezikut, ne synojmë të ruajmë standardet

më të larta të integritetit dhe qëndrueshmërisë financiare. Fokusi ynë është nxitja e një kulture ndërgjegjëse për rrezikun, që fuqizon çdo anëtar të ekipit tonë për të kontribuar në qëndrueshmërinë e përgjithshme të Bankës. Duke përqafuar inovacionin, duke iu përmbajtur kërkesave rregullatore dhe duke i paraprirë rreziqeve në zhvillim, ne pozicionohemi si një institucion financiar i besuar, që performon në një treg financiar dinamik dhe në zhvillim.”

Monitorimi efektiv dhe administrimi i rreziqeve, kanë vijuar të mbajnë të njëjtën rëndësi me zhvillimin e biznesit, dhe Banka ka vijuar të jetë e fokusuar në ruajtjen e stabilitetit, shëndetit financiar dhe vijueshmërinë e operacioneve. Qëndrimi i Bankës ndaj administrimit të rrezikut, dokumentohet në Strategjinë e saj të Rrezikut dhe Kapitalit, e rishikuar mbi baza vjetore dhe e aprovuar nga Këshilli Drejtues. Përtej Strategjisë së Rrezikut dhe Kapitalit, kuadri i brendshëm i administrimit të rrezikut, i plotë dhe efektiv, i bazuar në kulturën e rrezikut në organizatë, përfshin komponentë të qeverisjes, politikave, procedurave dhe metodologjive që mbështeten në infrastrukturën e nevojshme.

Këshilli Drejtues është përgjegjës për të mbikëqyrur zhvillimin dhe implementimin e kuadrit të brendshëm të administrimit të rrezikut, çka gjithashtu, sigurohet edhe nëpërmjet një numri të specializuar komitetesh. Divizioni i Administrimit të Rrezikut, është administrativisht i pavarur nga njësitë e tjera të Bankës. Banka ka përcaktuar procese të detajuara dhe mekanizmat e duhur të kontrollit për të identifikuar, menaxhuar, monitoruar dhe raportuar rreziqet. Kjo siguron pavarësinë midis sipërmarrjes së rrezikut, menaxhimit të tij dhe funksioneve të kontrollit. Struktura aktuale organizative, siguron ndarjen e detyrave dhe synon të parandalojë situata të mundshme të konfliktit të interesit.

ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË TIRANA BANK, KONSISTON NË NJËSITË E MËPOSHTME TË ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT:

- Departmaneti i Administrimit të rrezikut të kredisë, raportimit, provigjonimit dhe përlllogaritjes së aseteve të ponderuara me rrezik;

- Departmaneti i Administrimit të rrezikut të tregut, likuiditetit dhe rrezikut operacional;
- Departmaneti i Sigurisë së Informacionit

PARIMET E ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT DHE KAPITALIT NË TIRANA BANK

- **Mjaftueshëria e Kapitalit:** Tirana Bank synon të ruajë bazë të kapitalit të mjaftueshme për të përthithur humbjet në kushte të zhvillimeve të pafavorshme ekonomike, duke siguruar vijueshmërinë e operacioneve dhe përmbushjen e detyrimeve. Kjo përfshin përcaktimin e limiteve të brendshme të synuara të kapitalit mbi limitet minimale rregullative me qëllim ruajtjen e fleksibilitetit dhe besueshmërisë.
- **Oreksi dhe Toleranca për Rrezik:** Tirana Bank përcakton nivele të pranueshme të rrezikut në synim të realizimit të objektivave të saj. Kjo përfshin përcaktimin e limiteve sasiore dhe udhëzimeve cilësore.
- **Qëndrueshmëria dhe Testet e Shok-ut:** Realizimi i testeve të shok-ut është pjesë integrale e strategjisë, që mundëson bankën të vlerësojë qëndrueshmërinë dhe aftësinë e saj për të përballuar situata të mundshme të shok-ut. Kjo ndihmon vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe përcaktimin e planeve rezervë të besueshme.

OBJEKTIVAT E FUNKSIONIT TË MANAXHIMIT TË RREZIKUT

Objektivat e funksionit të menaxhimit të rrezikut janë krijuar për të balancuar ndjekjen e përfitimit të bankës me nevojën për t'u mbrojtur nga rreziqet,

për të ruajtur pajtueshmërinë rregullatore dhe për të siguruar stabilitet financiar. Nëpërmjet identifikimit proaktiv, monitorimit dhe zbutjes së rreziqeve, funksioni i menaxhimit të rrezikut mbron kapitalin e bankës, nxit një kulturë të ndërgjegjshme për rrezikun dhe mbështet rritjen e qëndrueshme afatgjatë. Këto objektiva krijojnë bazë për qëndrueshmëri dhe aftësi për përshtatje, duke i mundësuar bankës të përballojë si sfidat aktuale ashtu edhe ato të pritshme në një peizazh financiar gjithnjë e më kompleks.

A. KUADRI I TOLERANCËS SË RREZIKUT

Banka shpreh oreksin e saj për rrezik nëpërmjet një Kuadri të Plotë të Oreksit për Rrezik (RAF), në linjë me praktikën më të mira, që konsiston në deklarata cilësore të oreksit për rrezik, si dhe tregues sasiorë që shprehin oreksin për rrezik, për të cilat, limitet dhe nivelet e paralajmërimit të hershëm, shërbejnë si mjete monitoruese, të përcaktuara nga Këshilli Drejtues, Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe Menaxhimi i Lartë i Bankës.

Kuadri i Oreksit për Rrezik, rishikohet mbi baza vjetore dhe sa herë që ka zhvillime të rëndësishme në mjedisin e brendshëm e të jashtëm, si dhe në kuadrin rregullativ. Ai aprovohet nga Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe përfundimisht nga Këshilli Drejtues, në vijim të aprovimit paraprak të Komitetit Ekzekutiv. Ai merr në konsideratë udhëzimet e përgjithshme strategjike, të dhëna nga Këshilli Drejtues, dhe është zhvilluar në linjë me rekomandimet dhe kërkesat rregullative.

Oreksi për rrezik i Tirana Bank

Banka i jep prioritet: **ruajtjes së një baze solide të kapitalit, diversifikimit të burimeve të financimit,**

ruajtjes së cilësisë së asetëve dhe diversifikimit të portofolit të kredisë, si dhe menaxhimit efektiv të kostove dhe shpenzimeve operacionale.

Ajo synon të kombinojë përfitueshmërinë e kënaqshme dhe ruajtjen e standardeve të kredidhënies, duke siguruar se, ekspozimet e rrezikut, janë në përputhje me oreksin për rrezik të aprovuar nga Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe Këshilli Drejtues.

Banka është e angazhuar në përforcimin e vazhdueshëm të praktikave të administrimit të rrezikut, duke siguruar se ajo operon nën një sistem të qartë dhe rigoroz të administrimit të rrezikut, me infrastrukturë optimale të teknologjisë së informacionit, duke siguruar kontributin e administrimit të rrezikut në planifikimin strategjik. Ajo përmirëson në mënyrë të vazhdueshme proceset e administrimit të rrezikut, politikën, modelet dhe mjetet për identifikimin, matjen e ekspozimit ndaj rrezikut, në linjë me kërkesat rregullative dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Këshilli Drejtues i Tirana Bank, njehtë të gjitha rreziqet materiale me të cilat Banka përballlet dhe ka përgjegjësinë për aprovimin e kuadrit të administrimit të rrezikut të bankës. Banka ka në fuqi procese të përshtatshme për aprovimin e produkteve të reja apo ndryshimin e proceseve, me qëllim që të vlerësojë impaktin potencial mbi nivelin e rrezikut të Bankës.

Banka ruan një politikë komunikimi dhe kulturë që synon të përforcojë besueshmërinë e klientëve, aksionerit, investitorëve, punonjësve dhe partnerëve të saj. Ajo synon të sigurojë disponueshmërinë dhe përshtatshmërinë e burimeve të nevojshme për implementimin efektiv të kuadrit të brendshëm të administrimit të rrezikut. Banka mban një politikë

shpërblimi, që nuk stimulon praktikat e ndërmarrjes së rrezikut përtej niveleve të dëshiruara.

Oreksi për Rrezik – Kapitali

- Tirana Bank synon të ruajë në çdo kohë një bazë të fortë të kapitalit, duke mbështetur planet e saj të biznesit dhe duke ruajtur aftësinë për të vijuar operacionet.
- Ajo synon të ruajë treguesit e kapitalit mbi limitet rregullative, me qëllim që të sigurojë besueshmërinë e depozituesve dhe të mbajë mjaftueshëm rezerva për të përballur sfidat ekonomike.
- Ajo mban infrastrukturë të përshtatshme, politika, procedura e metodologji për të përmbushur kërkesat rregullative referuar menaxhimit të kapitalit.

Oreksi për Rrezik – Kredia

- Tirana Bank kontrollon rrezikun e kredisë nëpërmjet kritereve të shëndetshme të kredidhënies, të cilat përfshijnë opsionin e pagesës (opsioni i parë) si dhe pranimin e kolateralit (si opsion i dytë për ripagimin e kredisë) si dhe vlerësimin e kujdesshëm të klientit. Procesi mbështetet nga përdorimi i sistemeve të brendshme të vlerësimit me aftësi diskriminuese dhe sistemeve për matjen e rrezikut të kredisë dhe përlogaritjen e kërkesës për kapital.
- Fokusi i saj është rritja e portofolit të kredisë në sektorë të rëndësishëm me perspektivë të mirë rritjeje, duke synuar reduktimin e vonesave, nëpërmjet identifikimit në kohë të rrezikut të kredisë, monitorimit të vazhdueshëm dhe masave korrigjuese.

- Ajo administron në mënyrë efektive normën e kredive me probleme nëpërmjet Divizionit të Rikuperimit të Kredive me Probleme, duke reduktuar normën e formimit të kredive të reja me probleme me qëllim ruajtjen e kostos së rrezikut brenda limiteve të përcaktuara nga Këshilli Drejtues.
- Banka operon në çdo kohë nën limitet e kreditimit të aprovuara nga Këshilli Drejtues, të cilat përditësohen në mënyrë të rregullt dhe mbulojnë të gjitha aktivitetet e Bankës, në mënyrë që të mbajë nën kontroll rrezikun e kredisë. Të gjitha vendimet e kredidhënies, bëhen në përputhje me Politikat dhe Manualët e Kredidhënies në fuqi.
- Monitorimi i centralizuar i të gjithë ekspozimeve të kredisë në nivel kredimarrësi dhe palësh të lidhura, është në fuqi.

Oreksi për Rrezik – Likuiditeti

- Banka synon të ruajë një bazë të diversifikuar të financimit dhe të monitorojë në mënyrë të kujdesshme nivelet e likuiditetit. Rritja e përqëndrimit përtej niveleve të dëshiruara reflektohet në shtesën dinalime të likuiditetit me qëllim reduktimin e rrezikut respektiv.
- Ajo ruan treguesit e likuiditetit brenda kërkesave rregullative dhe limiteve të brendshme të oreksit për rrezik, këto të fundit përcaktuar në nivele më të larta se treguesit rregullativë, duke lejuar akomodimin e situata të mundshme të shok-ut dhe veprimet e nevojshme për ripozicionim.
- Në baza të rregullta, Banka kryen teste të shok-ut, si pjesë e proceseve rutinë të administrimit të rrezikut dhe kryen teste të shok-ut specifik dhe sipas rastit, në përgjigje të zhvillimeve të jashtme me impakt potencial mbi aktivitetin e saj.

- Banka mbështetet në administrimin efektiv të Aseteve dhe Detyrimeve të saj, me qëllim që të sigurojë ruajtjen e niveleve të përshtatshme të asetëve shumë likuide.

Oreksi për Rrezik – Rreziku i Tregut

- Banka synon të mbajë nivel të ulët të ekspozimit ndaj rreziqeve të tregut, të krijuara nëpërmjet aktiviteteve të saj të tregtimit, si dhe realizon administrim dhe monitorim të qendëruar të rreziqeve të tregut që rrjedhin nga aktivitetet e klientëve, ndërkohë që mban ekspozimet brenda limiteve të rrezikut të tregut, të përcaktuara nga Këshilli Drejtues.

Oreksi për Rrezik – Rreziku Operacional

- Banka dëshiron të minimizojë humbje operationale të shkaktuara nga papërshtatshmëria dhe joefektiviteti i Sistemit të Brendshëm të Kontrollit apo mospërputhshmëria e palëve të përfshira me parimet dhe objektivat e kontrollit.
- Banka synon të shmangë plotësisht humbjet nga mashtrimi i brendshëm dhe humbje të lidhura me të gjitha format e korrupsionit, përfshirë mashtrimin, ryshfetin, abuzimin e tregut apo manipulimin dhe përdorimin e institucionit për qëllime të pastrimit të parave apo financimit të terrorizmit. Në këtë kontekst, Banka ka implementuar masa dhe politika të përshtatshme për të parandaluar këto praktika dhe për të mbrojtur reputacionin e saj në lidhje me etikën në biznes, integritetin financiar dhe besueshmërinë e stafit. Përputhshmëria e vazhdueshme e burimeve të saj njerëzore me kodin e etikës dhe sjelljes, si dhe parimet e qeverisjes

korporative dhe rregullorja e brendshme e operimit, janë të nevojshme me qëllim shmangien e këtyre humbjeve.

- Banka nuk ka tolerancë ndaj incidenteve me impakt reputacional dhe ndikim në imazhin e korporatës. Këto incidente përfshijnë humbjen e jetës, cënimin e integritetit fizik apo shëndetin e klientëve dhe punonjësve, mospërputhshmërinë me kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës, mospërputhshmërinë me parimet e Përgjegjësisë Korporative dhe Sociale (shoqërinë, kulturën dhe mjedisin) apo cënimin e vijueshmërisë së biznesit dhe/ose operacionet e sistemeve të informacionit.

Oreksi për Rrezik – Siguria e Informacionit

- Banka merr masa të vazhdueshme për të përforcuar aftësinë e saj mbrojtëse ndaj sulmeve kibernetike, me qëllim parandalimin e incidenteve dhe humbjeve nga sulmet kibernetike në sistemet e saj, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm, zgjerimit dhe përdorimit të mekanizmave të avancuar të mbrojtjes, infrastrukturës dhe kontrolleve teknike për monitorim, parandalim dhe mitigim të rreziqeve përkatëse.
- Banka dëshiron të shmangë incidente që çojnë në mosdisponueshmërinë e sistemeve që mbështesin funksionet e saj kritike të biznesit dhe synon në minimizimin e kohës së nevojshme për të rikuperuar operacionet kritike, sikurse përcaktohet nga RTO-të (Recovery Time Objectives) e identifikuar dhe dakordësuara.
- Banka dëshiron të shmangë incidentet e lidhura me sistemet e informacionit, të cilat gjenerohen nga praktika të dobëta të implementimit të ndryshimeve, ndërkohë që është e hapur ndaj

teknologjive të reja për përmirësimin e efektivitetit dhe produktivitetit, dhe synon harmonizimin e novacionit digjital me sigurinë e informacionit.

Oreksi për Rrezik – Përputhshmëria, GDPR, Transparenca dhe Sinjalizimi

- Banka është e vendosur të luftojë krimin financiar dhe të sigurojë që llogaritë e mbajtura pranë Bankës, të mos keqpërdoren për qëllime të pastrimit të parasë dhe financimit të terrorizmit.
- Tirana Bank nuk pranon e nuk toleron përfshirje me dijeni dhe vullnet në praktika të lidhura me Pastrimin e Parasë, Ryshfetin dhe Korrupsionin, apo mospërputhje me Sanksionet dhe Embargot, si dhe mospërputhshmëri me rregullat, rregulloret, ligjet e politikat përkatëse. Ajo synon të mbajë të përditësuara politikat, procedurat e lidhura me luftën kundër pastrimit të parasë, sanksionet dhe embargot, Politikat kundër Ryshfetit dhe Korrupsionit, si dhe Programet Kundër Mashtrimit, në përputhje me ligjet dhe rregulloret.
- Tirana Bank kryen trajnime të vazhdueshme dhe monitorime me qëllim realizimin kurdo që është e nevojshme, të analizës dhe njohjes së klientëve, mbikëqyrjes së zgjeruar dhe monitorim të transaksioneve të dyshimta dhe të ndaluara, si dhe mban një sistem të përshtatshëm të monitorimit të këtyre aktiviteteve.
- Banka nuk do të ofrojë asnjëherë në dijeni të saj, produkte apo shërbime ndaj palëve të përfshira në pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, mbështetje ndaj palëve apo regjimeve subjekt i sanksioneve qeveritare, sikurse ndaluar nga ligji apo nëpërmjet kufizimeve speciale bazuar në rrezikun e vendit, apo që synojnë të përdorin

shërbimet bankare të Tirana Bank, për të lehtësuar aktivitete jo të ligjshme, përfshirë ryshfetin, korrupsionin apo evazionin fiskal.

- Banka mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj respektimit të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, duke e trajtuar përputhshmërinë jo vetëm si një detyrim ligjor, por si një komponent thelbësor të qeverisjes së mirë dhe integritetit institucional. Funkzioni i përputhshmërisë është i pozicionuar strategjikisht për të identifikuar, vlerësuar dhe adresuar risqet që lidhen me mospërputhjen, në përputhje me parimet e linjave të mbrojtjes dhe standardet ndërkombëtare. Gjatë vitit raportues, banka ka vijuar të investojë në forcimin e kapaciteteve të kontrollit të përputhshmërisë, përmirësimin e politikave të brendshme dhe integrimin e kërkesave të reja rregullatore në praktikat operacionale.
- Qasja e bazuar në rrezik dhe bashkëpunimi i ngushtë funksionet e tjera kyçe të kontrollit kanë mundësuar një menaxhim proaktiv dhe gjithëpërfshirës të rrezikut të përputhshmërisë, duke rritur qendrueshmerine institucionale dhe besimin e aktorëve të jashtëm.
- Banka mbetet e angazhuar në një qasje të kujdesshme ndaj rrezikut të përputhshmërisë, duke ruajtur një oreks të ulët për rrezik gjithashtu edhe në fushat që lidhen me transparencën, sinjalizimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.
- Gjatë periudhës raportuese, janë konsoliduar më tej politikat dhe praktikat që sigurojnë përputhshmëri të vazhdueshme me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi, përfshirë kuadrin e përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave personale (GDPR). Transparenca në marrëdhëniet me klientët dhe palët e interesuara mbetet një prioritet i pandryshuar, duke u reflektuar

në përmirësimin e njoftimeve të privatësisë, vendimmarrjes së informuar dhe përpunimit të drejtë e të ligjshëm të të dhënave.

- Masat teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave janë përditësuar në përputhje me natyrën dhe qëllimin e përpunimeve, ndërsa kapacitetet e stafit janë rritur përmes trajnimeve të strukturuar dhe ndërgjegjësimit të vazhdueshëm
- Në të njëjtën kohë, janë mbajtur në vëmendje të vazhdueshme edhe mekanizmat për raportimin e brendshëm të shkeljeve (sinjalizimi), përmes krijimit të kanaleve të sigurta dhe respektimit të standardeve të mbrojtjes së sinjalizuesve.
- Këto elementë janë pjesë përbërëse e kulturës së përputhshmërisë së bankës dhe dëshmojnë angazhimin e saj për të vepruar në përputhje me parimet e integritetit, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë.

Oreksi për Rrezik – Rreziku i ESG

- Banka kupton ndikimin e saj mjedisor dhe është e angazhuar për të reduktuar gradualisht gjurmën e saj të karbonit. Ajo mbështet kalimin në një ekonomi me karbon të ulët, duke njohur rreziqet dhe mundësitë që lidhen me çështjet mjedisore si ndryshimi i klimës, ndotja dhe përdorimi i burimeve natyrore.
- Banka ka një oreks të ulët rreziku për sektorë me ndikim të lartë mjedisor, si karburantet fosile, miniera dhe prodhimi i rëndë. Megjithatë, banka mund t'i mbështesë këto industri kur klientët tregojnë një angazhim të qartë dhe të matshëm ndaj praktikave të qëndrueshmërisë,

të tilla si objektivat e reduktimit të emetimeve ose minimizimi i mbetjeve.

- Së brendshmi, banka angazhohet për masat bazë të efikasitetit të energjisë dhe burimeve (p.sh. reduktimi i përdorimit të letrës, kursimi i energjisë) dhe është e hapur për zbatimin e politikave më të forta ndërkohë që zhvillon kapacitetet e saj të brendshme.
- Banka ka zero tolerancë për praktikën e biznesit që çënon të drejtat themelore të njeriut. Kjo përfshin një angazhim për të shmangur klientët ose partnerët e biznesit të përfshirë në punën e detyruar, punën e fëmijëve ose forma të tjera të shfrytëzimit.
- Banka vlerëson diversitetin dhe synon të krijojë një mjedis gjithëpërfshirës për të gjithë punonjësit. Është plotësisht e përkushtuar ndaj ekuilibrit gjinor dhe mundësive të barabarta.
- Banka ka zero tolerancë për aktivitetet joetike ose të paligjshme, duke përfshirë rryshfetin, korrupsionin dhe mashtrimin. Ajo është e përkushtuar për ruajtjen e standardeve të qëndrueshme të pajtueshmërisë, megjithëse struktura e qeverisjes së ESG është ende në zhvillim.
- Banka është e përkushtuar për komunikim të qartë dhe transparent për çështjet e ESG me të gjitha grupet e interesit.
- Banka ka një qasje të kujdesshme ndaj sektorëve më të cënueshëm ndaj rreziqeve të tranzicionit që lidhen me ndryshimet klimatike. Kjo përfshin gatishmërinë për të mbështetur industrinë në tranzicion, me kusht që ato të demonstrojnë një plan strategjik për dekarbonizimin.
- Banka ka tolerancë të kufizuar ndaj rrezikut për huadhënien ose investimin në zona me

cënueshmëri të lartë ndaj ngjarjeve të lidhura me klimën (p.sh., përmbytjet, zjarret). Ajo synon të punojë me klientët në këto fusha për të zbatuar strategjitë e zbutjes së rrezikut dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre.

- Banka njih rëndësinë e ESG për reputacionin e saj dhe ka një oreks të ulët për aktivitete që mund të ndikojnë negativisht në pozitën e saj me klientët, investitorët ose komunitetin më të gjerë. Kjo përfshin ekspozimin ndaj sektorëve ose klientëve me të dhëna të dobëta mjedisore ose sociale.
- Ndërsa ende është në zhvillim, banka synon të përmbushë pritshmëritë në rritje të klientëve për një bankë të përgjegjshme duke komunikuar qartë synimet e saj ESG dhe duke vendosur synime shtesë në përputhje me interesat e klientëve në financa të qëndrueshme.
- Banka zero tolerancës për cënimin e të dhënave personale dhe i jep përparësi respektimit të kuadrit ligjor e rregullativ për mbrojtjen e të dhënave personale.

B. PROFILI I RREZIKUT

Përgjatë vitit 2024, Tirana Bank i ka kushtuar vëmendje të veçantë rreziqeve me të cilat, sistemi bankar dhe Banka, janë përballur.

Mjaftueshmëria e kapitalit

Banka kupton rëndësinë e ruajtjes së një baze të fortë të kapitalit kundrejt rreziqeve të ndërmarra. Ajo ka ruajtur një bazë të shëndoshë kapitali, në gjendje për të mbështetur zhvillimin e biznesit, planet e saj strategjike, si dhe për të vijuar qetësisht operacionet e saj. Kërkesat për kapital përlllogariten ndaj të gjitha rreziqeve kryesore që banka ndërmerr, në përputhje të plotë me kërkesat rregullative mbikëqyrëse. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, ka tejkaluar kërkesën minimale rregullative, duke u përlllogaritur në fund të vitit 2024 në nivelin 17.3%, në përputhje me kërkesat rregullative, duke siguruar ruajtjen e besimit të depozitorëve dhe duke krijuar mjaftueshmërisht rezervë për të përballuar sfidat ekonomike.

Mjaftueshmëria e kapitalit (millionë Lek/%)*	31.12.2024	Pajtueshmëria me kufijtë rregullatorë	Pajtueshmëria me kufijtë e brendshëm
Capital Nivel 1	13,894		
Capital Nivel 1	1,192		
Kapitali Total (Niveli 1+2)	15,086		
Asetet e ponderuara me rrezik	87,432		
Nga të cilat:			
Rreziku i Kredisë	77,073		
Rreziku i Tregut	0		
Rreziku Operacional	10,358		
Raporti i Kapitalit të Nivelit të parë*	15.9%**	✓	✓
Raporti i Mjaftueshmërisë së kapitalit **	17.3%**	✓	✓
Përmbushja e shtesave makro-prudenciale	146.7%**	✓	
Leva Financiare	8.5%**	✓	✓

*Për treguesit e pa shoqëruar me shënimin e përputhshmërisë me limitet nuk ka limite rregullative apo të brendshme

**Norma e kapitalit të nivelit të parë arrin në 17.3% me certifikimin e fitimit të mbetur të vitit 2024.

**Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit arrin në 18.7% me certifikimin e fitimit të mbetur të vitit 2024.

**Përmbushja e shtesave makroprudenciale arrin në 202.9% me certifikimin e fitimit të mbetur të vitit 2024.

**Leva Financiare arrin në 9.3% me certifikimin e fitimit të mbetur të vitit 2024.

Administrimi dhe planifikimi i kapitalit, si funksion, siguron qëndrueshmërinë e bankës nën kushte normale dhe stresi ekonomik e financiar, duke marrë në konsideratë rreziqet me të cilat Banka ekspozohet. Nivelet e synuara të raportit të mjaftueshmërisë së

kapitalit, synojnë të sigurojnë stabilitetin e nevojshëm për të mbrojtur depozituesit, duke mbajtur nivele rezervë të mjaftueshme mbi nivelet minimale rregullative të kërkuara.

Administrimi i kapitalit, është gjithashtu pjesë integrale e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit, që synon vlerësimin e kapitalit të nevojshëm në përputhje me profilin e rrezikut të Bankës dhe strategjinë e saj. Në këtë kontekst, dhe me qëllim vlerësimin e mjaftueshmërisë së kapitalit, Banka kryen në mënyrë të vazhdueshme projeksione të nevojës për kapital dhe kapitalit të disponueshëm, duke konsideruar zhvillimet makroekonomike, profilin aktual të biznesit të Bankës, si dhe ndryshimet rregullative që mund të ndikojnë mjaftueshmërinë e kapitalit në periudhat pasardhëse. Procesi i sipërpërmendur, mbikëqyret nga Komitetet më të larta të Bankës, Komiteti i Administrimit të Rrezikut dhe Këshilli Drejtues.

Rreziku i kredisë

Tirana Bank mbylli vitin 2024 me Normë të Kredive me Probleme në nivelin 3.1%, duke qenë kështu nën mesataren e sistemit bankar dhe ndër bankat me nivelin më të ulët të Kredive me Probleme. Kostoja e Riskut për portofolin e Kredisë, shënoi nivelin e 50 pikë bazë për vitin 2024, ndërkohë që Kosto e e Riskut u regjistrua në nivelin negativ prej 24 bps (rekuperim në fondin rezervë) për portofolin e investimeve në letra me vlerë. Mbulimi i kredive me probleme në fund të vitit 2024 regjistroi nivelin rreth 57.8% dhe kreditë performuese u mbuluan me provigjone në nivelin 1.5%. Banka ka treguar në përgjithësi stabilitet në përbërjen e portofolit të kredive sipas klasave për të tre linjat kryesore të biznesit.

Rreziku i kredisë (%)*	31.12.2024	Pajtueshmëria me kufijtë rregullatorë	Pajtueshmëria me kufijtë e brendshëm
Norma e Kredive me Probleme ndaj Totalit të Kredive	3.1%		✓
Mbulimi me provigjone i kredive me probleme	57.8%		✓
Mbulimi me provigjone i kredive performuese	1.5%		
Pesha e kredive në Klasën 1	93.1%		
Pesha e kredive në Klasën 2	3.4%		
Pesha e kredive në Klasën 3	3.5%		
Kosto e Riskut (bps) _kredi	50		
Kosto e Riskut (bps) _portofoli i letrave me vlerë	-7 bps		

*Për treguesit e pa shoqëruar me shënimin e përputhshmërisë me limitet nuk ka limite rregullative apo të brendshme

Rreziku i Likuiditetit

Banka njeh rrezikun e likuiditetit si një ndër rreziqet kryesore që mund të ketë impakt të rëndësishëm mbi kapacitetin e saj për të financuar operacionet e biznesit dhe për të përmbushur detyrimet e saj financiare. Administrimi i likuiditetit është një objektiv kryesor i Bankës dhe përfshin një tërësi aktivitetesh nga monitorimi i kujdesshëm dhe i vazhdueshëm i pozicionit të saj të likuiditetit, deri te menaxhimi i burimeve të financimit dhe përdorimi i fondeve, në mënyrë që të mos kompromentojë aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet.

Banka ka implementuar praktikat më të mira dhe kërkesat e udhëzimit rregullative, për të vlerësuar pozicionin e saj të likuiditetit dhe efektet potenciale të ndryshimeve të pafavorshme të maturimit (dhe mosrinnovimit) të burimeve të financimit, si dhe mundësinë e reduktimit të vlerës së asetëve të saj likuide.

Ajo ushtron monitorim të kujdesshëm të kostos së likuiditetit dhe ka siguruar përputhshmërinë me kuadrin rregullativ të administrimit të rrezikut të likuiditetit, ndërkohë që ruan dhe rishikon në mënyrë të rregullt metodologjitë, politikat, procedurat dhe sistemet e saj, me qëllim administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit.

Banka ka mbajtur nën monitorim të kujdesshëm nivelet e likuiditetit, duke u siguruar që ato të mbeten mbi minimumet rregullative.

Depozitat nga klientët mbeten të diversifikuara pavarësisht rritjes së vërejtur të depozitave nga bizneset gjatë viteve të fundit. Raporti kredi-depozita mbetet i përmbajtur, banka tregon stabilitet të llogarive dhe gjendjes së depozitave me afat, ndërsa analiza e daljeve dhe hyrjeve siç kërkohet nga rregullorja e raportit të mbulimit të likuiditetit kundrejt atyre aktuale tregon aftësinë e Bankës për të përballuar edhe situata shumë të stresuara. Treguesit kryesorë të likuiditetit mbeten mbi kërkesat minimale rregullatore dhe brenda oreksit të rrezikut të Bankës.

Treguesit e rrezikut të likuiditetit*	31.12.2024	Pajtueshmëria me kufijtë rregullatorë	Pajtueshmëria me kufijtë e brendshëm
Kredi / Depozita	62.9%		✓
Aktive likuide / Detyrime afatshkurtra – Total	37%	✓	
Aktive likuide / Detyrime afatshkurtra – Monedha të huaja	28%	✓	
Aktive likuide / Detyrime afatshkurtra – LEK	47.2%	✓	
LCR – LEK	217.3%		✓
LCR – Monedhat e huaja kryesore	155.6%	✓	✓

LCR Total	202.1%	✓	✓
NSFR – LEK	166.4%		✓
NSFR – Monedhat e huaja kryesore	164.5%	✓	✓
NSFR Total	167.6%	✓	✓

*Për treguesit e pa shoqëruar me shënimin e përputhshmërisë me limitet nuk ka limite rregullative apo të brendshme

Rreziku i Tregut

Banka ka të implementuara metoda të përshtatshme për matjen, monitorimin dhe kontrollin e rrezikut të tregut, përfshirë rrezikun e interesit në librin e bankës.

Tirana Bank aplikon politikë të administrimit të rrezikut të normës së interesit dhe adopton teknika vlerësimi, bazuar në analizën e gap-eve të normave të interesit. Ajo vlerëson rrezikun e normës së interesit nëpërmjet treguesit “Earnings-at-Risk”, që shpreh ndikimin negativ mbi të ardhurat në një periudhë të përcaktuar,

të shkaktuar nga ndryshimet e normave të interesit në të gjitha maturimet dhe monedhat.

Për më tepër, ajo vlerëson rrezikun e normës së interesit të portofolit të investimeve në letra me vlerë nëpërmjet ndryshimit të Vlerës Aktuale Neto të shkaktuar nga ndryshimi në normat e interesit të 1 pike bazë. Përgjatë vitit, ajo ka mbajtur tregues të rrezikut të tregut brenda niveleve rregullative dhe oreksit të saj për rrezik.

Rreziku i Tregut	31.12.2024	Pajtueshmëria me kufijtë rregullatorë	Pajtueshmëria me kufijtë e brendshëm
Pozicioni i hapur valutor neto / Kapitali rregullator	0.7%	✓	✓
Ekspozimi ndaj rrezikut të normës së interesit në librin e bankës / Kapitali rregullator	8.54%*	✓	✓

*Duke konsideruar certifikimin e fitimit të mbetur të vitit 2024, ky tregues zbrit në 7.9%.

Rreziku Operacional

Rreziku operacional ka marrë vëmendje të veçantë, nëpërmjet rishikimit të proceseve të Bankës, duke synuar identifikimin e përmirësimeve të mundshme, me qëllim reduktimin e humbjeve operacionale dhe impakteve negative (qofshin ato të natyrës reputacionale, rregullative, etj.) Monitorimi i kujdesshëm i humbjeve operacionale, treguesve kyç të rrezikut, procesi i vetëvlerësimit të kontrollit të rrezikut dhe vlerësimi i skenarëve ekstremë, mbeten format kryesore të kuadrit të brendshëm të administrimit të rrezikut operacional.

Rreziku i sigurisë së informacionit

Rreziku nga kërcënimet e sulmeve kibernetike me të cilat përballet sistemi bankar, ka ndryshuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit dhe një sërë sulmesh janë

regjistruar ndaj aktorëve të infrastrukturave kritike. Si rrjedhojë e sulmeve të shtuara, Tirana Bank ka realizuar rishikim të vazhdueshëm të masave të saj të sigurisë, me qëllim për të siguruar mbrojtjen ndaj sulmeve të sofistikuar. Banka nuk ka regjistruar gjatë vitit 2024 asnjë incident të sigurisë së informacionit me impakt reputacional dhe/ose operacional, dhe performanca e sigurisë së Bankës, ka qenë në nivelet më të larta.

Banka ka zhvilluar dhe dokumentuar një kuadër të brendshëm të administrimit të rrezikut, që synon adresimin e rreziqeve kibernetike dhe të teknologjisë së informacionit. Ndërgjegjësimi i vazhdueshëm i stafit dhe klientëve është konsideruar i një rëndësie të veçantë në rritjen e mbrojtjes. Banka ka investuar vazhdimisht në rritjen e kapacitetit të saj për t'iu përgjigjur sulmeve kibernetike në rritje, duke modernizuar më tej infrastrukturën e saj dhe duke implementuar teknologjitë më të fundit.

RRUGËTIMI DIGJITALI I TIRANA BANK

Gjatë vitit 2024 Tirana Bank ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt një ekosistemi financiar më inovativ, të personalizuar dhe më efikas. Transformimi digjital është kthyer në një shtyllë kryesore për rritjen tonë të qëndrueshme dhe konkurruese.

Digjitalizimi ka qenë mundësuesi kryesor në drejtim të:

- Përmirësimin të përvojës së klientit duke ofruar zgjidhje financiare cilësore të personalizuara dhe intuitive.
- Ekselencën operacionale përmes automatizimit që redukton kostot dhe përshpejton shërbimet.
- Inovacionin dhe rritjen së qëndrueshme duke udhëhequr tregun me zgjidhje digjitale inovatore.

Në vitin 2024, kemi bërë hapa të rëndësishëm në:

- Rritjen organike përmes inovacionit digjital.
- Efikasitetin operacional përmes automatizimit dhe përmirësimin të proceseve.
- Rritjen e përvojës së klientit me platforma më intuitive, shërbime më të shpejta dhe produkte më të personalizuara.

Në drejtim të Inovacionit dhe Rritjes e Qëndrueshme zhvilluam dhe lançuam platforma të reja digjitale për bankimin online duke ofruar akses më të shpejtë dhe më të sigurt për klientët.

TiStart – Digital Onboarding shënoi një hap të rëndësishëm për Tirana Bank drejt pozicionimit si lider në bankimin digjital dhe përmirësimin e efikasitetit operativ.

Digital Onboarding është një kanal inovativ që i mundëson klientëve të hapin llogari plotësisht online, pa pasur nevojë të vizitojnë një degë fizikisht. Përmes këtij procesi të thjeshtuar, klientët mund të verifikojnë identitetin e tyre, të plotësojnë informacionin e nevojshëm dhe të përfundojnë regjistrimin lehtësisht dhe me komoditet, kudo dhe kurdo.

Digital Onboarding është një proces më i shpejtë dhe i sigurt, falë teknologjisë së avancuar për verifikimin dhe mbrojtjen e të dhënave. Për Tirana Bank, kjo platformë e re përmirëson efikasitetin operativ dhe përvojën e klientëve, duke çuar përpara transformimin digjital në sektorin bankar. Me këtë hap, synojmë të jemi gjithmonë më afër klientëve tanë, për t'u ofruar një shërbim më të personalizuar dhe inovativ.

Disa nga përfitimet e Digital Onboarding për Tirana Bank:

1. **Proces më i shpejtë:** Regjistrimi i klientëve të rinj nga 45 minuta fizikisht pranë degës, në më pak se 10 minuta.
2. **Pozicionim më i mirë në treg:** Duke ofruar shërbime digjitale më konkurruese dhe të avancuara.
3. **Përmirësim i përvojës së klientit:** Përmes procesit të thjeshtuar ofrojmë një përvojë pozitive për klientët e rinj.

4. **Rritje e numrit të klientëve:** Mundësi për të tërhequr më shumë klientë, veçanërisht ata që preferojnë zgjidhje digjitale.
5. **Ulje e ngarkesës administrative:** Redukton detyrat administrative për punonjësit e bankës, duke rritur produktivitetin dhe fokusin në detyra të tjera të rëndësishme që përmirësojnë shërbimin ndaj klientit.

Përfitimet e Digital Onboarding për klientët:

1. **Komoditet:** Mund të kryhet nga çdo vend dhe në çdo kohë.
2. **Shpejtësi:** Proces më i shpejtë, brenda 10 minutave.
3. **Lehtësi në përdorim:** Platformë komode dhe e thjeshtë në përdorim.
4. **Siguri më e lartë:** Verifikim biometrik shumë të sigurt.
5. **Akses i menjëhershëm:** Shërbimet bankare janë të disponueshme menjëherë pas regjistrimit.

Ne vazhduam thjeshtimin dhe përmirësimin e shërbimeve tona online duke e pasuruar platformën TiBank me funksionalitete të reja për klientët tanë. Përditësimi i platformës TiBank drejt një platforme të re, për të ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh digjitale.

Pagesa e Taksave Lokale - Ofrimi i një zgjidhjeje të përshtatshme për pagesën e taksave lokale, duke i mundësuar komoditet përdoruesve.

Pagesa e gjobave të policisë - Implementimi i një sistemi efikas për pagesat e gjobave të policisë, duke thjeshtuar procesin për klientët.

Pagesa e faturave utilitare - Përmirësimi i përvojës së përdoruesve për menaxhimin e pagesave utilitare.

Në vitin 2024 ne kemi bërë pjesë të shërbimeve tona në rrjetin e ATM dhe POS, skemën prestigjioze të kartave në të gjithë botën, Mastercard. Ky bashkëpunim na lejoi të ofrojmë shërbime të avancuara dhe të sigurta për klientët tanë duke rritur kështu numrin e transaksioneve dhe forcuar pozitën në treg. Gjithashtu Karta e kreditit Mastercard World Elite në tregun shqiptar, e bën bankën tonë të vetmen në rajon që ofron këtë produkt prestigjioz financiar. Kjo kartë inovative është krijuar ekskluzivisht për klientët tanë elitare, duke u ofruar atyre një sërë përfitimesh.

Digjitalizimi dhe Ekselencia Operacionale

Për të ndërtuar ekselecë operacionale është punuar në disa drejtime duke synuar optimizimin e burimeve, reduktimin e kostove, dhe rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientit.

Ndërtimi i platformës LOS e cila automatizon dhe optimizon procesin e kredidhënies, nga aplikimi deri në disbursimin automatik të fondeve ka qenë një nga arritjet më të mëdha gjatë vitit 2024. Përmes integritimit me burime të ndryshme të të dhënave dhe algoritme vendimmarrëse për vlerësimin e kërkesave për kredi në kohë reale, janë eliminuar proceset manuale dhe është reduktuar ndjeshëm koha e pritjes për klientët. Plataforma LOS ka mundësuar aprovimin e kredive konsumatore të pasiguruara brenda 20 minutash. Impakti që Los platform soll:

- **Përmirësimi i eksperiencës së klientëve:** Kohë më e shkurtër për përpunimin e kërkesave/aplikimeve dhe përgjigje më të shpejtë ndaj klientëve, duke përmirësuar përvojën e klientëve.
- **Transformim i procesit të kredidhënies:** Implementimi i platformës LOS ka transformuar

rrënjësisht procesin e kreditimit në Tirana Bank, duke optimizuar procedurat dhe rritur efikasitetin e stafit të përfshirë në procesin e kredidhënies.

- **Reduktimi i gabimeve njerëzore:** Eliminimi i procesit manual të plotësimit të dokumenteve ka minimizuar gabimet njerëzore, duke rritur saktësinë dhe besueshmërinë e procesit.
- **Inovacion:** Implementimi i teknologjisë moderne ka ndihmuar Tirana Bank të qëndrojë konkurrese në treg dhe të ofrojë shërbime më inovative për klientët.
- **Rritja e transparencës:** Platforma ofron një proces më të qartë dhe të lehtë për t'u ndjekur, duke siguruar transparencë në çdo fazë të procesit së kredidhënies.

Gjatë vitit 2024 ne kemi zhvilluar robotin e parë në bankë RPA (Robotic Process Automation) i cili bëri të mundur automatizimin e procesit të pagesave të policave të sigurimit. Më parë, këto pagesa trajtoheshin manualisht për tetë kompani sigurimesh, me rreth 600-700 polica çdo muaj. Nga rezultatet e deritanishme, nga totali i pagesave të procesuara, roboti përpunon saktësisht -95% të pagesave të policave të sigurimit çdo muaj, duke reduktuar ndjeshëm punën manuale dhe të përsëritur në njësitë e përfshira.

Disa përfitime të tjera të Bankës nga teknologjia robotike, RPA pëfshijnë:

- Automatizimin e detyrave të përsëritshme
- Reduktimin e kostove
- Zvogëlimin e riskut operacional
- Standardizimin dhe optimizimin e proceseve

Zgjerimi i flotës POS me терминаlet PAX dhe zëvendësimi i terminaleve ekzistuese është një projekt strategjik që nxit rritjen e biznesit, përmirëson efikasitetin

operacional dhe përmirëson përvojën e përgjithshme të klientit. Duke investuar në teknologji moderne në терминаlet POS, bizneset bashkëpunëtoresh të bankës mund të qëndrojnë në këtë mënyrë me avantazhe konkurrese në treg.

Firma elektronike, e implementuar në bankë për nënshkrimin e të gjithë dokumenteve të brendshme, ndihmoi në reduktimin e përdorimit të letrës, shkurtimin e kohës së procesit të firmosjes, rritjen e produktivitetit dhe promovimin e digjitalizimit të dokumenteve.

Një partneritet strategjik midis kompanive të Grupit, Tirana Bank mundësoi hedhjen në treg të një karte debiti të re, të krijuar posaçërisht për kompensimin e Policisë së Shtetit. Ky produkt synon të thjeshtojë procesin e pagesave shtesë direkt në llogarinë e punonjësve, të rrisë sigurinë financiare dhe të ofrojë përfitime shtesë nga programet ekskluzive të besnikërisë për punonjësit e Policisë së Shtetit.

Migrimi i personalizuesit për kartat e kreditit bëri të mundur që personalizimi i kartave të bëhet më i shpejtë dhe më i përshtatshëm për kërkesat e bankës dhe klientëve të saj. Kjo solli përmirësimin e eksperiencës së përdoruesit për klientët, duke shkurtuar kohën, duke ndihmuar bankën që të qëndrojë konkurrese në treg, duke tërhequr klientët e rinj dhe mbajtur ata ekzistues.

Transformimi Organizativ

Gjatë vitit 2024, banka ka kaluar nga një organizatë tradicionale drejt një organizate 'agile', të fokusuar tek krijimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm i vlerës për klientët. Qëllimi ynë mbetet krijimi i një strukture që përshtatet, reagon, dhe inovon vazhdimisht, përmes rritjes e përgjegjshmërisë, zvogëlimit të kohës për të nxjerrë

një produkt në treg dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërfunksional.

Fokusi i transformimit tonë organization u mbështet në këto dimensione:

Krijimi i 4 skuadrave tona ndërdisiplinore, autonome dhe të qëndrueshme të cilat u mbështetën në ndjekjen e një modeli të dorëzimit të vazhdueshëm të vlerës në 4 prej shtyllave më strategjike ishin:

1. Lending Operating System (LOS)
2. Digital Banking
3. Cards
4. Efficiency

Krijimi i një mënyre të re pune mbështetur në proceset dhe metodologjitë 'Agile'

- Kalimi në cikle planifikimi tremujore për të siguruar harmonizim midis objektivave strategjikë dhe backlog-ut të ekipeve.
- Implementimi i metodologjive Agile dhe qeverisjes Agile në menaxhimin e projekteve dhe dorëzimit të vlerës.

Krijimi i një kulture inovatore dhe mëndësie iterative

- Kemi kultivuar një kulturë që mbështet:
 - Dorëzim incremental të vlerës.
 - Qasje "customer-centric" për zgjidhjen e problemeve reale të klientëve.
 - Frekuencë të lartë iterimesh (planifikime, inspektime dhe adaptime).

Iniciativa SHIFT (Smart Habits and Ideas for Fostering Thoughtful Efficiency) u krijua me qëllimin për të rritur efikasitetin në proceset tona të brendshme duke përdorur metodologjinë Design Thinking, një qasje e orientuar të përdoruesi, e cila thekson empatinë, kreativitetin dhe bashkëpunimin.

Pozicionimi i teknologjisë si një komponent mbështetës i inovacionit

Fokusi ka qenë në modernizimin e teknologjive duke adoptuar:

- Inxhinieri dhe arkitekturë Agile.
- Qasje "API-First" për integritime.
- Adopim të teknologjive cloud për rritjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Në Tirana Bank besojmë se roli ynë në shoqëri shkon përtej shërbimeve financiare. Si pjesë e Grupit BALFIN dhe si një nga bankat kryesore në Shqipëri, jemi të përkushtuar të krijojmë vlerë afatgjatë jo vetëm për klientët dhe partnerët tanë, por edhe për komunitetet ku operojmë. Për ne, rritja ka kuptim vetëm kur është gjithëpërfshirëse, e përgjegjshme dhe e qëndrueshme.

Gjatë vitit 2024, përgjegjësia jonë sociale u përqendrua në tre shtylla kryesore: arsim dhe fuqizim i të rinjve, qëndrueshmëri mjedisore, dhe përfshirje sociale. Nga mbështetja për edukimin sipërmarrës të nxënësve të shkollave të mesme, te investimet në shkolla të gjelbra dhe ofrimi i zgjidhjeve financiare për grupet në nevojë, kemi synuar të krijojmë ndikim pozitiv aty ku ai është më i nevojshëm.

Çdo nismë që mbështesim udhëhiqet nga një qëllim i përbashkët: të kontribuojmë për një të ardhme më të mirë. Qoftë përmes partneriteteve me organizata joqeveritare, bashkëpunimeve me institucione publike, apo angazhimit vullnetar të punonjësve tanë, mbetemi të përkushtuar për të qenë një faktor ndryshimi në shoqëri.

Më poshtë gjeni një përmbledhje të aktiviteteve dhe projekteve kryesore të CSR-së që Tirana Bank realizoi gjatë vitit 2024, në përputhje me vizionin tonë për një bankë të përgjegjshme.

PRILL 2024

Dhurimi vullnetar i gjakut në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar

Tirana Bank vijoi edhe këtë vit traditën e saj të rëndësishme të dhurimit vullnetar të gjakut, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar. Nisma synon të nxisë ndërgjegjësimin për nevojën jetike të dhurimit të gjakut dhe të japë një shembull pozitiv



për shoqërinë. Me pjesëmarrjen e gjerë të punonjësve nga zyrat qendrore dhe degët në të gjithë vendin, ky aktivitet vërteton frymën e solidaritetit dhe përfshirjes që karakterizon kulturën tonë organizative.



MAJ 2024

Ndërtojmë së bashku të ardhmen e sipërmarrjes rinore

Për të tretin vit radhazi, Tirana Bank ishte mbështetëse e Festivalit Kombëtar të Sipërmarrjes, organizuar nga Junior Achievement of Albania, me qëllim fuqizimin e të rinjve përmes zhvillimit të aftësive sipërmarrëse dhe inovative. Në edicionin e këtij viti, i mbajtur në datat 14-15 maj në Piramidën e Tiranës, morën pjesë 95 nxënës nga 17 qytete të vendit, të cilët përfaqësuan 19 kompani të ideuara prej tyre gjatë zhvillimit të modulit "Shoqëritë e Nxënësve".



Tirana Bank mbështeti gjithashtu dy panairt rajonale në Shkodër dhe Vlorë, duke ndihmuar në realizimin e një rrugëtimi disa mujor ku u përfshinë mbi 2,000 nxënës nga 52 shkolla të mesme në Shqipëri. Çmimi kryesor për kompaninë më të mirë të vitit, "Eco Empathy", u dorëzua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Tirana Bank, z. Dritan Mustafa, duke nënvizuar angazhimin e bankës për të mbështetur ide me ndikim pozitiv në shoqëri dhe mjedis.




QERSHOR 2024

Për një ekonomi më të gjelbër: Konkursi i Bizneseve të Gjelbra 2024

Për të tretin vit me radhë, Tirana Bank ishte partnere në Konkursin e Bizneseve të **Gjelbra**, organizuar nga Partners Albania.

Ky bashkëpunim përfaqëson përkushtimin tonë ndaj zhvillimit të qëndrueshëm, përmes mbështetjes së ideve inovatore që lidhin ruajtjen e mjedisit me fuqizimin ekonomik të komuniteteve lokale.

Nëpërmjet kësaj nisme, Tirana Bank synon të nxisë filantropinë korporative dhe të promovojë modele biznesi që ruajnë traditat, përmirësojnë jetesën dhe janë në përputhje me parimet e ekonomisë së gjelbër. Nga prezantimet e shumta të këtij viti, juria përzgjedhi gjashtë fitues – tre në fazën e ideve dhe tre në fazën e zhvillimit të biznesit – të cilat do të mbështeten në vijim përmes mentorimit dhe monitorimit të dedikuar nga Partners Albania.



QERSHOR 2024

Mbështetje për Konferencën e 15-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC)

Tirana Bank ishte një nga mbështetësit kryesorë të edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit, me temë “Fuqizimi i individëve përmes aksesit në informacion, transparencës dhe gjithëpërfshirjes në një botë të ndërlidhur”. Duke mbështetur këtë platformë ndërkombëtare, ne riafirmuam besimin tonë në rolin

thelbësor që ka transparenca në ndërtimin e një shoqërie më demokratike dhe më të informuar. Për Tirana Bank, përkrahja e nismave që promovojnë të drejtën për informacion është një pjesë integrale e përkushtimit ndaj përgjegjësisë sociale dhe përfshirjes qytetare.



TETOR 2024

Tirana Bank edukon për një të ardhme më të gjelbër

Tirana Bank, në bashkëpunim me Fondacionin Mane dhe organizatën ndërkombëtare Save the Children Albania, nisi projektin “Shkollat Ekologjike”, një nismë 12-mujore që synon edukimin dhe ndërgjegjësimin e brezit të ri për çështje mjedisore. Projekti filloi në shkollën “Rilindja” në qytetin e Vlorës dhe synon të krijojë modele të qëndrueshme për përfshirjen e të rinjve në mbrojtjen aktive të natyrës.

Gjatë prezantimit të projektit, nxënësit e Klubit Ekologjik, mësuesit dhe përfaqësuesit e institucioneve u njohën me objektivat dhe aktivitetet konkrete të kësaj nisme, përfshirë përdorimin praktik të pajisjeve për matjen e cilësisë së ajrit. Këto matje ndihmuan fëmijët të kuptojnë më mirë ndikimin e ndotjes në jetën e përditshme dhe rëndësinë e veprimeve parandaluese.

Drejtoresha e degës së Tirana Bank në Vlorë, znj. Klodjana Aliraj, theksoi rëndësinë që ka edukimi mjedisor për fuqizimin e komuniteteve, ndërsa përfaqësuesja e Save the Children, znj. Anila Meço, vlerësoi këtë projekt si një mënyrë për të angazhuar fëmijët dhe qytetarët në veprime konkrete për një mjedis më të pastër dhe të sigurt.

Kjo nismë është dëshmi e angazhimit të Tirana Bank për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe për të ndërtuar një kulturë të re ndërgjegjësimi mjedisor në shkolla, familje dhe komunitet.

DHJETOR 2024

“Dhuratë Dashurie” për fëmijët në nevojë

Në frymën e festave të fundvitit, Tirana Bank në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar organizoi aktivitetin “Dhuratë Dashurie”, një ditë të veçantë argëtimi për 40 fëmijë të Shoqatës së Jetimëve. Aktiviteti u zhvillua në ambientet e qendrës tregtare QTU, ku fëmijët përjetuan emocione të veçanta gjatë shfaqjes së filmit “Moana” në Cineplexx, u argëtuan me animatorë dhe lojëra, dhe në përmbyllje secili prej tyre mori një dhuratë simbolike nga Jumbo.

Kjo nismë u realizua në kuadër të angazhimit tonë për të sjellë gëzim dhe përfshirje sociale për fëmijët në nevojë, duke treguar se solidariteti dhe dashuria për tjetrin janë vlera që Tirana Bank i mban gjithmonë në zemër. Falë bashkëpunimit me partnerët Cineplexx, Jumbo dhe QTU, kjo ditë e ngrohtë u kthye në një kujtim të paharrueshëm për fëmijët pjesëmarrës.



BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2024, Tirana Bank zbatoi një strategji gjithëpërfshirëse të menaxhimit të burimeve njerëzore, e cila është ndërtuar mbi parimin se kapitali njerëzor përbën themelin e suksesit afatgjatë të organizatës. Në përputhje me zhvillimet e tregut dhe nevojat në rritje të bankës për talent, inovacion dhe efikasitet, Departamenti i Burimeve Njerëzore ka fokusuar veprimtarinë e tij në disa objektiva kyçe.

Së pari, është intensifikuar përpjekja për të tërhequr dhe rekrutuar profesionistët më të kualifikuar dhe me performancë të lartë në treg, në mënyrë që të mbështetet rritja e qëndrueshme e biznesit dhe fuqizimi i performancës organizative. Kjo është realizuar përmes vlerësimit të thelluar të kompetencave, kombinuar me përdorimin e instrumenteve moderne të seleksionimit dhe promovimit.

Në mënyrë paralele, janë ndërmarrë hapa konkretë për të forcuar angazhimin e punonjësve dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e talenteve brenda bankës. Janë zhvilluar mekanizma të reja të motivimit, është rishikuar paketa e përfitimit për punonjësit dhe janë krijuar kushte më të favorshme për zhvillim të qëndrueshëm profesional, duke e pozicionuar bankën si një punëdhënës atraktiv në tregun vendas. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të paketës së përfitimeve dhe skemave stimuluese, janë kryer analiza krahasuese me tregun dhe janë ndërtuar instrumente të përshtatura për t'u përgjigjur më mirë nevojave të profileve të ndryshme të punonjësve. Kjo ka ndihmuar në rritjen e përfshirjes dhe mbajtjen e niveleve të larta të kënaqësisë në punë.

TË DHËNA DEMOGRAFIKE



KAPITALI NJERËZOR



564 PUNONJËS



161 MENAXHERË

403 JO-MENAXHERË




76% FEMRA

24% MESHKUJ

MOSHA MESATARE **37 VJEÇ**

KOHËZGJATJA
MESATARE E PUNËS:
7 VITE



Përfitimet dhe Shpërblimet

Politika e Shpërblimit në Tirana Bank është në përmbushje me standardet ndërkombëtare dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë për një strukturë objektive, transparente dhe të drejtë kompensimi në përputhje me kërkesat aktuale rregullatore. Sistemi i shpërblimit është në përputhje me kërkesat aktuale rregullatore dhe promovon një drejtim të shëndetshëm dhe efektiv të rrezikut dhe nuk inkurajon marrjen përsipër të rreziqeve që tejkalojnë nivelin e rrezikut të toleruar. Politika e shpërblimit në Tirana Bank është në përputhje me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerat dhe interesat afatgjata të Grupit BALFIN dhe të Tirana Bank si dhe përfshin masa për të shmangur konfliktet e interesit.

Objekti i sistemit të shpërblimit në Tirana Bank është të tërheqë dhe të ruajë një fuqi punëtore të motivuar dhe të kualifikuar si dhe të shpërblejë punonjësit për menaxhimin e sfidave të ardhshme në përputhje me drejtimin e shëndoshë dhe efektiv të rrezikut.

Trajtimi i drejtë dhe i barabartë është një parim kryesor i sistemit të shpërblimeve.

Paketa e shpërblimit promovon dhe shpërblen performancën dhe kontributet e qëndrueshme bazuar në rezultatet e arritura, sjelljen dhe mënyrën e të vepruarit në të gjitha nivelet e organizatës.

Totali i shpërblimeve nënkupton të gjitha format e shpërblimit fiks dhe të ndryshueshëm dhe përfshin pagesat dhe përfitimet, monetare ose jomonetare, të dhëna drejtpërdrejt personelit nga ose në emër të Tirana Bank në këmbim të shërbimeve profesionale të ofruara nga stafi.

Shpërblimi fiks duhet të pasqyrojë kryesisht përvojën relevante profesionale dhe përgjegjësinë organizative të punonjësit si dhe të sigurojë një burim të qëndrueshëm të ardhurash.

Në Tirana Bank shpërblimi konsiderohet fiks kur kushtet për dhënien e tij dhe shuma e tij:

- janë të paracaktuar;
- janë jo diskrete;
- janë transparente për stafin dhe të vendosura në një mënyrë të paracaktuar dhe me objektivitet;
- janë të përhershme;
- nuk ofrojnë stimuj për marrje rreziku;
- janë të parevokueshme;
- nuk mund të zvogëlohen, pezullohen ose anulohen nga Tirana Bank;
- nuk varen nga performanca.

Paga bazë është një shpërblim fiks, i cili nuk ndryshon sipas performancës së kompanisë dhe duhet të pasqyrojë kryesisht përvojën relevante profesionale dhe përgjegjësinë organizative siç përcaktohet në përshkrimin e punës së një punonjësi si pjesë e kushteve të punësimit.

Mund të ketë elementë të tjerë/shtesë shpërblimi (p.sh. kompensime për orët jashtë orarit, kompensime të tjera të veçanta ose pagesa shtesë, pagesa që janë pjesë e paketave rutinë të punësimit ose pagesa për personelin e huaj) sipas udhëzimeve/rregulloreve vendase. Elementë të tillë kompensimi mund të jepen vetëm nëse plotësohen të gjitha kërkesat e kompensimit fiks.

Pagesat e ndryshueshme gjatë vitit lëndor mund të jenë pjesë dhe të zbriten nga shuma e bonusit të

performancës, që miratohet për t'iu dhënë punonjësit me këtë të drejtë. Në përfundim të procesit të vlerësimit vjetor të performancës, punonjësit që i lind kjo e drejtë merr shumën e mbetur.

Klasifikimi kryesor i pagesave të ndryshueshme të marra gjatë vitit dhe klasifikimi i tyre si të zbritshëm:

1. Skemat vjetore të stimulimit të linjave të biznesit të akorduara gjatë vitit, janë të zbritshëm nga shuma vjetore e bonusit.
2. Bonuset e tjera të akorduara gjatë vitit, skemat/projektet stimuluuese sipas rastit, nuk janë pjesë e shumës së zbritshme të Bonusit Vjetor.
3. Bonuset e akorduara për projekte të rëndësishme në nivel banke nuk janë pjesë e shumës së zbritshme të Bonusit Vjetor.

Bonusi i Performancës Vjetore:

Parakushte për pagesën e bonusit janë fitimi i përgjithshëm i Bankës (fitimi para tatimit) dhe pozicionimi i treguesve të kapitalit dhe likuiditetit. Si rregull i përgjithshëm, asnjë bonus vjetor nuk i paguhet në rast se Banka nuk është fitimprurëse ose në raste të kushteve të jashtëzakonshme të biznesit/tregut.

- Gjithashtu, në rast se banka është fitimprurëse, por ende nuk arrin shifrën e buxhetuar, vlera në dispozicion për bonusin total, duhet ulur me 10%.

- Në rast se Banka arrin fitimin e saj të buxhetuar, por treguesit e Kapitalit dhe/ose Likuiditetit nuk përputhen me kufirin e paracaktuar të oreksit ndaj rrezikut, Bordi i Drejtorëve ka autoritetin të vendosë për totalin e vlerës së bonusit që duhet shpërndarë. Për çdo pozicion pune, sipas fushëveprimit, përcaktohet një vlerë bonusi nga fitimet neto që përbëhet nga një

përqindje e pagës vjetore bruto. Në çfarëdo rasti vlera individuale e bonusit nuk mund të tejkalojë limitin 20% të pagës vjetore për shumicën e pozicioneve të punës.

Komponentët fiks dhe të ndryshueshëm të shpërblimit total duhet të jenë të mirë-ekuilibruara dhe në përputhje me direktivat e Grupit Balfin dhe kuadrin rregullator në fuqi. Shuma e synuar e kompensimit të ndryshueshëm përfaqëson një pjesë të konsiderueshme, por pa çuar në luhatje të paarsyeshme në kompensimin e punonjësve dhe marrjen përsipër të rrezikut të tepërt.

Burimet Njerëzore përcaktojnë strukturën e pagesës së përzier (pagesë e ndryshueshme si përqindje e pagës

bazë) në përputhje me direktivat dhe rregulloret e Grupit të cilat dhe miratohen më tej nga Këshilli Drejtues i Tirana Bank.

Në çdo rast, Kompensimi i ndryshueshëm i synuar nuk duhet të tejkalojë çdo prag ligjor ose rregullator të detyrueshëm (p.sh. ai duhet të jetë plotësisht në përputhje me çdo dispozitë përsa i përket shumës maksimale të lejueshme të komponentit të kompensimit të ndryshueshëm gjithsej) dhe shpërndarja, dhe pagesa e kompensimit të ndryshueshëm për Stafin e Identifikuar duhet të kryhet në përputhje me rregullat e kufirit të bonusit.

Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues (çdo fund viti)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale 2024	Për periudha të kaluara 2023
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	12,705,247	11,120,922
Cash/bonus	1,858,046	3,425,157
Aksione		
Të tjera		

Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit Ekzekutivë (çdo fund viti)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale 2024	Për periudha të kaluara 2023
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	86,991,357	68,399,877
Cash/bonus	31,281,724	21,037,579
Aksione		
Të tjera		

Gjatë vitit 2024 është kryer rishikimi dhe përmirësimi i skemave nxitëse për linjat e biznesit duke rritur shitjet/referimet ndërmjet linjave të biznesit si dhe duke nxitur punonjësit e zyrave qendrore që të referojnë klientë për degët.

Punonjësit e Tirana Bank gëzojnë të drejtën e produkteve bankare me çmime dhe kushte preferenciale si dhe produkte apo shërbime me çmime preferenciale në kompanitë e Grupit Balfin.

Gjatë vitit 2024 janë përmirësuar disa përfitime të punonjësve të Tirana Bank si:

- Shtesë ditë leje për disa tipologji si (për vjetërsi, për check-up, për nënat e reja, për ditëlindje, për baballarët e rinj).
- Rishikim i normës së interesit për kreditë hipotekore të punonjësve tanë.

Zhvillimi i punonjësve

Një ndër drejtimet më strategjike të këtij viti ka qenë zhvillimi i kompetencave digjitale, në përputhje me objektivat e transformimit digjital të bankës. Janë organizuar programe të posaçme për zhvillimin e drejtuesve, të cilët kanë luajtur një rol kyç në menaxhimin efektiv të ndryshimit dhe përshtatjen e ekipeve me dinamikat e reja të biznesit. Përmes këtij investimi është nxitur një kulturë inovacioni dhe gatishmëri për të përqafuar ndryshimin.

Një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të brendshëm ka qenë investimi në trajnime dhe zhvillim. Gjatë vitit, janë arritur 3,896 alokime në trajnime me një total prej mbi 92 mijë orësh trajnimi. Buxheti për trajnime është rritur me 67% në krahasim me vitin e kaluar, duke e pozicionuar

bankën në linjë me praktikat ndërkombëtare sa i përket zhvillimin profesional të punonjësve.

Programi i identifikimit të talenteve, dhe më pas përfshirja e tyre në programe zhvillim si "Tirana Bank Talent Pool", ka përfshirë 15 punonjës me potencial të lartë rritje profesionale, të cilët kanë ndjekur module të orientuara drejt vetë-udhëheqjes dhe performancës në tregje sfiduese.

Paralelisht, për drejtuesit ekzekutivë janë krijuar plane individuale zhvillimi, të cilat janë plotësuar në masën 85%. Këto plane zhvillimi profesional kanë përfshirë trajnime të specializuara në menaxhim strategjik, auditim, transformim digjital dhe menaxhim të rrezikut financiar, përmes partneriteteve me institucione prestigjioze vendase dhe ndërkombëtare.

Në drejtim të përfshirjes së degëve dhe fuqizimit të rolit të drejtuesëve, Akademia e Degëve ka ofruar mbi 5,000 orë trajnimi për 72 pjesëmarrës, duke mbuluar tema që variojnë nga inteligjenca emocionale tek menaxhimi i ndryshimit.

Gjithashtu, nëpërmjet Akademisë Balfin, është bërë e mundur zhvillimi i 94 punonjësve përmes 24 moduleve trajnimi, të fokusuara në aftësi kritike si udhëheqja përmes coaching-ut, marrja e vendimeve dhe menaxhimi i marrëdhënieve me palët e interesit.

Për më tepër, programi Startech, një nismë e re për përfshirjen e studentëve me potencial në fushën e IT-së dhe analitikës, i cili ka rezultuar me përfshirjen e më shumë se 20 të rinjëve dhe punësimin e tre prej tyre në departamente kyçe, duke krijuar ura efektive midis formimit teorik dhe nevojave reale të tregut të punës.

Përzgjedhja dhe rekrutimi i punonjësve të rinj

Në vitin 2024, Tirana Bank i dha përparësi tërheqjes së talenteve në tregun e punës për të mbështetur një nga pikat e strategjisë tonë të lidhura me rritjen dhe zgjerimin e bankës. Përpjekjet tona të rekrutimit u fokusuan në identifikimin dhe rekrutimin e talenteve të nivelit të lartë, duke rezultuar në integrimin e suksesshëm të 134 profesionistëve të aftë që ndajnë vizionin tonë për inovacion. Për të mbështetur këtë periudhë të zgjerimit, ne kemi përmirësuar ndjeshëm proceset tona të rekrutimit duke përdorur mjete të avancuara të automatizimit, metodologjive të vlerësimit dhe përmirësime që lehtësuan procesin fillestar të përzgjedhjes, shqyrtimit dhe rekrutimit e kandidatëve. Duke nxitur një qasje dinamike dhe gjithëpërfshirëse, ne kemi pozicionuar Tirana Bank si një punëdhënës potencial për individët të cilët duan të bashkohen në një bankë që ka në fokus zhvillimin e punonjësve dhe është e orientuar drejt digjitalizimit dhe inovacionit.

Programi i praktikës

Strategjia jonë e zhvillimit të talenteve që në fillimet e rrugëtimit të tyre profesional është një gur themeli i suksesit. Me një qasje proaktive për të përgatitur gjeneratën e ardhshme të liderëve, ne forcuan programin tonë të praktikës, duke mirëpritur në ekipet tona rreth 100 studentë të talentuar nga universitetet më të mira. Nëpërmjet përfshirjes në programin Tirana Bank Students Hub ne sigurojmë përvojë praktike dhe mentorim përmes filozofisë "Learn by Doing". Programi i strukturuar i praktikës mundëson trajnime

të personalizuar, feedback të vazhdueshëm dhe mundësi për ndërtimin e marrëdhënieve profesionale, duke rezultuar në kalimin 7% të praktikantëve në role me kohë të plotë. Gjatë vitit ne zhvilluam gjithashtu sesione të hapura, seminare dhe panele të industrisë duke ndarë njohuri për tendencat në zhvillim dhe rrugët e karrierës. Këto iniciativa përforcojnë angazhimin tonë për të investuar në një fuqi punëtore dinamike dhe inovative për të ardhmen.

Aktivite të nxisin angazhimin e punonjësve

Tirana Bank i vë një theks të veçantë nxitjes së komuniteteve të brendshme përmes një kalendari të pasur me mbi 20 aktivitete angazhuese gjatë vitit të cilat synojnë të promovojnë bashkëpunimin, lidhjen mes punonjësve dhe mirëqenien e tyre. Nga aktivitetet për forcimin e ekipit te seminarët ndërgjegjësues, këto nisma krijojnë një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështesin kulturën tonë të punës. Për më tepër, ekipi ynë mbetet i përkushtuar ndaj përgjegjësisë sociale të korporatës (CSR), duke kontribuar në mënyrë aktive në aktivitete të dedikuara për CSR. Këto nisma jo vetëm që përputhen me vlerat tona, por edhe fuqizojnë angazhimin e punonjësve për të kontribuar në mënyrë domethënëse për komunitetet të cilave u shërbejmë.

Viti 2024 ka qenë një vit me vëmendje të veçantë ndaj zhvillimit dhe rritjes së punonjësve po ashtu dhe përmirësimit të paketave të kompensimit dhe benefiteve për punonjësit duke e pozicionuar Tirana Bank si një punëdhënës të kërkuar dhe tejet konkurrent në tregun e punës.



1.4%

BABY BOOMERS
(lindur para 1964)



22.5%

GJENERATA X
(lindur 1965 - 1979)



47.2%

GJENERATA Y
(lindur 1980 - 1994)



26%

GJENERATA Z
(lindur 1995 -)

TRAJNIME:

Investimi total në trajnime:

80% përfunduar

(nga nevojat për trajnim të vlerësuara në PEF në vitin 2023)

	Staf	Menaxher	Total
PJESËMARRËSIT E STAFIT	2490	1406	3896
ORË TRAJNIMI PËR PUNONJËS	8235	3962	12197
ORËT TOTALE TË TRAJNIMIT	29776.65833	62625	92401.65833
KOSTO E TRAJNIMIT PËR ÇDO PUNONJËS	ALL 13,904.01		
KOSTO E TRAJNIMIT PËR MANAXHERËT	ALL 54,168,605.87		

2024:

Trajnime të brendshme/në Bankë:

- 29/trajnime
- 784/staf i trajnuar përgjatë 2024 (trajnime për LOS, Menaxhim i Parasë Cash, Rreziku i Kreditit, VISA, SAP, promovime dhe orientim i punonjësve të rinj).

Buxheti për trajnime është rritur me 67% krahasuar me vitin 2023 (benchmark-u për buxhetin e L&D nuk është i disponueshëm në nivel lokal, por duke marrë parasysh tregun global, rekomandohet të jetë nga 3% deri në 5% e kostove vjetore të pagave, për të forcuar ruajtjen e stafit, produktivitetin dhe angazhimin).

Tirana Bank Talent Pool

Pjesëmarrës:

15 individë të përzgjedhur përmes procesit të Identifikimit të Talenteve

Modulet:

Moduli 1: Udhëheqja në një mjedis sfidues

Moduli 2: Arritja e Ekselencës në Tregje Kërkuese

Zhvillimi i Drejtuesve Ekzekutivë

- Plane të personalizuar zhvillimi për çdo ekzekutiv.
- 85% përmbushje e nevojave për trajnim për vitin 2023.
 - Menaxhim strategjik në bankë
 - Auditimi i menaxhimit të projekteve
 - Program për transformim dixhital nga BALFIN
 - Udhëheqja e organizatave në kohë të trazuar

- Programi i Universitetit të Oksfordit “Udhëheqja në kohë pasigurie dhe trazirash”
- Certifikimi për Menaxherin e Rrezikut Financiar (FRM®)
- All Web Summit
- Web Summit Lisbonë
- Forumi i pagesave dhe tregtisë ndërkombëtare i Deutsche Bank
- Samiti bankar Pronovea, menaxhimi i rrezikut të kredisë
- Samiti Global Banking Live
- Bacee i 47-të
- Konferenca e Visa-s
- Backbase
- Konferenca e Creatio-s
- Samiti për Inteligjencën Artificiale dhe Teknologjinë

BRANCH ACADEMY

5,184

Orë
Trajnimi

72

Pjesëmarrës

67

Managers

5

Non
Managerial

Modulet e Zhvilluara:

- Inteligjenca Emocionale
- Menaxhimi i Prioriteteve
- Dhënia e Feedback-ut me NLP
- Menaxhimi i Ndryshimit
- Workshop për Kompetencat 360°
- Ndërtimi i Ekipit (Team Building)

BTA

94

Pjesëmarrës

24

Module

Modulet e Zhvilluara:

- Udhëheqja me Coaching
- Marrja e Vendimeve
- Ndërtimi i Raportit (Marrëdhënieve)
- Menaxhimi i Palëve të Interesuara
- Mendimi Kritik
- Zgjidhja e Problemeve

STARTECH PROGRAM

35

Orë
Trajnimi

7

Module

15


Lektorë nga
Banka

Rezultatet:

- U punësuan 3 praktikantë për MIS, Zhvillim & IT
- Praktika të paguara
- Orar pune fleksibël
- KPI-të e qarta të vendosura nga drejtuesi i departamentit

STRUKTURA ORGANIZATIVE

LEGJENDA DIVIZION DEPARTEMENT FUNKSION



TIRANA BANK SHA

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

**NË DATËN DHE PËR VITIN E MBYLLUR
MË 31 DHJETOR 2024**

përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur	64
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	67
Pasqyra e pozicionit financiar	68
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	69
Pasqyra e flukseve monetare	70
1. Informacion mbi bankën	71
2. Deklarata e përputhshmërisë	71
3. Paraqitja e pasqyrave financiare	72
4. Bazat e përgatitjes	72
5. Çështjet që lidhen me klimën	73
6. Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit	73
7. Standarde të publikuara, por ende jo efektive	93
8. Gjykime, vlerësime dhe supozime të rëndësishme të kontabël	94
9. Administrimi i rrezikut financiar	97
10. Interesi dhe të ardhura të ngjashme	136
11. Shpenzimet e interesit	136
12. Të ardhurat neto nga tarifatat dhe komisionet	136
13. Humbjet e pritshme të kredisë nga paradhëniet për bankat, letrat me vlerë dhe jashtë bilancit artikuj	137

14.	Shpenzimet e personelit	137
15.	Shpenzime të tjera operative	138
16.	Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	138
17.	Të ardhura të tjera, neto	141
18.	Paratë dhe gjendjet me bankën qendrore	141
19.	Detyrimet nga bankat	143
20.	Kredi dhe paradhënie për klientët, neto	146
21.	Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	158
22.	Aktive financiare me kosto të amortizuar	161
23.	Aktivet e riposeduara	164
24.	Aktivet jo-materiale	165
25.	Aktivet afatgjata materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi	166
26.	Aktive të tjera	167
27.	Detyrime ndaj bankave	167
28.	Detyrime ndaj klientëve	167
29.	Borxhi i varur	168
30.	Detyrime të tjera	168
31.	Provizionet	169
32.	Kapitali i paguar dhe primi i aksioneve	169
33.	Informacion shtesë për rrjedhën e parasë	170
34.	Palët e lidhura	170
35.	Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorive të matjes	172
36.	Analiza e maturimit të aktiveve dhe detyrimeve	173
37.	Angazhimet dhe kontingjentet	174
38.	Ngjarjet pas datës së raportimit	178

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR AKSIONARËT DHE BORDIN DREJTUES TË “TIRANA BANK SH.A.”

OPINIONI

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të “Tirana Bank sh.a” (këtu e më poshtë referuar “Banka”), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2024, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 Dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

BAZA PËR OPINIONIN

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

INFORMACIONE TË TJERA TË PËRFSHIRA NË RAPORTIN VJETOR TË TIRANA BANK SH.A

Informacionet e tjera përbëhen nga informacioni i përfshirë në Raportin Vjetor të Bankës, të përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, përveç pasqyrave financiare dhe raportit tonë të auditimit për to. Përgjegjësia për informacionin tjetër i takon Menaxhimit. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2024 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të auditimit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionin tjetër dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë opinionin për të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionin tjetër të identifikuar më sipër kur ai të bëhet i disponueshëm dhe, gjatë kësaj, të shqyrtojmë nëse ai është në kundërshtim material me pasqyrat financiare, ose me njohuritë që kemi marrë gjatë auditimit.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT DHE TË PERSONAVE TË NGARKUAR ME QEVERISJEN NË LIDHJE ME PASQYRAT FINANCIARE

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projekteve dhe zbatimeve procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurën të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare

ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet në atë mënyrë që arrijnë paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri

19 Maj 2025



PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Të ardhurat nga interesi dhe të ngjashme	10 7,596,127	6,128,816
Shpenzimet nga interesi dhe të ngjashme	11 (1,679,641)	(1,063,078)
Të ardhura neto nga interesat	5,916,486	5,065,738
Të ardhura nga tarifrat dhe komisionet	12 833,803	680,337
Shpenzime për tarifrat dhe komisionet	12 (178,134)	(45,118)
Të ardhurat neto nga tarifrat dhe komisionet	655,669	635,219
Humbjet të pritshme nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënies për klientët	20 (435,030)	(436,040)
Humbjet të pritshme nga zhvlerësimi i paradhënies ndaj Bankave, Letrave me vlerë dhe zërave jashtë bilancit	13 159,206	(3,917)
Totali i humbjeve të pritshme nga huatë	(275,824)	(439,957)
Të ardhura të tjera, neto	17 150,578	30,283
Humbje nga kursi i këmbimit, neto	228,724	(103,268)
Shpenzime personeli	14 (1,369,179)	(1,068,275)
Zhvlerësimi i aktiveve të riposuduara	23 (95,991)	(138,764)
Provizione të tjera	(50,000)	(20,500)
Amortizimi i aktivit jo-material	24 (88,781)	(89,402)
Zhvlerësimi i pasurive, pajisjeve dhe aktiveve me të drejtë përdorimi	25 (344,639)	(321,261)
Shpenzime të tjera operative	15 (1,307,237)	(1,204,832)
	(2,876,525)	(2,916,019)
Fitimi përpara tatimit mbi të ardhurat	3,419,806	2,344,981
Shpenzime për tatimin mbi të ardhurat	16 (551,270)	(403,638)
Fitimi për vitin	2,868,536	1,941,343
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:		
Zëra që mund të riklasifikohen më vonë në fitim/humbje:		
Humbja neto nga vlera e drejtë e aktivet financiare VDATGJ	21 669,205	1,365,364
Tatimi i shtyrë në lidhje me fitimin e vlerës së drejtë i regjistruar direkt në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	16 (100,381)	(204,805)
Të ardhura //(shpenzime) të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	568,824	1,160,559
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	3,437,360	3,101,902

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 18 Mars 2025 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa
Drejtör i Përgjithshëm Ekzekutiv

Elvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 86 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Tirana Bank SHA

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVET			
Mjete monetare dhe llogari me Bankën Qendrore	18	14,266,671	11,366,257
Depozita dhe llogari me bankat	19	7,087,704	8,167,673
Huatë dhe paradhënie për klientët, neto	20	75,565,904	56,368,260
Aktivitet financiar me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	21	27,737,012	29,752,158
Aktivitet financiar me kosto të amortizuar	22	31,815,372	21,661,396
Aktive të riposduara, neto	23	707,300	917,575
Aktive të tjera	26	1,024,116	813,178
Aktive jo-materiale	24	446,456	342,235
Aktive afatgjata materiale dhe aktive me të drejtë përdorimi	25	1,006,442	862,215
Aktive tatimore të shtyra	16	82,358	186,193
TOTALI I AKTIVEVE		159,739,335	130,437,140
DETYRIMET			
Detyrime ndaj bankave	27	15,737,734	6,949,364
Detyrime ndaj klientëve	28	123,380,294	107,079,094
Borxhi i varur	29	1,418,277	1,501,077
Detyrime të tjera	30	2,587,960	1,724,225
Provizione	31	299,230	304,901
TOTALI I DETYRIMEVE		143,423,495	117,558,661
Kapitali			
Kapitali i paguar	32	5,917,986	5,917,986
Primi i aksioneve	32	1,735,603	1,735,603
Rezervat	32	1,586,695	920,803
Filimi i pashpërndarë		7,075,556	4,304,087
TOTALI I KAPITALIT		16,315,840	12,878,479
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		159,739,335	130,437,140

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 18 Mars 2025 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa
Drejtör i Përgjithshëm Ekzekutiv

Elvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 86 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

	Kapitali i paguar	Primi i aksioneve	Rezerva ligjore dhe rezerva të tjera	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Totali i kapitalit
Më 1 janar , 2023	5,917,986	1,735,603	1,469,956	(1,762,274)	2,415,309	9,776,580
Transaksioni me pronarët regjistruar drejtpërdrejt në kapital						
Përvetësimi i fitimit të mbajtur në rezerva ligjore	-	-	52,562		(52,562)	-
	5,917,986	1,735,603	1,522,518	(1,762,274)	2,362,747	9,776,580
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit	-	-	-	-	1,941,340	1,941,340
Ndryshimi neto në Rezervat për Asetet Financiare në FVOCI	-	-	-	1,160,559	-	1,160,559
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
	-	-	-	1,160,559	1,941,340	3,101,899
Më dhjetor 31, 2023	5,917,986	1,735,603	1,522,518	(601,715)	4,304,087	12,878,479
Transaksioni me pronarët regjistrohet drejtpërdrejt në kapital						
Përvetësimi i fitimit të mbajtur në rezerva ligjore			97,067		(97,067)	-
	5,917,986	1,735,603	1,619,585	(601,715)	4,207,020	12,878,479
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
Fitimi i vitit					2,868,536	2,868,536
Ndryshimi neto në Rezervat për Asetet Financiare në FVOCI				568,825		568,825
Të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin						
	-	-	-	568,825	2,868,536	3,437,361
Më dhjetor 31, 2024	5,917,986	1,735,603	1,619,585	(32,889)	7,075,556	16,315,840

Pasqyrat financiare u miratuan nga Drejtimi i Bankës më 18 Mars 2025 dhe u nënshkruan në emër të tyre nga:

Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Elvira Kapoli
Drejtuese Financiare

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 86 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

Tirana Bank SHA

(Të gjitha shumat janë në mijë Lek, përveç nëse shprehet ndryshe)

PAS PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2024

Notes	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
AKTIVITETE OPERATIVE:		
Fitimi përpara tatimit	3,419,806	2,344,981
<i>Rregullime për rakordimin e fitimit neto me mjetet monetare nga aktivitetet operative::</i>		
Shpenzime amortizimi	24,25	433,420
Zhvierësimi i pronave të riposeduara	23	31,739
Zhvierësimi i huave dhe paradhënieve për klientët	20	435,030
Zhvierësimi i paradhënieve ndaj Bankave, Letrave me vlerë dhe zërave jashtë bilancit		(109,206)
Të ardhura nga interesi	10	(7,596,127)
Shpenzime nga interesi	11	1,679,641
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative		
Rezerva të detyrueshme		(428,262)
Depozita dhe llogari me bankat		(2,242)
Huatë dhe paradhëniet për klientët		(19,632,675)
Aktive të tjera		(210,927)
Aktive të riposeduara		178,536
Detyrime ndaj bankave		8,798,343
Detyrime ndaj klientëve		16,247,584
Detyrime të tjera		645,205
Interesi i arkëtuar		7,635,635
Interesi i paguar		(1,636,287)
Tatimi i paguar mbi të ardhurat		(551,270)
Flukse të mjeteve monetare neto nga aktivitetet operative	9,337,943	10,385,637
AKTIVITETE INVESTUESE		
Blerjet e letrave me vlerë të investimit	(55,795,236)	(67,549,360)
Të ardhurat nga maturimi/shitja e letrave me vlerë	48,317,995	57,440,664
Të ardhura nga shitja e pronave dhe aktiveve jo-materiale	105,337	435
Blerja e aktiveve jo-materiale	(236,107)	(78,943)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	(551,110)	(428,155)
Flukse të mjeteve monetare net përdorur në aktivitetet investues	(8,159,121)	(10,615,361)
AKTIVITETE FINANCUESE:		
Lëshimi i borxhit të varur	33	-
Shlyerja e principalit të detyrimeve të qirasë	25	212,860
Flukse të mjeteve monetare neto nga aktivitetet financuese	212,860	160,531
Flukset e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre, neto	1,391,686	(69,191)
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, fillimi i vitit	10,734,389	10,803,580
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre, në fund të vitit	12,126,075	10,734,389

Shënimet shoqëruese nga faqja 5 deri në 86 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMACION MBI BANKËN

Tirana Bank SHA ("Banka"), u themelua në 1996 për të operuar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar tregtare dhe me pakicë në Shqipëri. Bazuar në nenin 4 të Statutit të Bankës, objektivi i Bankës është të veprojë, në favor të saj apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Aktiviteti kryesor i Bankës konsiston në operacione bankare dhe financiare, bazuar në një licencë të plotë bankare të lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Licenca është lëshuar në përputhje me Ligjin nr. 8365, "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", datë 2 Korrik 1998, i cili është zëvendësuar nga Ligji nr. 9662, datë 18 Dhjetor 2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar. Banka është gjithashtu subjekt i Ligjit nr. 9901, datë 14 Prill 2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ndryshuar, si edhe ligje të tjera.

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 struktura aksionare e Tirana Bank SHA paraqitet si më poshtë:

Aksionari	Aksione	Në %
Balfin sh.p.k	501,975	100%
Totali	501,975	100%

Më 31 Dhjetor 2024 Banka ka 33 degë (2023: 32) brenda Republikës së Shqipërisë dhe nuk kryen asnjë aktivitet jashtë saj.

Adresa e regjistruar e Bankës është Rruga Ibrahim Rugova, Kutia Postare 2400/1, Tiranë, Shqipëri. Më 31

Dhjetor 2024 Banka ka pasur 564 punonjës (më 31 Dhjetor 2023: 508 punonjës).

Më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 Komiteti Ekzekutiv përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm:

Dritan Mustafa	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Oliver Baur	Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
Elvira Kapoli	Drejtuese Financiare
Brisilda Bala	Drejtuese e Menaxhimit të Riskut
Eralda Tafaj	Drejtuese e Operacioneve
Elona Gjipali	Drejtore e Divizionit të Rikuperimit Bankar
Manjola Capo	Drejtore e Divizionit të Kredisë
Lila Canaj	Drejtuese e Retail-it
Glenda Kurti	Drejtuese e Divizionit të Korporatave

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës është veprimtaria bankare tregtare dhe me pakicë brenda Republikës së Shqipërisë. Banka funksionon në sajë të një licence të plotë bankare të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë ("Banka e Shqipërisë" ose "BSH") që prej vitit 1996.

2. DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2. DEKLARATA E PËRPUTHSHMËRISË (vazhdim)

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.

3. PARAQITJA E PASQYRAVE FINANCIARE

Banka e ka paraqitur pasqyrën e pozicionit të saj financiar në shifra të përafërta të likuiditetit bazuar në qëllimin dhe aftësinë e perceptuar të Bankës për të rikuperuar/shlyer pjesën më të madhe të aktiveve/detyrimeve të nën zërit përkatës të pasqyrave financiare. Aktivitetet dhe detyrimet financiare në përgjithësi raportohen bruto në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar, përveç kur janë përmbushur kriteret e netimit të SNRF-ve.

4. BAZAT E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes investimeve financiare të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ") që maten me vlerën e drejtë dhe kolaterale të riposeduara të cilat maten në vlerën më të ulët të kostos dhe vlerën neto të realizueshme. Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar dhe të gjitha vlerat janë të rrumbullakosur në mijëshen më të afërt ('000 LEK), nëse nuk shprehet ndryshe.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i Bankës i përgatiti këto pasqyra financiare mbi bazën e vazhdimësisë. Sipas gjykimeve, drejtimi i Bankës mori parasysh pozicionin financiar të Bankës, synimet aktuale, përfitimin e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare.

Drejtimi i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së Bankës duke u mbështetur në parimin e vijimësisë dhe është i kënaqur që Banka ka burime që të vazhdojë aktivitetin operacional në të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, Drejtimi nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie të mundshme materiale që mund të hedhë dyshime në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi.

Banka e Shqipërisë ka kërkuar konkretisht që Tirana Bank të mbajë një normë minimale të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 13.5%.

Gjithashtu Banka po monitoron situatën aktuale me konfliktin Rusi - Ukrainë dhe ndikimin e saj në ekonomi, veçanërisht në termat e inflacionit. Banka nuk ka asnjë investim direkt të ekspozuar ndaj këtyre vendeve dhe nuk ka klientë të mëdhenj kreditues që kanë përqendrim të konsiderueshëm biznesi me to, kështu që nuk ka rreziqe të drejtpërdrejta përveç mjedisit të përgjithshëm ekonomik. Banka është përgjigjur me një qasje të matur ndaj ekspozimeve në humbjen e kredisë, dhe me rritje të vigjilencës ndaj monitorimeve të portofoleve të kredisë

Banka ka njohur dhe përgatitur veten për efektet e mundshme negative që mund të paraqesin zhvillimet e viteve të fundit dhe ka shqyrtuar sfidat e përballura me vëmendjen e kërkuar.

Që nga tërmeti i vitit 2019, pandemia e vitit 2020 dhe efektet botërore të luftës Rusi-Ukrainë të materializuara në inflacion të lartë dhe turbulenca në tregje, Banka ka bërë vazhdimisht stres test të portofolit të kredive dhe letrave me vlerë dhe ka rritur mbulimin e provizioneve në pritje të rritjes së mundshme të vonësave në pagesa.

4. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

Si rrjedhojë, mbulimi i provizioneve për kreditë e fazës 2 është rritur nga Dhjetor '19: 5.9% në Dhjetor '24: 14.1%, pavarësisht rënies së peshës së kredive të fazës 2 mbi totalin e portofolit (nga Dhjetor '19: 6.3% deri në Dhjetor '24: 3.4%). Strategjia ndiqet me ekspozimet e fazës 3 për të cilat mbulimi ka ndryshuar gjatë viteve të fundit nga Dhjetor '19: 36.7% në Dhjetor '24: 54.6% ndërsa pesha e kredive të fazës 3 është ulur gjatë të njëjtit hark kohor (nga Dhjetor '19: 11%, në Dhjetor '24: 3.5%).

Në pritje të rritjes së mundshme të vonesave në pagesa për shkak të rritjes së normave të interesit si rezultat i politikave kufizuese të Bankave Qendrore në përpjekje për të luftuar inflacionin, Banka kryen vazhdimisht stress test dhe rishikime të ekspozimeve të saj për të vlerësuar ndikimin e tyre dhe për të siguruar marrjen e masave të duhura për të reduktuar efektet e mundshme negative të këtyre ngjarjeve. Banka ka realizuar nivele të kënaqshme fitimi dhe ka kapital dhe likuiditet të mjaftueshëm për të qëndruar elastike ndaj çdo goditjeje të paraqitur. Për këtë arsye, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi parimin e vijimësisë.

5. ÇËSHTJET QË LIDHEN ME KLIMËN

Rreziku i shkaktuar nga ndryshimet klimatike mund të ketë efekte negative në të ardhmen në aktivitetin e biznesit të bankave. Këto rreziqe përfshijnë rreziqet e tranzicionit (p.sh. ndryshimet rregullatore dhe rreziqet e reputacionit) dhe rreziqet fizike (edhe nëse rreziku i dëmtimit fizik është i ulët për shkak të aktiviteteve të Bankës dhe vendndodhjeve gjeografike). Mënyra se si Banka e operon biznesin e saj mund të ndikohet nga rregullat dhe ndryshimet e reja.

Në përputhje me vitin e kaluar, më 31 Dhjetor 2024, Banka nuk ka identifikuar rreziqe të rëndësishme të shkaktuara nga ndryshimet klimatike që mund të ndikojnë negativisht dhe materialisht në pasqyrat financiare të Bankës.

Supozimet mund të ndryshojnë në të ardhmen në përgjigje të rregulloreve të ardhshme mjedisore dhe angazhimeve të reja të marra. Këto ndryshime, nëse nuk parashikohen, mund të kenë ndikim në flukset e ardhshme të parasë, performancën financiare dhe pozicionin financiar të bankave.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

Politikat kryesore të kontabilitetit të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç kur citohet ndryshe.

6.1. KONVERTIMI I MONEDHËS SË HUAJ

Monedha funksionale dhe prezantuese

Monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës është leku shqiptar ("lekë"). Leku është monedha kryesore në mjedisin ekonomik në të cilin Banka operon, Republika e Shqipërisë. Shumat e paraqitura në këto pasqyra financiare janë rumbullakosur në mijëra më të afërt, përveç kur citohet ndryshe.

Transaksionet dhe gjendjet

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën përkatëse funksionale të operacionit me kursin e këmbimit spot në datën e transaksionit.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.1. KONVERTIMI I MONEDHËS SË HUAJ (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet monetare të cilat maten me monedha të huaja janë ri-konvertuar në monedha funksionale me kursin e këmbimit spot në datën e raportimit. Fitimi ose humbja në valutë në zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të përkthyer me kursin e këmbimit në vend në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me kosto historike, konvertohen duke përdorur kurset e këmbimit, në datën e njohjes. Diferencat në monedhë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje, përveç diferencave në monedhë të huaj që rrjedhin nga përkthimi i instrumenteve të kapitalit të disponueshëm për shitje, të cilat njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Normat e aplikueshme të këmbimit (lekë në njësi valutore) për monedhat kryesore më 31 Dhjetor 2024 dhe 2023 ishin si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2024	Më 31 dhjetor 2023
USD	94.26	93.94
EUR	98.15	103.88

6.2. NJOHJA E TË ARDHURAVE

Të ardhurat njihen në atë masë sa është e mundshme që përfitimet ekonomike do të rrjedhin në Bankë dhe të ardhurat mund të maten me besueshmëri. Kriteret

specifike të mëposhtme të njohjes gjithashtu duhet të përmbushen përpara se të njihen të ardhurat.

a) Të ardhura dhe shpenzime nga interesat dhe të ngjashme

Të ardhurat nga interesi përfshijnë kuponat e fituar nga investimet me të ardhura të pandryshueshme, çdo zbritje të maturuar dhe primin nga bonot e thesarit me kupon zero të njohura duke u përdorur në fitim ose humbje metodën efektive të normës së interesit dhe të ardhura interesi nga kredi dhe paradhënie. Për të gjithë instrumentet financiare të matur me kosto të amortizuar dhe instrumentet financiare që mbartin interesin, të klasifikuar si investime financiare të vlefshme për shitje, të ardhurat nga interesi ose shpenzimet regjistrohen me normën efektive të interesit, e cila është norma që skanton vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimeve monetare të ardhshme përgjatë jetës së instrumentit financiar, ose një periudhe më të shkurtër, sipas rastit, me vlerën e mbetur neto të aktivitet ose detyrimit financiar.

Përlllogaritja merr parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, opsionet e parapagimit) dhe përfshin çdo tarifë ose kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt instrumentit dhe janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, por përjashton humbjet e kredisë në të ardhmen. Vlera kontabël e aktivitet ose detyrimit financiar rregullohet nëse Banka rishikon vlerësimet e saj të pagesave ose të arkëtimeve. Vlera kontabël e rregulluar llogaritet duke u bazuar në normën efektive fillestare të interesit dhe ndryshimi në vlerën kontabël regjistrohet si e ardhur ose shpenzim nga interesi. Kur vlera e regjistruar e një aktivi financiar ose një grupi aktivesh të ngjashme financiare është zvogëluar si pasojë e një humbje

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.2. NJOHJA E TË ARDHURAVE (vazhdim)

a) Të ardhura dhe shpenzime nga interesat dhe të ngjashme (vazhdim)

nga zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën efektive të interesit fillestar të aplikuar në vlerën e re kontabël.

'Kostoja e amortizuar' e një aktivi financiar ose detyrimi financiar është shuma në të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus ripagimet kryesore, plus ose minus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj fillestare shuma dhe shuma e maturitetit dhe, për aktivet financiare, të rregulluara për çdo lejim të prishëm të humbjes së kredisë (ose lejimin e zhvlerësimit para 1 Janarit 2018). "Vlera kontabël neto e një aktivi financiar" është kostoja e amortizuar e një aktivi financiar para se të rregullohet çdo zhvlerësim për humbjet e pritura të kredisë.

b) Të ardhura nga tarifa dhe komisione

Në përputhje me SNRF 15, të ardhurat nga kontratat me klientët njihen kur Banka ka përbushur detyrimet e saj të performancës duke transferuar shërbimet e premtuara tek klienti. Të ardhurat njihen me një vlerë që reflekton vlerën kontabël që pritet të merret në këmbim. Banka fiton të ardhura nga tarifa dhe komisione nga një gamë e larmishme shërbimesh që u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat mund të ndahen në dy kategoritë e mëposhtme:

I. Të ardhura nga tarifat për shërbime që ofrohen përgjatë një periudhe kohe të caktuar

Tarifat e fituara për ofrimin e shërbimeve përgjatë një periudhë kohe maturohen përgjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë tarifa komisioni për mirëmbajtjen e llogarive, tarifa të mirëmbajtjes së kartave dhe shërbimit E-banking. Tarifat për angazhimin e huasë, për kredi që ka të ngjarë të tërhiqen dhe tarifa të tjera të lidhura me kredinë të cilat shtyhen (së bashku me ndonjë kosto shtesë) dhe njihen si një rregullim i normës efektive të interesit për kredinë.

II. Të ardhura nga tarifat për shërbime transaksioni që njihen në një afat kohor të caktuar

Këto tarifa dhe komisione përfshijnë tarifat e urdhër-pagesave dhe urdhër-transfertave të klientëve, dhe shërbimet e tjera bankare të ofruara. Këto tarifa ose pjesët përbërëse të tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas kryerjes së shërbimit.

• TARIFAT E HUADHËNIES

Tarifat e përfshira këtu përfshijnë ndër të tjera tarifat për shërbimin e një kredie, letër kredie ose garancie bankare. Të ardhurat dhe shpenzimet e tarifave dhe komisioneve të tjera lindin në shërbimet financiare që operohen nga Banka gjatë aktivitetit të saj dhe njihen kur shërbimi përkatës realizohet ose merret.

6.3. INSTRUMENTET FINANCIARE - NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASHME

a) Data e njohjes

Aktivitet dhe detyrimet financiare, me përjashtim të huave dhe paradhënive për klientët dhe tepricat që i detyrohen klientëve, fillimisht njihen në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

INSTRUMENTET FINANCIARE - NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASHME (vazhdim)

a) Data e njohjes

në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin tregtime të rregullta, d.m.th., blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e aktiveve brenda afatit kohor të vendosur përgjithësisht me rregullore ose konventë në tregun vendas. Huatë dhe paradhënie ndaj klientëve njihen kur fondet transferohen në llogaritë e klientëve. Banka njihet tepriçat ndaj klientëve kur fondet transferohen në Bankë.

b) Matja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga kushtet e tyre kontraktuale dhe modeli i biznesit për menaxhimin e instrumenteve siç përshkruhet në Shënimin 6.2. Instrumentet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, me përjashtim të rasteve kur aktivet dhe detyrimet financiare janë regjistruar në Vlerën e Drejtë nëpërmjet Pasqyrës së Fitimit dhe Humbjes (VDPFH), kostot e transaksionit i shtohen, ose zbriten nga kjo shumë. Llogaritë e arkëtueshme tregtare maten me çmimin e transaksionit. Kur vlera e drejtë e instrumenteve financiare në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit, bankat kontabilizon fitimin ose humbjen e Ditës 1, siç përshkruhet më poshtë.

c) Dita 1 fitimi ose humbja

Kur vlera e drejtë e instrumentit ndryshon nga vlera e drejtë në origjinë dhe vlera e drejtë bazohet në një

teknikë vlerësimi duke përdorur vetëm hyrjet (inputet) e krahasuara në transaksionet e tregut, Banka njihet ndryshimin midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë në të ardhurat neto nga tregtimi. Në këto raste kur vlera e drejtë bazohet në modele për të cilat disa nga inputet nuk janë të krahasueshme, diferenca midis çmimit të transaksionit dhe vlerës së drejtë shtyhet dhe ajo njihet vetëm në fitim ose humbje kur hyrjet (inputet) bëhen të krahasueshme, ose kur instrumenti është çregjistruar.

d) Kategoritë e matjes së aktiveve dhe detyrimeve financiare

Banka i klasifikon të gjitha aktivet e saj financiare bazuar në modelin e biznesit për administrimin e aktiveve dhe kushteve kontraktuale të aktivitetit, të matura ose me:

- Koston e amortizuar
- Vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ)

Detyrimet financiare, përveç angazhimeve të kredisë dhe garancive financiare, maten me koston e amortizuar ose në VDPFH kur ato mbahen për tregtim ose aplikohet përcaktimi i vlerës së drejtë. Shihni politikat e kontabilitetit në Shënimin 6.3.

e) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto e raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar shumën e njohura dhe ka një qëllim që të shlyhen në bazë neto, ose të realizojnë aktivitetin dhe të shlyejnë detyrimin njëkohësisht.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.3. INSTRUMENTET FINANCIARE - NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASSHME (vazhdim)

f) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për të marrë flukset monetare nga këto aktive kanë pushuar së ekzistuari ose aktivet janë transferuar dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve janë transferuar gjithashtu (që do të thotë, nëse në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet nuk janë transferuar, Banka teston kontrollin për tu siguruar që përfshirja e vazhdueshme në bazë të çdo pushteti të mbajtur të kontrollit nuk parandalon çregjistrimin). Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato janë shlyer ose në rastin e kundërt shuar, d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë, shkarkohet, anulohet ose skadon.

g) Fshirjet

Banka i fshin aktivet financiare në tërësinë e tyre ose një pjesë të tyre kur ka ezauruar të gjitha përpjekjet praktike të rimëkëmbjes dhe nuk ka ndonjë pritshmëri të arsyeshme për rimëkëmbje. Kriteret që tregojnë se nuk ka pritshmëri të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë periudhën e dështimit, cilësinë e kolateralit dhe fazat e ndryshme të procedurave të përbarimit. Banka mund të fshijë aktivet financiare që janë ende subjekt i aktiviteteve përbarimore, por kjo nuk ndikon në të drejtat e saj në procedurat e përbarimit. Banka ende kërkon të rikuperojë të gjitha shumat plotësisht të takojnë me ligj. Fshirja zvogëlon vlerën kontabël bruto të një aktivi financiar dhe zbritjen për zhvlerësimin.

Çdo rikuperim i mëvonshëm i kreditohet shpenzimit të humbjes së kredisë.

6.4. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

Për të treguar se si janë nxjerrë vlerat e drejta, instrumentet financiare klasifikohen bazuar në një hierarki të teknikave të vlerësimit, siç përmbledhen më poshtë, në:

- **Instrumente financiare të Nivelit 1** – Ato instrumente ku hyrjet (Inputet) e përdorura në vlerësim janë çmime të kuotuar të parregulluara nga tregjet aktive për aktive ose detyrime identike në të cilat Banka ka qasje në datën e matjes. Banka i konsideron tregjet si aktive vetëm nëse ka veprimtari të mjaftueshme tregtare në lidhje me vëllimin dhe likuiditetin e aktiveve ose detyrimeve identike dhe kur ka kuota çmimesh detyruese dhe të periudhës së ushtruar, të disponueshme në datën e bilancit. Një instrument financiar vlerësohet i kuotuar në një treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të disponueshme me lehtësi dhe në mënyrë të rregullt nga një agjenci këmbimi valutor, tregtar, ndërmjetës, grup i industrisë, agjenci shërbimi çmimesh ose agjenci rregullatore, dhe këto çmime përfaqësojnë transaksione të tregut aktual dhe që ndodhin rregullisht mbi bazën e vlerës së tregut. Nëse kriteret e mësipërme nuk përmbushen, tregu vlerësohet si joaktiv. Treguesit e një tregu joaktiv janë kur ka një marzh të gjerë të çmimit të kërkuar dhe ofruar ose një rritje të konsiderueshme të marzhit midis çmimit të kërkuar dhe ofruar ose ka pak transaksione të fundit, një rënie të ndjeshme në vëllimin mesatar të tregtimit ditor të të gjitha aksioneve nën shqyrtim në vend gjatë 5 viteve të fundit, etj.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.4. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË (vazhdim)

- **Instrumente financiare të Nivelit 2** - Ato instrumente ku hyrjet (inputet) që përdoren për vlerësim dhe janë të konsiderueshme, rrjedhin nga të dhëna të tregut të vëzhguara direkt ose indirekt të disponueshme përgjatë të gjithë periudhës së jetës së këtij instrumenti. Të dhëna të tilla përfshijnë çmime të kuotuarra për aktive ose detyrime të ngjashme në tregjet aktive, çmime të kuotuarra për instrumente identike në tregjet joaktive dhe të dhëna të mbikëqyrura përveç çmimeve të kuotuarra siç janë normat e interesit dhe kurbat e normës së interesit, paqëndrueshmëria e nënkuptuar dhe marzhi i kredisë. Për më tepër, rregullimet mund të kërkohen për gjendjen ose vendndodhjen e aktivit ose masën në të cilën lidhet me zërat që janë të krahasueshëm me instrumentin e vlerësuar. Sidoqoftë, nëse rregullime të tilla bazohen në inpute të pakontrollueshme të cilat janë domethënëse për tërë matjen, Banka do t'i klasifikojë instrumentet si Nivelit 3.
- **Instrumente financiare të Nivelit 3** - Ato instrumente që përmbajnë një ose më shumë të dhëna të pambikëqyrura që janë domethënëse për matjen në tërësi.

Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë që nuk janë listuar në një treg aktiv, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika të përshtatshme vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të vlerës aktuale neto, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat

ekzistojnë çmime të mbikëqyrura të tregut të dhe modele të tjera të vlerësimit. Teknika vlerësimi, siç janë modelet skontuara të fluksit monetar dhe modelet e bazuara në transaksionet e kryera në mënyrë të vullnetshme midis palëve të palidhura me njëra-tjetrën ose vlera kontabël neto e të dhënave financiare të investitorëve, përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuar financiarë për të cilët informacioni mbi çmimet e tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Banka vlerëson vlerën kontabël neto në secilën periudhë raportimi mbi bazën e instrumentit me instrument dhe riklasifikon instrumentet kur është e nevojshme, bazuar në faktet në fund të periudhës së raportimit.

Banka vlerëson vlerën kontabël neto në secilën periudhë raportimi mbi bazën e instrumentit me instrument dhe riklasifikon instrumentet kur është e nevojshme, bazuar në faktet në fund të periudhës së raportimit.

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE

I. Matja dhe klasifikimi

Instrumentet financiare klasifikohen sipas rregullave të SNRF 9 bazuar në:

- Modelin e biznesit të Bankës për administrimin e aktivit financiar dhe
- Karakteristikat kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare (referuar si "Testi VPPI").

Bazuar në kriteret e mësipërme, Banka klasifikon instrumentet financiare në një nga tre kategoritë e mëposhtme: (a) me koston e amortizuar (KA) (b) në VDATGJ dhe (c) në VDPFH.

Një aktiv financiar (d.m.th. Depozita dhe llogari me

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

I. Matja dhe klasifikimi (vazhdim)

bankat, Kreditë dhe paradhëniet e klientëve dhe investimeve të tjera financiare) matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale; dhe kushtet kontraktuale të tij krijojnë data të caktuara për flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar (VPPI).
- Një aktiv financiar matet në VDATGJ vetëm nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:
- ai është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është si mbajtja e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe shitjen e aktiveve financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të tij krijojnë data të caktuara për flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Të gjitha aktivet financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose VDATGJ siç përshkruhet më lart, maten në VDPFH. Për më tepër, në njohjen fillestare, Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një aktiv financiar që plotëson kërkesat e tjera që duhet të maten me koston e amortizuar ose në VDATGJ si në VDPFH nëse kjo e eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do

të lindte ndryshe. Banka nuk ka instrumente VDPFH deri në datën e raportimit.

Sipas SNRF 9, derivativët e përfshira në kontrata ku baza e kontratës është një aktiv financiar në fushën e SNRF 9 nuk qëndrojnë të ndarë. Përkundrazi, instrumenti financiar hibrid vlerësohet si një i tërë për klasifikim.

Banka ka finalizuar modelin e saj të biznesit, si dhe testimin VPPI dhe ka arritur në përfundimin si më poshtë:

- **Obligacione dhe portofoli i bonove të thesarit**
Për **produktet e thesarit** të Bankës (obligacionet dhe bonot e thesarit), modelet e identifikuara të biznesit janë **“Mbajtje për mbledhje” dhe “Mbajtje për mbledhje dhe shitje”** që kërkojnë matjen me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ) nëse edhe kushtet e Testit VPPI janë përmbushur.

Sipas SNRF 9 (4.1.2A), një aktiv financiar do të matet me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktivi financiar mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale, ashtu edhe nga shitja e aktiveve financiare dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar lindin në data të specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën e principalit të papaguar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Aktivitetet financiare VDATGJ janë matur më pas në vlerën e drejtë me fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim) I. Matja dhe klasifikimi (vazhdim)

ndryshimit në vlerën e drejtë të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ). Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutë njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja e HPK për aktivin financiar shpjegohet në shënimin 6.5 ii). Mbi çregjistrimin, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Tirana Bank nuk mban portofol të letrave me vlerë për qëllime tregtimi, me qëllimin e blerjes/shitjes në mënyrë aktive në varësi të vlerës së drejtë të aktiveve.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Aktivitetet financiare VDATGJ janë matur më pas në vlerën e drejtë me fitimet dhe humbjet që vijnë si rezultat i ndryshimit në vlerën e drejtë të njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ). Të ardhurat nga interesi dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutë njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar. Llogaritja e HPK për aktivin financiar shpjegohet në shënimin 6.5 ii). Mbi çregjistrimin, fitimet ose humbjet kumulative të njohura më parë në ATGJ janë riklasifikuar nga ATGJ në fitim ose humbje.

Tirana Bank nuk mban portofol të letrave me vlerë për qëllime tregtimi, me qëllimin e blerjes/shitjes në mënyrë aktive në varësi të vlerës së drejtë të aktiveve.

• **Huatë dhe paradhëniet për klientët**

Për huatë dhe paradhëniet e Bankës ndaj portofolit të klientëve, modeli i biznesit i identifikuar është modeli i biznesit “Mbajtje për mbledhje” dhe për këtë arsye, huatë e klasifikuara në këtë model biznesi do të maten me kosto të amortizuar nëse plotësohen edhe kushtet e testit VPPI. Çdo hua që do të dështojë në testin VPPI do të matet me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes. Sipas SNRF 9 (4.1.2), një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse plotësohen të dyja kushtet e mëposhtme:

- aktiviteti financiar mbahet brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë aktivet financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale dhe
- kushtet kontraktuale të aktivitetit financiar lindin në data të specifikuar të flukseve monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesi mbi shumën e principalit të papaguar.

Modeli i biznesit i Bankës është të krijojë kredi dhe të mbledhë flukset e tyre monetare kontraktuale. Çdo shitje e aktiveve financiare brenda këtij modeli biznesi kryhet për shkak të përkeqësimit të kreditimit të huasë dhe me qëllim zvogëlimin e kredive me problem (NPL, NPE) dhe në asnjë rast nuk pasqyron qëllimin fillestar të veprimtarisë së huadhënies.

Vlerësimet nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesi

Për qëllime të këtij vlerësimi, “principalit” përkufizohet si vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. ‘Interesi’ përcaktohet si vlera kontabël neto për vlerën në kohë të parasë, për rrezikun e kredisë të shoqëruar me shumën e principalit të mbetur papaguar në një periudhë të caktuar kohe dhe për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të huazimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), si dhe një marzh fitimi.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

I. Matja dhe klasifikimi (vazhdim)

Në mënyrë që të japë vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Banka merr në konsideratë kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar përmban një afat kontraktual që mund të ndryshojë kohëzgjatjen ose shumën e flukseve monetare kontraktuale të tillë që të mos mund të plotësojë këtë kusht.

Në bërjen e vlerësimit, Banka konsideron:

- ngjarje të mundshme që mund të ndryshojnë shumën dhe kohëzgjatjen e fluksit të parave;
- karakteristikat e levave;
- afatet zgjatjes dhe parapagimit;
- kushte që kufizojnë pretendimin e Bankës për flukse monetare nga aktive të specifikuar - p.sh. rregullimet e aktiveve pa rekurs; dhe
- tipare që modifikojnë vlerën kontabël neto për vlerën në kohë të parasë - p.sh. rivendosja periodike e normave të interesit.

Normat e interesit në huatë me pakicë të krijuara nga Banka bazohen në Normat e Brendshme që përcaktohen nën diskrecionin e Bankës. Në këto raste, Banka vlerëson nëse seti SFR është në përputhje me normat e tregut dhe i siguron Bankës kthime të mjaftueshme për të mbuluar:

- vlerën në kohë të parasë,
- rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe kohe të caktuar, dhe

- rreziqe dhe kosto të tjera bazë të huazimit, si dhe një marzh fitimi.

Të gjitha kreditë konsumatore të Bankave përmbajnë karakteristika të parapagimit. Një veçori e parapagimit është në përputhje me kriterin VPPI nëse shuma e parapagimit përfaqëson në mënyrë të konsiderueshme shumat e papaguara të principalit dhe të interesit mbi shumën kryesore të prapambetur, që mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm për ndërprerjen e parakohshme të kontratës.

II. Zhvlerësimi

Banka ka regjistruar provizionin për humbjet e pritshme të kredisë për të gjitha kreditë dhe aktivet e tjera financiare që nuk mbahen në VDFH, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Kjo kërkon vlerësim mbi ndryshimet në faktorët ekonomikë që ndikojnë në HPK, të cilat përcaktohen në bazë të ponderuar sipas probabilitetit. Përveç aktiveve financiare të matura me kosto të amortizuar, modeli i ri i zhvlerësimit ishte aplikuar edhe për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk maten me VDFH:

- aktivet financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- Angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi matej sipas SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Aktivet Kontingjente).

SNRF 9 kërkon të njihet një humbje e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore ose HPK-të e përjetshme në varësi të vlerësimit të rrezikut të dështimit. HPK-të e përjetshme janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha rastet e mundshme të dështimit gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar, ndërsa HPK-të

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

II. Zhvlerësimi (vazhdim)

12-mujore janë pjesë e HPK-ve që rezultojnë nga rastet e dështimit që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit.

Banka njeh humbjet e zbritshme në një shumë të barabartë me HPK-të e përjetshme, përveçse në rastet e mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë investuese të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët kreditor në datën e raportimit. Banka e konsideron një letër borxhi si një rrezik i ulët kredie kur vlerësimi i rrezikut të saj kreditor është ekuivalent me përkufizimin e kuptimit global të "klasës së investimit"; dhe
- huatë dhe letrat me vlerë investuese të borxhit për të cilat rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, dhe kështu që, ato klasifikohen në Fazën 1.

Kërkesat për zhvlerësim të SNRF 9 janë komplekse dhe kërkojnë gjykime, vlerësime dhe supozime të drejtimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme, të cilat diskutohen më në detaje më poshtë:

- Logaritja e input-eve kryesore në HPK si Probabiliteti i Dështimit (PD), Humbja në rast Dështimi (HD) dhe Ekspozimi në rast Dështimi (ED).
- vlerësimi nëse rreziku kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare; dhe
- përfshirja e informacionit të ardhshëm në matjen e HPK-ve.

HPK-të janë një vlerësim i ponderuar probabiliteti i humbjeve të kredisë dhe do të maten si më poshtë:

- aktive financiare që nuk janë kredituar-zhvlerësuar në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mungesave të parave - d.m.th. diferenca midis fluksit të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe fluksit të mjeteve monetare që Banka pret të marrë;
- aktivet financiare që janë zhvlerësuar nga kreditë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të fluksit monetare të ardhshme të vlerësuar;
- angazhimet e huasë të patërhequr: vlera aktuale e diferencës midis fluksëve të mjeteve monetare kontraktuale që i detyrohen Bankës nëse angazhimi dhe fluksit monetare që Banka pret të marrë tërhiqen; dhe
- kontratat e garancisë financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të rikuperojë.

• Të dhënat (Input-e) në matjen e HPK-ve

Të dhënat (inputet) kryesore në matjen e HPK-ve kanë të ngjarë të jenë struktura afatgjata të variablave në vijim: Probabiliteti i Dështimit (PD), Humbja në rast Dështimi (HD) dhe Ekspozimi në rast Dështimi (ED). Këto parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara nga brenda dhe të dhëna të tjera historike. Ato janë të përshtatura për të pasqyruar informacionin e ardhshëm siç përshkruhet më poshtë.

Nivelet e rrezikut kreditor do të jenë një kontribut primar në përcaktimin e strukturës afatgjatë të Probabilitetit të Dështimit për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të Probabilitetit të Dështimit së mbetur të ekspozimeve dhe se si këto pritjet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

II. Zhvlerësimi (vazhdim)

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e Dështimit dhe ndryshimeve në faktorët kryesorë makroekonomikë. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e PBB-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

- Humbje nga pagesat në vonesë (HPV) është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka mospagim nga huamarrësi. Banka vlerëson parametrat e Humbjes së Ardhur nga Mospagimi bazuar në historinë e niveleve të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të paracaktuara. Modelet e Humbjes së Ardhur nga Mospagimi marrin në konsideratë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivit financiar.
- Ekspozimi në rast Dështimi (ED) përfaqëson ekspozimin e pritshëm në rast të mospagesave. Ekspozimi në rast Dështimi i një aktivi financiar do të jetë vlera kontabël bruto në mospagim. Për angazhimet e huadhënies dhe garancitë financiare, Ekspozimi në rast Dështimi do të marrë parasysh shumë e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të nxirren ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrojtimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

Banka mat HPK-të duke marrë parasysh rrezikun e Dështimit për periudhën maksimale kontraktuale (përfshirë opsionet e zgjatjes së kredisë së huamarrësit) mbi të cilat është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë një pagesë paradhënie ose ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për overdraftet konsumatore dhe lehtësirat e kartës së kreditit dhe disa struktura rrotulluese të korporatave që përfshijnë si një hua dhe një përbërës të angazhimit të patërhequr, Banka mund të matë HPK-të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar ripagimin dhe anulimin e angazhimit të patërhequr nuk kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kredisë në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto lehtësira nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka vihet në dijeni për një rritje të rrezikut kreditor.

Megjithatë, kjo periudhë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut kreditor që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e lehtësirave që Banka ofron.

Kur modelimi i një parametri kryhet në bazë kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të rrezikut të përbashkët që përfshijnë:

- llojin e instrumentit/klientit; dhe
- klasifikimin i rrezikut kreditor.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim) II. Zhvlerësimi (vazhdim)

Grupimet do t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të caktuar të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit, në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna historike të kufizuara, informacionet e jashtme referuese të publikuara nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kredive si Moody's do të përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

PËRKUFIZIMI I DËSHTIMIT

Sipas SNRF 9, Banka e konsideron një aktiv financiar si të papaguar kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë plotësisht detyrimet e tij të kredisë ndaj Bankës, pa ndërhyrjen nga ana e Bankës me veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka mbajtje të tilla); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë pa i paguar një detyrim material kredie Bankës.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si nën standard, të dyshimta ose të humbura.

Identifikimi i karakteristikave të mëposhtme rezulton si mospagim.

a. Ditët e kaluara të pagesës. Ekspozimet më shumë

se 90 ditë me vonesë në datën e raportimit (duke përdorur efektin e tërheqjes prej 20% - në nivelin e debitorit).

b. Vështirësia për të paguar

c. Aktivi i zhvlerësuar i kredisë siç përcaktohet në kërkesat e SNRF 9

d. Ekspozime jo performuese të modifikuara

e. Ekspozime performuese të modifikuara gjatë periudhës së provës (24 muaj pas periudhës së kurimit) për të cilat masat e modifikuara janë zgjatur ose kanë më shumë se 90 ditë vonesë.

Inputet e përdorura për të vlerësuar në se një instrument financiar kategorizohet në mospagim, si dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethana.

Nivelet e rrezikut të kredisë

Banka shpërndan çdo ekspozim të biznesit me një shkallë rreziku të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Administrimit të Riskut të Kredisë, duke përdorur faktorë cilësor dhe sasior që janë tregues të rrezikut të dështimit. Përveç klasave të rrezikut të paraqitura për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron veçmas kreditë standarde të paguara me vonesë nga kreditë standarde jo të paguara me vonesë.

Çdo ekspozim biznesi është shpërndarë në një shkallë të rrezikut të kredisë në njohjen fillestare bazuar në informacionin e disponueshëm në lidhje me huamarrësit. Ekspozimet i nënshtrohen një monitorimi të vazhdueshëm, i cili mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një shkallë të ndryshme të rrezikut të kredisë.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

II. Zhvlerësimi (vazhdim)

- **Përcaktimi nëse rreziku kreditor është rritur ndjeshëm**

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku kreditor (për shembull rreziku i dështimit) të një instrumenti financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të marrë parasysh informacione të arsyeshme dhe të mbështetura që janë relevante dhe të disponueshme, pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacionin cilësor dhe sasior dhe analizën bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e ekspertëve të kredive dhe informacionin e ardhshëm.

Banka merr në konsideratë si kriteret sasiorë ashtu edhe cilësorë në mënyrë që të vlerësojë nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut kreditor. Elementi sasior llogaritet bazuar në ndryshimin e probabilitetit të dështimit për të gjithë jetën duke krahasuar:

- Probabilitetin e dështimit në datën e raportimit; me
- Probabilitetin e dështimit që u vlerësua bazuar në fakte dhe rrethana në kohën e njohjes fillestare të ekspozimit

Banka përcakton kriteret për rritjen sasiorë relative të probabilitetit të dështimit që janë tregues i një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë.

Banka ka vendosur tre lloje treguesish:

- a) primar,
- b) sekondar dhe
- c) ndalesa për të demonstruar prioritetin e treguesve

të përdorur për të vlerësuar nëse ka ndodhur një rritje e konsiderueshme e rrezikut të kredisë. Pavarësisht prioritetit të tyre, të gjithë kriteret kanë të njëjtën peshë në procesin e vlerësimit për rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor.

Treguesit primarë ose sekondarë mund të ndryshojnë për secilin portofol dhe përfshijnë, por pa u kufizuar në ndryshimet relative në jetëgjatësinë e probabilitetit të dështimit ndryshimet e vlerësimit të brendshëm/të jashtëm në nivele, ditë maksimale të vonuara përgjatë 6 muajve të fundit, aktivitetet e modifikuara, ndërsa treguesi i ndaluar është i pranishëm në kushtet e mëposhtme:

- Instrumente që kanë kaluar më shumë se 30 ditë

Të gjitha kreditë që tregojnë rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë klasifikohen në fazën 2.

Banka monitoron efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë me rishikime të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun kreditor para se një ekspozim të jetë në mospagim;
- koha mesatare midis identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe dështimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matjet e HPK-ve 12-mujore të kredia e zhvlerësuar

Aktivitetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të modifikohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientit dhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të kredisë aktuale ose

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim) II. Zhvlerësimi (vazhdim)

të mundshme të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilës janë modifikuar mund të çregjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerën e drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një aktivi financiar modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, Banka shqyrton nëse rreziku i kredisë së aktivit është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësor që ndikojnë në rrezikun e dështimit.

Banka ri-negocionuat për klientët në vështirësi financiare (të referuara si "aktivitete modifikuese") për të rritur mundësitë e grumbullimit dhe për të minimizuar rrezikun e dështimit. Sipas politikës së modifikimeve të Bankës, modifikimi i huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ekziston një rrezik i lartë i dështimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kushteve të kontratës fillestare dhe debitori pritët të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Kushtet e rishikuara zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të marrëveshjeve të huasë. Të dyja kreditë e tregtueshme dhe të biznesit janë subjekt i politikës së modifikimit.

Në përgjithësi, modifikimi është një tregues cilësor i vonesës dhe zhvlerësimit të kredisë dhe pritshmëritë

ndaj modifikimeve janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të kredisë. Pas modifikimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave të vazhdueshme gjatë njëzetekatër muajve përpara se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore.

Informacionet e ardhshme

Sipas SNRF 9, Banka do të inkorporojë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse rreziku kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matjen e HPK-ve. Banka do të formulojë një skenar bazë për drejtimin e ardhshëm të variablave përkatës ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshin zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetin relativ të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku Banka operon, organizata ndërkombëtare, siç janë Komisioni Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe sektori privat dhe parashikuesit akademikë të zgjedhur.

Rasti bazë paraqet një rezultat më të mundshëm dhe do të përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç është planifikimi strategjik dhe buxheti. Skenarët e tjerë paraqesin rezultat më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu do të kryejë në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e saj për këto skenarë të tjerë përfaqësues.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.5. AKTIVET DHE DETYRIMET FINANCIARE (vazhdim)

II. Zhvlerësimi (vazhdim)

Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të rrezikut kreditor dhe humbjeve të kredisë për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe, duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet midis variablave makro-ekonomikë dhe rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë. Këta drejtues kryesorë përfshijnë Indeksën e Çmimeve të Konsumit ("IÇK"), shkallën e papunësisë dhe parashikimet e indeksit të Produkteve të Brendshme Bruto ("PBB"). Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe niveleve të dështimit dhe humbjeve në portofole të ndryshme të aktiveve financiare janë zhvilluar bazuar në analizën e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

6.6. AKTIVE TË RIPOSEDUARA

Në rrethana të caktuara, kolaterali rivlerësohet pas konfiskimit të huave që janë në mospagim. Politika e Bankës është të përcaktojë nëse një aktiv i rikuperuar mund të përdoret më së miri për operacionet e saj brendshme apo duhet të shitet. Aktivët e përcaktuara si të dobishme për operacionet e brendshme të Bankës transferohen në kategorinë e tyre përkatëse të aktiveve me vlerën më të ulët të tyre të rivlerësimit ose me vlerën kontabël të aktivitet origjinal të siguruar. Aktivitet për të cilat shitja është përcaktuar si opsion më i mirë transferohen si inventarë ("aktive të rivlerësuar") derisa të përmbushen kriteret e njohjes për ta klasifikuar këto aktiv si "të mbajtur për shitje", nga ku ato maten me vlerën e tyre të drejtë (nëse janë

aktive financiare) dhe me vlerën e drejtë minus koston e shitjes për tu shitur si aktive jo-financiare në datën e rivlerësimit, në përputhje me politikën e Bankës. Si inventarët, këto aktive maten me koston më të ulët ose vlerën neto të realizueshme (SNK 2.9).

Për të përcaktuar nëse vlera neto e realizueshme e këtyre aktiveve ka pësuar rënie nën koston e tyre, Banka mbledh raporte të ndryshme vlerësimi nga disa vlerësues të pavarur dhe regjistron vlerësimet më të ulëta për secilën pronë përkatëse. Çdo rënie nën vlerën neto të realizueshme shfaqet si një shpenzim në periudhën në të cilën ndodh rënia. Çdo përmbysje shfaqet në pasqyrën e fitimit dhe humbjes në periudhën në të cilën ndodh përmbysja.

6.7. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTËT E SAJ

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përbëjnë bilancet e mjeteve monetare dhe depozitat e fondeve të investimit me një maturim origjinal prej tre muajsh ose më pak. Për qëllimin e Pasqyrës së Fluksit Monetar, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga mjete monetare në arkë, llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore dhe shumatat që i detyrohen bankat e tjera sipas kërkesës dhe me një maturim fillestar prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Rezerva statutore pranë Bankës Qendrore nuk është e disponueshme për veprimet ditore të Bankës dhe nuk përfshihet si një përbërës i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar. Detaje të mëtejshme se çfarë përmbajnë mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mund të gjenden në Shënimin 33.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

6.8. MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE MARRËVESHJET E ANASJELLA TË RIBLERJES

Letrat me vlerë të shitura nën marrëveshje për t'u riblerë në një datë të ardhshme të caktuar nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar pasi Banka mban në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Arkëtimet përkatëse të pranuar, përfshirë interesin e përlogarit, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si “detyrime ndaj bankave”, duke pasqyruar thelbin ekonomik të kredisë bankare. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzimi i interesit dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Ndërkohë letrat me vlerë të blera përmes marrëveshjeve për rishitje në një datë të ardhshme të specifikuar, marrëveshjet e anasjella të riblerjes (‘Marrëveshje të anasjellta të riblerjes’), regjistrohen si detyrime ndaj bankave të tjera ose hua dhe paradhënie për klientë, sipas rastit. Pagesat përkatëse të kryera, duke përfshirë interesin e përlogarit, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime ndaj bankave. Diferenca midis çmimit të blerjes dhe atij të rishitjes trajtohet si e ardhur nga interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

6.9. QIRAJA

Banka vlerëson fillimet e kontratës nëse një kontratë është, ose përmban, një qira. Që do të thotë, nëse

kontrata përmban të drejtën e kontrollit të përdorimit të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të përfitimeve.

I. Banka si Qiramarrës

Banka aplikon një qasje të vetme njohjeje dhe matjeje për të gjitha qiradhëniet, përveç qirave afatshkurtra dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët. Banka njeh detyrimet e qirasë për të bërë pagesa qiraje dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve bazë.

Aktivet me të drejtë përdorimi

Banka njeh aktivet me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë (d.m.th. data kur aktivi bazë është disponueshëm për përdorim). Aktivet me të drejtë përdorimi maten me kosto, minus çdo humbje të akumuluar dhe humbje nga zhvlerësimi, dhe rregullohen për çdo rivlerësim të detyrimeve të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin shumën e detyrimeve të njohura të qirasë, kostot fillestare direkte të marra mbi vete, dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, minus çdo stimulim qiraje të marrë. Aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Aktivt me të drejtë përdorimi paraqiten në Shënimin 24 për aktive afatgjata materiale dhe aktivt me të drejtë përdorimi dhe i nënshtrohen zhvlerësimit në përputhje me politikën e Bankës, siç përshkruhet në Shënimin 6.10 zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare.

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Banka njeh detyrimet e qirasë të matura me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të bëhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.9. QIRAJA (vazhdim)

I. Banka si Qiramarrës (vazhdim)

e qirasë përfshijnë pagesa fikse, minus çdo stimulim qiraje të arkëtueshme. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e periudhës të një opsioni blerjeje që do të ushtrohet në mënyrë të arsyeshme nga Banka dhe pagesa të penalteteve për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e opsionit të ndërprerjes.

II. Banka si Qiradhënës

Qiradhëniet në të cilat Banka nuk transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme nga një aktiv klasifikohen si qira operative. Të ardhurat që gjenerohen nga qiraja kontabilizohen mbi bazën lineare mbi kushtet e qirasë dhe përfshihen në të ardhura në pasqyrën e fitimit ose humbjes për shkak të natyrës së saj operative. Kostot e drejtpërdrejta fillestare të bëra në negociimin dhe rregullimin e një qiraje operative i shtohen vlerës kontabël të aktivit të marrë me qira dhe njihen gjatë afatit të qirasë mbi të njëjtën bazë si të ardhura nga qiraja. Qiratë e kushtëzuara njihen si të ardhura në periudhën në të cilën janë fituar.

6.10. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE AKTIVE ME TË DREJTË PËRDORIMI

Pronat dhe pajisjet paraqiten me kosto duke përjashtuar kostot e shërbimit të përditshëm, minus zhvlerësimin e akumuluar dhe zhvlerësimin e akumuluar në vlerë.

Aktivet me të drejtë përdorimi paraqiten së bashku me pronën dhe pajisjet në pasqyrën e pozicionit financiar - referojuni politikës së kontabilitetit në Shënimin 6.10. ku aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen mbi bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare për të regjistruar koston e pronës dhe pajisjeve me vlerat e tyre të mbetura përgjatë jetëve të tyre të vlerësuara të dobishme. Toka nuk zhvlerësohet. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si më poshtë:

- Ndërtesat e veta: deri në 20 vjet
- Mobilie dhe pajisje të tjera: 5 vjet
- Automjete: 5 vjet
- Njësia kompjuterike: 4 vjet
- Përmirësime të qiradhënies: shkurtësia e jetës së dobishme dhe afatit të qirasë.

Vlera e mbetur e aseteve dhe jeta e dobishme rishikohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur bëhet nxjerrja jashtë përdorimi e aktivit ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose nxjerrja e tij jashtë përdorimi. Çdo fitim ose humbje që vjen nga çregjistrimi i aktivit (llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto të nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivit) njihet në "Të ardhura të tjera operative" ose "Shpenzime të tjera operative" në fitimin ose humbjen e vitit kur aktivi çregjistrohet.

6.11. AKTIVE JO-MATERIALE

Aktivet jo-materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.11. AKTIVE JO-MATERIALE (vazhdim)

lineare përgjatë jetës së dobishme të pritshme të aktivitetit. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhat aktuale dhe krahasuese është si më poshtë:

	Në vite
Programe kompjuterike dhe aplikacione	4 - 10

6.12. ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE JO-FINANCIARE

Vlerat kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç aktiveve të tatimit të shtyrë dhe inventarëve, rishikohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose njësisë e tij gjeneruese e mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i aktiveve të identifikueshme që gjenerojnë flukset monetare që janë kryesisht të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare ndahen së pari për të zvogëluar vlerën kontabël të çdo emri të mirë të caktuar për njësitë dhe më pas për të zvogëluar vlerën kontabël të aktiveve të tjera në njësi (grupi i njësisë) mbi një bazë proporcionale.

Shuma e rikuperueshme e një aktivi ose njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe e saj në përdorim dhe vlera e drejtë e tij minus

koston e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të mjeteve monetare zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivitetin.

6.13. KONTRATAT E GARANCISË FINANCIARE

Kontratat e garancisë financiare kërkojnë që emetuesi të kryejë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për humbje që ai ndesh si pasojë e mosshlyerjes të një huamarrësi të caktuar në datën e detyrimit, në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit.

Këto garanci financiare u jepen bankave, institucioneve financiare dhe organizatave të tjera për llogari të klientëve për të siguruar kredi, paradhënie dhe produkte të tjera bankare. Garancitë financiare njihen fillimisht të pasqyrave financiare me vlerë të drejtë në datën kur garancia jepet. Pas njohjes fillestare, detyrimet e bankës në sajë të këtyre garancive maten me vlerën më të madhe midis matjes fillestare, minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitim ose humbje tarifat e fituara në mënyrë lineare përgjatë jetës së garancisë dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer çdo detyrim të garancisë financiare në datën e raportimit. Këto vlerësime përcaktohen në bazë të eksperiencës me transaksione të ngjashme dhe historikut të humbjeve, të mbështetur nga gjykimi i stafit drejtues. Çdo rritje në detyrim nga garancitë regjistrohet në fitim ose humbje si shpenzime të tjera operative. Garancitë dhe angazhimet financiare për të dhënë kredi, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, e cila evidentohet normalisht nga shuma e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetës së angazhimit.

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT (vazhdim)

6.14. BORXHI I EMETUAR DHE FONDE TË TJERA TË HUAZUARA

Borxhi i varur i emetuar njihet fillimisht në datën e tregtimit, d.m.th., datën në të cilën Banka bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit. Banka njihet detyrimet e obligacioneve të varura kur fondet i transferohen Bankës. Pas matjes fillestare, borxhi i varur i emetuar matet më pas me koston e amortizuar. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shpenzimet e interesit llogariten me normën nominale të interesit dhe njihen në fitim ose humbje kur llogariten. Interesi i përlllogaritur por i papaguar transferohet në llogarinë e të ardhurave dhe njihet si aktiv ose detyrim në llogarinë “interesi i përlllogaritur”.

6.15. PËRFITIMET E PUNONJËSVE

Banka paguan kontribute në planet e pensioneve të punonjësve të saj sipas kërkesave të legjislacionit vendaspërsigurimetshoqërore. Detyrimet për pensione të Bankës, lidhen vetëm me plane me kontribut të përcaktuar. Planet me kontribut të përcaktuar, të bazuar mbi pagat, bëhen me institucionin e administruar nga Shteti (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme pas pagesës së kontributit. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato lindin dhe njihen si shpenzime personeli në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse. Banka nuk ka asnjë plan pensioni sipas SNK 19.

6.16. PROVIZIONET

Provizionet njihen kur banka ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shuma mund të matet me besueshmëri. Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e daljes së burimeve për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë kategorinë e detyrimit si të ishte një. Një provizion njihet edhe nëse mundësia e daljes së burimeve në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën kategori detyrimesh mund të jetë e vogël.

Provizionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut në lidhje me vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të lidhura me detyrimin. Rritja në provizion me kalimin e kohës njihet si shpenzim interesi.

6.17. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin paraqiten në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi ose të miratuar nga ana thelbësore deri në datën e raportimit. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse nëse nuk është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse kur lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi aktual

Aktivitet dhe detyrimet aktuale tatimore për vitin në vazhdim dhe vitet e mëparshme maten me shumën që pritet të merret apo t'u paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore që përdoren për

6. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

(vazhdim)

6.17. TATIMI MBI FITIMIN (vazhdim)

të përlogaritur shumën janë ato që janë në fuqi apo konsiderohen të miratuara në parim duke filluar nga data e raportimit 2024: 15% (2023: 15%).

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet kundrejt diferencave të përkohshme midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël për raportim financiar në datën e raportimit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme, përveç rasteve kur detyrimi tatimor i shtyrë rezulton nga njohja fillestare e emrit të mirë ose e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitimi kontabël dhe as fitimi ose humbja e tatueshme.

Aktivet tatimore të shtyra njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, kreditimet tatimore të pashfrytëzuara dhe humbje tatimore të pashfrytëzuara, deri në atë masë sa është e mundshme që fitimi i tatueshëm të jetë i disponueshëm, kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, kundrejt të cilave diferencat e përkohshme të zbritshme dhe kreditimet dhe humbjet tatimore të bartura mund të përdoren, do të jenë të disponueshme, përveç rasteve kur aktivi tatimor i shtyrë që lidhet me diferencat e përkohshme të zbritshme rezulton nga njohja fillestare e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në kohën e transaksionit, nuk ndikon fitimin kontabël apo fitim ose humbjen e tatueshme.

Vlera kontabël e aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në atë masë sa nuk është më e mundur që fitimi i tatueshëm të jetë të gjithë ose një pjesë të aktivitetit tatimor të shtyrë që të shfrytëzohet. Aktivitetet e panjohura e tatimeve të shtyra rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen në atë masë që është bërë e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm të lejojë rikuperimin e aktivitetit tatimor të shtyrë. Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra maten me normat e taksave që pritet të zbatohen në vitin kur aktivi është realizuar ose detyrimi është shlyer, bazuar në tarifatat tatimore (dhe ligjet tatimore) që janë në fuqi ose konsiderohen si të miratuar në parim në datën e raportimit.

Aktivet tatimore të shtyra dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e ligjshme që të kompensojë aktivitetet tatimore aktuale kundrejt pasiveve tatimore aktuale dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtën njësi ekonomike dhe të njëjtin organ tatimor. Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali kur ato miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendët e ndërmjetëm janë zbritur nga kapitali kur deklarohen dhe nuk është më nën diskrecionin e Bankës.

6.18. KAPITALI

Elementet e kapitalit janë kapitali aksionar, primi i aksioneve dhe rezervat. Rezervat përfshijnë rezervën ligjore dhe të përgjithshme (Shënimi 32), rezervën e bashkimit dhe rezervën e vlerës së drejtë. Rezervat e vlerës së drejtë përfshijnë ndryshimin kumulativ neto në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit të klasifikuar në VDATGJ, minus provizionin për HPK. Lëvizjet e elementeve të kapitalit neto janë shpalosur në shënimin 22.

7. STANDARDE TË PUBLIKUARA, POR ENDE JO EFEKTIVE

7.1. STANDARDE DHE INTERPRETIME TË REJA DHE TË NDRYSHUARA

Banka nuk ka miratuar më herët ndonjë standard të ri, interpretim apo ndryshim që është nxjerrë por nuk është ende efektiv në këto pasqyra financiare.

Ndryshime dhe interpretime të tjera zbatohen për herë të parë në vitin 2023, por nuk kanë ndikim në pasqyrat financiare të Bankës, të përshkruara shkurtimisht më poshtë:

- **SNRF 17: Kontratat e sigurimit** – Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2024 me aplikim më të hershëm të lejuar, me kusht që njësia ekonomike të zbatojë gjithashtu SNRF 9 Instrumentet Financiare në ose përpara datës kur zbatohet për herë të parë SNRF 17. Ky është një gjithëpërfshirës standard i ri i kontabilitetit për kontratat e sigurimit, që mbulon njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit të lëshuara, si dhe për garancitë dhe instrumentet financiare të caktuara me kontrata pjesëmarrjeje diskrecionale. Banka nuk lëshon kontrata në objektin e SNRF 17; prandaj zbatimi i tij nuk ka ndikim në performancën financiare, pozicionin financiar ose flukset monetare të Bankës.
- **SNK 12 Tatimet mbi të ardhurat: Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që lindin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet)** – Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2024 me aplikim më të

hershëm të lejuar. Ndryshimet ngushtojnë objektin dhe japin qartësi të mëtejshme për përjashtimin e njohjes fillestare sipas SNK 12 dhe specifikojnë se si kompanitë duhet të llogarisin për tatimin e shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm, të tilla si qiratë dhe detyrimet e nxjerrjes jashtë përdorimit. Ndryshimet sqarojnë se kur pagesat që shlyejnë një detyrim janë të zbritshme për qëllime tatimore, është çështje gjykimi, duke pasur parasysh ligjin tatimor në fuqi, nëse këto zbritje i atribuohen për qëllime tatimore detyrimit ose përbërësit të aktivit përkatës. Sipas ndryshimeve, përjashtimi i njohjes fillestare nuk zbatohet për transaksionet që, në njohjen fillestare, krijojnë diferenca të përkohshme të barabarta të tatueshme dhe të zbritshme. Ai zbatohet vetëm nëse njohja e një aktivi me qira dhe pasivi i qirasë (ose pasivi i çaktivizimit dhe komponenti i aktivitetit të çmontimit) sjellin diferenca të përkohshme të tatueshme dhe të zbritshme që nuk janë të barabarta. Amendamenti mund të ketë një ndikim në kontabilitetin e qirasë nga banka ku njohja e detyrimit të qirasë dhe e të drejtës së përdorimit të aktiveve zakonisht sjellin diferenca të përkohshme që janë pothuajse të barabarta.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare dhe Deklarata e Praktikave të SNRF 2: Shpalosja e politikave kontabël (Ndryshimet)**. Ndryshimet prezantojnë udhëzime të reja për zbatimin e konceptit të materialitetit dhe në veçanti ndryshon kërkesën për të shpalosur politikat kontabël materiale në vend të kërkesës aktuale për të shpalosur politika të rëndësishme kontabël. Kjo mund të çojë në heqjen e dhënies së informacioneve shpjeguese të politikave kontabël jo materiale.

7. STANDARDE TË PUBLIKUARA, POR ENDE JO EFEKTIVE (vazhdim)

7.1. STANDARDE DHE INTERPRETIME TË REJA DHE TË NDRYSHUARA (vazhdim)

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurtra dhe afatgjata (Ndryshime).** Amendamenti ka sjellë disa sqarime në lidhje me klasifikimin në rastet e të drejtave për të shtyrë zgjidhjen ose respektimin e marrëveshjeve. Banka paraqet aktivet dhe detyrimet e saj sipas likuiditetit, megjithatë ajo ofron informacione shpjeguese aktuale dhe afatgjata në shënime. Si rezultat, ndikimi i ndryshimit pritet të jetë i kufizuar.
- **SNK 8 Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet: Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshime).** Ndryshimet hyjnë në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 Janar 2024 me aplikimin më të hershëm të lejuar dhe zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël dhe ndryshimet në vlerësimet kontabël që ndodhin në ose pas fillimit të asaj periudhe. Ndryshimet prezantojnë një përkufizim të ri të vlerësimeve kontabël, të përcaktuara si shuma monetare në pasqyrat financiare që i nënshtrohen pasigurisë në matje, nëse ato nuk rezultojnë nga një korrigjim i gabimit të periudhës së mëparshme. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë se cilat janë ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe si ndryshojnë këto nga ndryshimet në politikat kontabël dhe korrigjimet e gabimeve. Efekti i këtyre ndryshimeve është subjekt i natyrës së ndryshimeve të ardhshme në politika dhe vlerësime.
- Ndryshimet e mëposhtme janë efektive për

periudhat pas datës 31 Dhjetor 2024 dhe nuk pritet të kenë një ndikim material në Bankë.

- Klasifikimi i pasiveve si korente ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)
- Marrëveshjet financiare të furnizuesit (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)
- Detyrimet afatgjata me marrëveshje (Ndryshimet në SNK 1)
- Mungesa e shkëmbyeshmërisë (Ndryshimet në SNK 21)

8. GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME TË RËNDËSISHME TË KONTABËL

Banka bën vlerësime dhe gjykime që prekin shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet çmohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme sipas rrethanave.

a) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Matja e humbjeve nga zhvlerësimi si në SNRF 9 për të gjitha kategoritë e aktiveve financiare në fushëveprim kërkon gjykim, në veçanti, vlerësimin e shumës dhe kohën e flukseve monetare të ardhshme dhe vlerave të kolateralit gjatë përcaktimit të humbjeve nga zhvlerësimi dhe vlerësimit të një rritje të konsiderueshme të rrezik të kredisë. Këto vlerësime nxiten nga një numër faktorësh, ndryshime të cilat mund të rezultojnë në nivele të ndryshme zbritjesh. Llogaritjet HPK të Bankës janë rezultate të modeleve komplekse me një numër

8. GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME TË RËNDËSISHME TË KONTABËL (vazhdim)

a) Humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve (vazhdim)

supozimesh themelore në lidhje me zgjedhjen e inputeve variabël dhe ndërvarësitë e tyre. Elementet e modeleve HPK që konsiderohen gjykime dhe vlerësime kontabël përfshijnë:

- Modeli i klasifikimit të kredisë së brendshme të Bankës, i cili cakton Probabilitetin e Dështimit sipas klasave individuale.
- Kriteret e Bankës për të vlerësuar nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe kështu zbritjet për aktivet financiare duhet të maten në bazë të LTHPK dhe vlerësimit cilësor.
- Segmentimi i aktiveve financiare kur HPK i tyre vlerësohet në bazë kolektive.
- Zhvillimi i modeleve HPK, përfshirë formulat e ndryshme dhe zgjedhjen e inputeve.
- Përcaktimi i pjesëmarrjeve përmes skenarëve makroekonomikë dhe inputeve ekonomike, siç janë nivelet e papunësisë dhe vlerat e kolateralit, dhe efekti tek PM, EM, dhe HM.
- Përzgjedhja e skenareve makroekonomike të ardhshme në kërkim dhe peshimi i probabilitetit të tyre, për të nxjerrë inputet ekonomike në modelet HPK.
- HPV e letrave me vlerë të qeverisë përcaktohet nga HPV specifike duke iu referuar mospagimit të borxheve sovraane që u përkasin qeverive që kanë vlerësim të ngjashëm me qeveritë të cilave u përkasin letrat me vlerë të Bankës;
- PD-të specifike të lidhura me palën tjetër pasqyrojnë rrezikun e palës tjetër.
- PD-ja e letrave të tjera jo sovraane përfaqëson HM-në e letrës me vlerë specifike.

Ka qenë politika e Bankës rishikimi në mënyrë të rregullt i modeleve të saj në kontekstin e përvojës aktuale të humbjes dhe të rregullojës kur është e nevojshme.

Vihet re se FLI për vitin 2024 nuk u materializua në masën e pritshme në rritje të probabilitetit të falimentimit dhe cilësia e portofolit të kredisë është mbajtur në nivele të mira. Banka ka kryer vlerësimet e saj duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit lidhur me tensionet gjeo-politike, inflacionin dhe evolucionin e normave të interesit dhe pritshmëritë, si dhe ka vlerësuar kriza potenciale të orientuara me specifikisht me vendin tone. Këto vlerësime janë reflektuar në faktorizimin e FLI për 2025. Vlerësimi i mundshëm i performancës është bazuar si në vlerësime individuale ashtu edhe në ato kolektive, duke identifikuar klientët që mund të jenë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve makroekonomike, duke përfshirë evoluimin e normave të interesit, dhe ndikimin e tyre në cilësinë e përgjithshme të portofolit të kredisë. Banka konsideron se FLI-të e zbatuara për vitin 2025 mbulojnë pritshmëritë e bankës në skenarin bazë dhe më të pafavorshëm.

b) Vlera e drejtë e instrumentit financiar

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt në tregun kryesor (ose më të favorshëm) në datën e matjes në kushtet aktuale të tregut (d.m.th., një çmim dalje) pavarësisht nëse ai çmim është drejtpërdrejt i mbikëqyrrur ose i çmuar nëpërmjet përdorimit të teknike tjetër vlerësimi. Kur vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet e mbikëqyrrura, ato përcaktohen duke përdorur një larmi teknikash vlerësimi që përfshijnë përdorimin e modeleve të

8. GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME TË RËNDËSISHME TË KONTABËL (vazhdim)

b) Vlera e drejtë e instrumentit financiar (vazhdim)

vlerësimit. Inputet në këto modele merren nga tregjet e mbikëqyrura kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, vlerësimi kërkohet në përcaktimin e vlerave të drejta. Gjykimet dhe vlerësimet përfshijnë shumatat e likuiditetit dhe inputeve të modelit që lidhen me zëra të tillë si rreziku i kredisë (si i Bankës ashtu dhe i kundërpartisë), rregullimet e vlerës së financimit, lidhjen reciproke dhe paqëndrueshmërinë. Për më shumë detaje rreth përcaktimit të vlerës së drejtë, ju lutemi shikoni Shënimin 6.4 dhe Shënimin 9.4.

c) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse tatimet dhe interesat shtesë mund të jenë detyrim për tu paguar. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një seri gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacioni i ri mund të bëhet i disponueshëm në mënyrë që Banka të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; ndryshime të tilla në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore në periudhën kur është bërë një përcaktim i tillë.

d) Aktivitet tatimore të shtyra

Aktivitet tatimore të shtyra njihen me diferencat e përkohshme në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm, ndaj të cilit mund të përdoren humbjet. Kërkohet gjykim për të përcaktuar shumën e aktiveve tatimore të shtyra që mund të njihen, bazuar mbi kohëzgjatjen e mundshme

dhe nivelin e fitimeve të tatueshme të ardhshme, së bashku me strategjitë e planifikimit të tatimit në të ardhmen.

e) Rreziku i çështjeve gjyqësore

Drejtimi i Bankës ka krijuar një proces të brendshëm në lidhje me njohjen dhe matjen e provizioneve dhe detyrimeve të kushtëzuara për shkak të çështjeve gjyqësore aktuale ose të paralajmëruara. Supozimet kryesore në lidhje me gjasat dhe madhësinë e një rrjedhje të burimeve bazohen në këshillat juridike të brendshme dhe të jashtme, duke ndjekur strategjitë përkatëse të suksesshme mbrojtëse kundër veprimeve pasuese. Çdo veprim dhe rrezik përkatës vlerësohet në bazë të meritave të tij dhe nga detyrimi thelbësor konstruktiv ose ligjor dhe vlerësimi i flukseve monetare që konsiderohen të pagueshme. Drejtimi beson se procese gjyqësore ekzistuese ose të mundshme në të ardhmen janë të largëta, megjithatë për shkak të shkaqeve përtej sfondit dhe kornizës ligjore mund të nxiten rreziqe të mëtejshme.

f) Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me opsione rinovimi dhe ndërprerje (Banka si qiramarrëse)

Banka e përcakton afatin e qirasë si afat të paanullueshëm të qirasë, së bashku me çdo periudhë të mbuluar nëpërmjet opsionit për ta zgjatur qiranë nëse ka siguri të arsyeshme se mund ta aplikojë, ose të çdo periudhë të mbuluar nëpërmjet një opsioni për të ndërprerë qiranë, nëse ka siguri të arsyeshme se mund ta aplikojë. Banka ka shumë kontrata qiraje që përfshijnë opsionin e zgjatjes dhe ndërprerjes së kontratës. Banka aplikon gjykimin për të vlerësuar nëse ka siguri të arsyeshme se mund ta aplikojë apo jo mundësinë e rinovimit ose përfundimit të qirasë. Kjo do të thotë, i konsideron të gjithë faktorët e rëndësishëm

8. GJYKIME, VLERËSIME DHE SUPOZIME TË RËNDËSISHME TË KONTABËL (vazhdim)

f) Përcaktimi i afatit të qirasë për kontratat e qirasë me opsione rinovimi dhe ndërprerje (Banka si qiramarrëse) (vazhdim)

që krijojnë një nxitje ekonomike për të që të ushtrojë ose opsionin e rinovimit ose të ndërprerjes së kontratës. Pas datës së fillimit, Banka rivlerëson afatin e qirasë nëse ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim në rrethanat që janë nën kontrollin e saj që ndikon në aftësinë e saj për të ushtuar ose për të mos ushtuar mundësinë e rinovimit ose ndërprerjes së kontratës (p.sh., krijimi i përmirësimeve të rëndësishme të qirasë ose përshtatjen e rëndësishme të aktivitetit të dhënë me qira).

g) Vlerësimi i normës rritëse të huamarrjes

Banka nuk mund të përcaktojë menjëherë normën e interesit të nënkuptuar në qira, prandaj, përdor normën e saj rritëse të interesit të huamarrjes ("IBR") për të matur detyrimet e qirasë. IBR është norma e interesit që Banka do të duhet të paguante për të marrë hua për një afat të ngjashëm, dhe me një siguri të ngjashme, fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me një vlerë të ngjashme me aktivin me të drejtë përdorimi në një mjedis të ngjashëm ekonomik. Prandaj, IBR pasqyron atë që Banka "do të duhet të paguante", e cila kërkon vlerësim kur nuk janë në dispozicion norma të mbikëqyrura ose kur ato duhet të rregullohen për të pasqyruar afet dhe kushtet e qirasë.

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

Aktivitetet e Bankës e ekspozojnë atë në një sërë rreziqesh financiare dhe ato aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe administrimin e një shkalle rreziku ose kombinimi të rreziqeve. Marrja e rrezikut është thelbësore për biznesin financiar, dhe rreziqet operacionale janë një pasojë e pashmangshme e të qenët në biznes. Qëllimi i Bankës është të arrijë një ekuilibër të duhur midis rrezikut dhe kthimit dhe të minimizojë efektet e mundshme negative në performancën financiare të Bankës.

Politikat e administrimit të rrezikut të Bankës janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar këto rreziqe, për të vendosur kufijtë dhe kontrollet e duhura të rreziqeve, dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve me anë të sistemeve të besueshme dhe të azhurnuara të informacionit. Banka rishikon rregullisht politikat dhe sistemet e saj të administrimit të rrezikut për të pasqyruar ndryshimet në tregjet, produktet dhe praktikatat më të mira të shfaqura.

Administrimi i rrezikut kryhet nga një departament i pavarur i rrezikut në Bankë nën politikat e aprovuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi siguron parime të shkruara për administrimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, të tilla si, rreziku i kreditit, rreziku i këmbimit valutor, rreziku i normës së interesit dhe rreziku i likuiditetit. Për më tepër, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të menaxhimit të rrezikut dhe mjedisit të kontrollit.

Llojet më të rëndësishme të rreziqeve të adresuara nga Banka janë rreziku i kredisë, rreziku i likuiditetit, rreziku i tregut dhe rreziku operacional. Rreziku i tregut përfshin

rrezikun e monedhës, normën e interesit dhe rrezikun e çmimit. Ai është gjithashtu subjekt i rrezikut të vendit dhe rreziqeve të ndryshme operative dhe biznesi.

9.1. RREZIKU I KREDISË

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes për Bankën, që rrjedh nga mos përmbushja e mundshme e detyrimeve kontraktuale të kundërpartisë. Tirana Bank bën analizën e spektrit të plotë të rrezikut të kredisë, përfshirë nënkategoritë e tij, siç janë rreziku i huazimit, rreziku i kundërpartisë, rreziku i emetuesit, rreziku i shlyerjes, rreziku i përqendrimit, rreziku i huadhënies në monedhë të huaj, rreziku sovran dhe rreziku i mbetur. Një vlerësim i tillë përkthehet në vlerësimin e brendshëm të nevojës së kapitalit për rrezik kredie. Rreziku i kredisë është rreziku më material për bankën që kërkon pjesën më të madhe të kapitalit minimal dhe rrjedh kryesisht nga aktivitetet e huadhënies (kredi dhe paradhënie) për klientët dhe investimet në letrat me vlerë të paraqitura në strukturën e tij të bilancit. Ekspozimet në dhe jashtë bilancit janë analizuar në lidhje me humbjen e mundshme që ato mund të prodhojnë dhe sigurohen në përputhje me rrethanat, sipas metodologjive të dokumentuara të provizionimit, të aprovuara nga Këshilli Drejtues.

Parimet e Bankës për Qeverisjen e Korporatës sigurojnë ndarjen e duhur të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë bazuar në origjinën e rrezikut, duke synuar përafrimin e procesit të marrjes së rrezikut me oreksin e rrezikut. Ekspozimi i Bankës ndaj rrezikut të kredisë monitorohet rregullisht në lidhje me oreksin e rrezikut të aprovuar duke siguruar që profili i rrezikut të Bankës të mbetet brenda niveleve të pranueshme. Devijimet, nëse ka, nga oreksi i rrezikut përshkallëzohen sipas Këshillit Drejtues.

Objektivat kryesore të Menaxhimit të Riskut të Kredisë së Bankës janë:

1. Vendosja e politikave të centralizuara në përputhje me kërkesat e Bankës Qendrore;
2. Monitorimi i portofolit të Bankës të ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë;
3. Administrimi i rrezikut në mënyrë aktive për të identifikuar dhe analizuar rrezikun në një fazë të hershme;
4. Krijimi i një funksioni të administrimit të rrezikut të pavarur nga linjat tregtare të biznesit;
5. Integrimi i funksionit të administrimit të rrezikut në procesin organizativ të biznesit;
6. Raportimi mbi rrezikun në të gjithë organizatën.

Komiteti i Auditit dhe Departamenti i Auditimit të Brendshëm ndjekin pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat.

9.1.1. Matja e rrezikut të kredisë

Rreziqet e Bankës maten duke përdorur një metodë që pasqyron humbjen e pritshme që mund të ndodhë në rrethana normale dhe humbjet e papritura, të cilat janë një vlerësim i humbjes aktuale përfundimtare bazuar në modelet statistikore. Modelet përdorin probabilitete që rrjedhin nga përvoja historike, të përshtatura për të pasqyruar mjedisin ekonomik. Banka drejton gjithashtu skenarët e rasteve më të këqija që mund të lindin në rast se ndodhin në fakt ngjarje ekstreme që nuk ka gjasa të ndodhin.

Monitorimi dhe kontrolli i rreziqeve kryhet kryesisht në bazë të limiteve të vendosura nga Banka. Këto kufizime pasqyrojnë strategjinë e biznesit dhe mjedisin e tregut të Bankës si dhe nivelin e rrezikut që Banka është e gatshme të pranojë, me theksim shtesë në industritë

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.1. Matja e rrezikut të kredisë (vazhdim)

e përzgjedhura. Për më tepër, politika e Bankës është të masë dhe monitorojë kapacitetin e përgjithshëm të mbajtjes së rrezikut në lidhje me ekspozimin e përgjithshëm të rrezikut në të gjitha llojet dhe aktivitetet e rrezikut.

Procedurat e përshkruara si vijon lidhen me vlerësimin e rrezikut të kredisë për qëllime operacionale, për raportimet rregullatore lokale si dhe kërkesat ligjore. Provigjonet e humbjeve nga kreditë dhe paradhëniet janë përcaktuar bazuar në procedurën e shpalosur në shënimin 9.1.3.

a) Huatë dhe paradhëniet

Në matjen e rrezikut të kredisë së huasë dhe paradhëniet për klientët dhe bankat në nivel kundërpattie, Banka pasqyron tre komponentë I. probabilitetin e dështimit nga klientët ose bankat për detyrimet e tyre kontraktuale; II. ekspozimet aktuale ndaj palës tjetër dhe zhvillimi i mundshëm i saj në të ardhmen, nga e cila Banka nxjerr "ekspozimin në dështim"; dhe III. raportin e mundshëm të rikuperimit të detyrimeve të pashlyera ("humbje nga pagesat në vonesë").

Banka vlerëson probabilitetin e mospagimit të palëve individuale të biznesit përmes analizës së mospagimit brenda grupeve me karakteristika të ngjashme. Prandaj, Banka përdor një klasifikim të brendshëm për klientët e biznesit të cilët janë të grupuar në pesë kategori më të mëdha. Kjo do të thotë që, në

parim, ekspozimet migrojnë ndërmjet klasave ndërsa vlerësimi i probabilitetit të tyre për mospagim ndryshon. Në lidhje me ekspozimet ndaj bankave dhe qeverive, Banka përdor kryesisht vlerësimet e prodhuara nga agjencitë e jashtme të vlerësimit, veçanërisht Moody's, dhe për rrjedhojë probabilitetin specifik të dështimit të palës tjetër, siç është marrë nga vlerësimet e Moody's. Grupet e klasifikimit të brendshëm të bankës:

- I shkëlqyeshëm
- I kënaqshëm
- I dobët
- Në ndjekje
- Në dështim

GRUPI I SHKËLQYER:

I referohet kompanive që paraqesin performancë të shkëlqyer sipas kriterëve të mëposhtme:

- struktura dhe cilësia e aktiveve
- baza e kapitalit dhe kapaciteti i fortë për të mbledhur kapital shtesë
- përfitueshmëri e qëndrueshme dhe e përsëritur
- gjenerimi i likuiditetit dhe rrjedhës së parasë
- aftësia dhe efektiviteti i administrimit
- pozicioni dominues në një industri që shfaq perspektiva pozitive afatmesme
- Vlerësohet se aftësia e kompanisë për të respektuar detyrimet afatshkurtra do të dëmtohet minimalisht nga çdo kusht i përkohshëm i pafavorshëm në mjedisin ekonomik dhe të biznesit.

GRUPI I KËNAQSHËM:

Përfshin tre vlerësime të brendshme në mënyrë specifike: të fortë, të mirë dhe të kënaqshëm. Ky grup i referohet kompanive që paraqesin performancë të fortë, të mirë dhe të kënaqshme sipas kriterëve të mëposhtme:

- struktura dhe cilësia e aktiveve

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.1. Matja e rrezikut të kredisë (vazhdim) **a) Huatë dhe paradhëniet (vazhdim)**

- baza e kapitalit dhe kapaciteti për të mbledhur kapital shtesë
- përfitueshmëri e përsëritur
- gjenerimi i likuiditetit dhe rrjedhës së parasë
- administrimi
- pozicioni në një industri dhe perspektivat afatmesme

Vlerësohet se aftësia e kompanisë për të respektuar detyrimet afatshkurtra do të dëmtohet në një shkallë të vogël/të kontrollueshme nga çdo kusht i përkohshëm i pafavorshëm në mjedisin ekonomik dhe të biznesit.

GRUPI I DOBËT:

Ai përfshin tre vlerësime të brendshme në mënyrë specifike: i përshtatshëm, i dobët dhe i varfër. Ky grup i referohet kompanive që paraqesin performancë të pranueshme, të dobët dhe të varfër sipas kritereve të mëposhtme:

- struktura dhe cilësia e aktiveve
- baza e kapitalit (kapaciteti i mundshëm i dëmtuar për të mbledhur kapital shtesë, vlerë neto e dobët ose negative)
- përfitueshmëri marginale, jo e përsëritur
- likuiditeti i përkeqësuar ose i kufizuar dhe gjenerimi i flukseve monetare
- dobësitë administrative
- pjesëmarrja në një industri që shfaq luhatje ose me kushte dhe perspektiva të përkeqësuar

Vlerësohet se çdo kusht i përkohshëm, i pafavorshëm

në mjedisin ekonomik dhe të biznesit, ndoshta do të çojë në përmbushje të kushtëzuara të detyrimeve ose klienti ka probabilitet relativisht të lartë për pagesa në vonesë / pamundësi për të përmbushur detyrimet.

GRUPI NË NDJEKJE:

I referohet kompanive që paraqesin:

- përkeqësim material i gjendjes financiare
- kushtet materiale të pafavorshme ndaj industrisë në të cilën ata marrin pjesë
- ndryshime të padëshirueshme në strukturën e aksionarëve ose administrimit ose probleme serioze administruese
- ngjarje që kërkojnë vëmendje të veçantë (zjarri, përmytja, grevat, ankandi i detyruar i aktiveve, zvogëlimi i vlerës së sigurisë etj.)
- probabilitet i lartë për mos përmbushje/pamundësi për të përmbushur detyrimet
- vonesë e parakohshme (deri në 90 ditë) Kërkesë për akumulimin e interesit.

GRUPI NË DËSHTIM

Ky grup përfshin tre vlerësime të brendshme në mënyrë specifike: Ristrukturim të vështirë, Nën standard dhe I Dyshimtë/I Humbur.

Vlerësimi i brendshëm i ristrukturimit në vështirësi

Zakonisht u referohet huamarrësve të kategorizuar si me vonesë të përkohshme mbi nëntëdhjetë (90) ditë (Nën standard) dhe me vonesë të përhershme (të dyshimta / humbje), të cilat më pas ristrukturohen me vendim të Bankës ose dekret ministror ose ligj. Gjithashtu, u referohet kompanive kreditë e të cilave, edhe nëse nuk klasifikohen si me vonesë të përkohshme mbi nëntëdhjetë (90) ditë (nënstandarte) ose me vonesë të përhershme (të dyshimta / humbje), janë ristrukturuar në atë mënyrë që ristrukturimi të çojë

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.1. Matja e rrezikut të kredisë (vazhdim) **a) Huatë dhe paradhëniet (vazhdim)**

në një ulje të vlera ekonomike e ekspozimit të Bankës (ristrukturim në vështirësi).

Në mënyrë indikative, përmenden rastet e mëposhtme të ristrukturimit në vështirësi:

- Ristrukturimi i kushteve të shlyerjes së borxhit (d.m.th. ulja e normës së interesit, zgjatja e afatit) në një nivel që Banka, në rrethanat e zakonshme, nuk do t'u jepte klientëve me aftësi të ngjashme kreditore.
- Reduktimi i shumës së të arkëtueshmeve të Bankës me njohjen e njëkohshme të humbjes ose provizionin përkatës.

Në kuadrin e një ristrukturimi të borxhit dhe në raste të veçanta, organi miratues i autorizuar mund të marrë në konsideratë financime shtesë. Pretendim me interes ose pa interes, sipas vendimit të Bankës.

Vlerësimi i brendshëm nën standard

I referohet kompanive që manifestojnë vonesë mbi nëntëdhjetë (90) ditë, e cila pritet të zgjidhet në një periudhë të shkurtër kohore, pa iu drejtuar veprimeve gjyqësore.

Kompanitë mund të klasifikohen edhe si Nënstandarte nëse shfaqin probabilitet të lartë mospagimi/pamundësie për të përmbushur detyrimet e tyre (kriteret subjektive); ende Banka nuk ka nevojë të mbështetet në veprimet gjyqësore. Shlyerja e plotë e detyrimit të borxhit është në pikëpyetje, ndërkohë që

është i mundur një përkeqësim i mëtejshme. Pretendim për akumulim interesi ose pa akumulim interesi, vijon sipas vendimit të Bankës.

Vlerësimi i brendshëm i dyshimtë/i humbur

I referohet shoqërive që manifestojnë i) vonesë mbi 90 ditë e gjykuar si e përhershme me veprime gjyqësore të gjykuara të nevojshme dhe ii) shoqëri që edhe nëse nuk kanë shlyer ende detyrimet e tyre të borxhit, konsiderohet e sigurt se do ta bëjnë këtë në të ardhmen e afërt. , ndërkohë që likuidimi i çdo ekspozimi pritet nëpërmjet veprimeve juridike duke likuiduar të gjitha llojet e kolateralit/sigurisë që Banka ka në zotërim të saj duke përfshirë edhe falimentimin e huamarrësit.

Probabilitet i lartë i rikuperimit të pjesshëm të dëmit për shkak të mos ekzistencës së burimeve të pranueshme të shlyerjes ose mbulimit të pjesshëm nga kolaterali/siguria ekzistuese, ose humbje totale e tij. Pretendim pa akumulim interesi.

b) Letrat me vlerë të borxhit dhe bonot e tjera

Për letrat me vlerë të borxhit dhe bonot e tjera, departamenti i riskut për administrimin e ekspozimeve ndaj rrezikut të kredisë përdor klasifikime në varësi të emetuesit. Investimet në obligacionet e qeverisë shqiptare dhe bonot e thesarit shihen si një mënyrë për të përfituar një mapim më të mirë të cilësisë së kredisë dhe për të mbajtur një burim lehtësisht të disponueshëm për të përmbushur kërkesat e financimit në të njëjtën kohë.

9.1.2. Kontrolli i kufirit të rrezikut dhe politikat e zbatjes

Banka menaxhon, kufizon dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë kudo që ato identifikohen - në veçanti, ndaj palëve dhe grupeve individuale, si dhe

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.2. Kontrolli i kufirit të rrezikut dhe politikat e zbutjes (vazhdim)

industrive dhe vendeve. Banka strukturon nivelet e rrezikut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e rrezikut të pranuar në lidhje me një huamarrës ose grup huamarrësish dhe segmente të industrisë. Rreziqe të tilla monitorohen në baza rrotulluese dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor ose më të shpeshtë, kur konsiderohet e nevojshme. Kufijtë në nivelin e rrezikut të kredisë sipas sektorit të produktit dhe industrisë miratohen nga Bordi i Drejtorëve. Për përqendrimin sipas industrisë është shpalosur në Shënimin 20.

Më 31 Dhjetor 2024, 20 grupet kryesore të klientëve të Bankës kanë një ekspozim prej 27,559 milionë lekë (2023: 21,579 milionë lekë) që përfaqëson 35% të portofolit bruto (2023: 37%), me ekspozimin më të madh të vetëm që përfaqësojnë 3.8% (2023: 4.5%).

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet gjithashtu nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë së huamarrësve dhe huamarrësve potencialë për të përmbushur detyrimet e interesit dhe ripagimit të kapitalit dhe duke ndryshuar këto kufij kreditimi aty ku është e përshtatshme. Disa masa të tjera specifike të kontrollit dhe zbutjes janë përshkruar më poshtë.

I. Kolateral

Banka përdor një sërë politikash dhe praktikash për të zbutur rrezikun e kredisë. Më tradicionalja prej tyre është marrja e garancisë për paradhëniet e fondeve, që është praktikë e zakonshme. Banka zbaton udhëzime

mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateralit ose zbutjen e rrezikut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për huatë dhe paradhëniet janë:

- Paratë, garancitë e klasit të parë bankar dhe të shoqërive;
- Hipotekat mbi pronat e banimit.
- Ngarkesat mbi asetet e biznesit si objektet, inventari dhe llogaritë e arkëtueshme; dhe
- Ngarkesat mbi instrumentet financiare si letrat me vlerë të borxhit dhe aksionet.

Kreditë për subjektet korporative dhe individët janë përgjithësisht të siguruara; mbi draftet dhe kartat e kreditit të lëshuara për individë sigurohen kryesisht nga depozitat në para dhe kolaterali në rastet e klientëve të kredisë me shumën e plotë të principalit, interesit dhe tarifave të tjera. Gjithashtu, për të minimizuar humbjen e kredisë, Banka do të kërkojë kolateral shtesë nga pala, sapo të vërehen tregues të zhvlerësimit për kreditë dhe paradhëniet individuale përkatëse. Referojuni shënimit 9.1.6.

Letrat me vlerë të borxhit, thesari dhe bonot e tjera të pranueshme janë përgjithësisht të pasiguruara.

II. Kontigjencat e lidhura me kredinë

Qëllimi kryesor i këtyre instrumenteve është të sigurojë që fondet të jenë në dispozicion të një klienti sipas nevojës. Garancitë dhe letrat e kredisë në pritje mbartin të njëjtin rrezik kredie si huatë dhe janë të siguruara me të njëjtin kolateral si kreditë. Letrat e kreditit dokumentare dhe komerciale – të cilat janë detyrime të shkruara nga Banka në emër të një klienti që autorizon një palë të tretë për të tërhequr draftet në Bankë deri në një shumë të caktuar sipas kushteve dhe kushteve specifike – janë kolateralizuar nga dërgesat

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.2. Matja e rrezikut të kredisë (vazhdim)

II. Kontigjencat e lidhura me kredinë (vazhdim)

themelore të mallrave në të cilat ato lidhen dhe për këtë arsye mbartin më pak rrezik sesa një kredi direkte. Angazhimet për dhënien e kredisë përfaqësojnë pjesë të papërdorura të autorizimeve për të dhënë kredi në formën e huave, garancive ose letrave të kredisë. Në lidhje me rrezikun e kredisë për angazhimet për dhënien e kredisë, Banka është potencialisht e ekspozuar ndaj humbjeve në një shumë të barabartë me totalin e angazhimeve të papërdorura.

Megjithatë, shumica e mundshme e humbjes është më e vogël se totali i angazhimeve të papërdorura, pasi shumica e angazhimeve për të dhënë kredi janë të kushtëzuara nga klientët që mbajnë standarde specifike kredie. Banka monitoron afatin deri në maturim të zotimeve të kredisë, sepse angazhimet afatgjata përgjithësisht kanë një shkallë më të madhe rreziku kredie sesa angazhimet afatshkurtra. Referojuni shënimit 9.1.5 dhe shënimit 37.

9.1.3. Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit

Banka duhet të njohë një rezervë për humbjet e pritshme të kredisë për një aktiv financiar, një kontratë qiraje, një aktiv të kontratës ose një angazhim kredie ose një kontratë të garancisë financiare për të cilën aplikohen kërkesat për zhvlerësim.

Aktivitetet financiare që i nënshtrohen përlllogaritjes së zhvlerësimit janë këto:

- aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (Shënimi 22)
- aktivet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 21)
- arkëtimet nga qiraja (Shënimi 22)
- angazhimet e huasë për të dhënë një kredi me një kontratë të garancisë financiare nën normën e interesit të tregut. (Shënimi 37)

Bankës i kërkohet të masë humbjet e pritshme të kredisë së një instrumenti financiar në një mënyrë që pasqyron:

- një rezultat të pavarur, matur duke përdorur një mesatare të ponderuar të rezultateve të ngjarjeve me probabilitete të ndryshme;
- vlerën në kohë të parasë; dhe
- informacion të arsyeshëm dhe të argumentuar që banka disponon pa kosto ose përpjekje të shtuara në datën e raportimit për ngjarje e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

Humbjet e pritshme të kredisë janë një vlerësim i ponderuar me probabilitetin e humbjeve të kredisë (d.m.th. vlera aktuale e të gjitha mungesave në mjete monetare) gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Një mungesë mjete monetare është diference midis fluksit të mjeteve monetare që janë detyrim ndaj Bankës në përputhje me kontratën dhe fluksit monetare që Banka pret të marrë. Për shkak se humbjet e pritura të kredisë marrin në konsideratë shumën dhe kohën e pagesave, një humbje kredie lind edhe nëse Banka pret që të paguhet plotësisht, por më vonë sesa data e përcaktuar në kontratë.

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.3. Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)

9.1.3.1. Rritje e konsiderueshme në rrezikun kreditor

Në çdo datë raportimi, Banka do të vlerësojë nëse rreziku i kredisë në një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Kur bën vlerësimin, Banka përdor ndryshimin në rrezikun e mospagimi që ndodh gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, në vend të ndryshimit në shumën e humbjeve të pritshme të kredisë. Për të bërë këtë vlerësim, duhet të bëhet një krahasim i rrezikut të një mospagimi që ndodh në instrumentin financiar në datën e raportimit me rrezikun e një mospagimi që ndodh në instrumentin financiar në datën e njohjes fillestare me informacion të arsyeshëm dhe mbështetës, që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të shtuara, që është tregues i rritjeve të konsiderueshme të rrezikut të kredisë pasi njohja fillestare duhet të merret në konsideratë.

Rreziku i kredisë në një instrument financiar konsiderohet i ulët, nëse instrumenti financiar ka një rrezik të ulët të dështimit, huamarrësi ka një kapacitet të fortë për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale të fluksit monetar në afatin e afërt dhe ndryshimet e pafavorshme në kushtet ekonomike dhe të biznesit në një afat më të gjatë mund, por jo domosdoshmërisht, të zvogëlojnë aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij kontraktuale të fluksit të mjeteve monetare. Instrumentet financiare nuk konsiderohen se kanë një rrezik të ulët kredie kur vlerësohen se kanë një rrezik të ulët humbjeje thjesht për shkak të vlerës së kolateralit dhe instrumentit financiar pa atë kolateral

nuk do të konsiderohej rrezik i ulët krediti. Instrumentet financiare gjithashtu nuk konsiderohet se kanë një rrezik të ulët kredie thjesht sepse ato kanë një rrezik më të ulët të dështimit sesa instrumentet e tjerë financiarë të Bankës ose në lidhje me rrezikun e kredisë të juridiksionit brenda të cilit Banka operon.

Nëse informacioni largpamës, i arsyeshëm dhe i faktuar është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të shtuara, Banka nuk mund të mbështetet vetëm në informacionet e kaluara për të përcaktuar nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare. Megjithatë, kur informacion më largpamës se sa statusi “në vonesë” (qoftë në baza individuale ose kolektive) nuk është i disponueshëm pa kosto ose përpjekje të shtuara, Banka mund të përdorë informacionet mbi ngjarje të ndodhura për të përcaktuar nëse ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor që nga njohja fillestare. Pavarësisht nga mënyra se si Banka vlerëson rritjen e ndjeshme të rrezikut kreditor, ekziston supozimi i arsyeshëm që rreziku kreditor për një aktiv financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare kur pagesat kontraktuale janë me shumë se 30 ditë në vonesë. Banka mund të kundërshtojë këtë supozim në qoftë se ka informacione të arsyeshme dhe të faktuara në dispozicion pa kosto ose përpjekje të shtuara, që tregojnë se rreziku kreditor nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare edhe pse pagesat kontraktuale janë më shumë se 30 ditë në vonesë. Kur ajo përcakton se ka pasur rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor para se pagesat kontraktuale të jenë mbi 30 ditë në vonesë, ky supozim nuk aplikohet.

9.1.3.2. Koha e matjes së Humbjeve të Pritshme të Kredisë

Në çdo datë raportimi, Banka mat fondin rezervë për

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.3. Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)

9.1.3.2. Koha e matjes së Humbjeve të Pritshme të Kredisë (vazhdim)

humbjet për një instrument financiar në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme të kredisë përgjatë jetës së instrumentit nëse rreziku kreditor për atë instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Në rast se në datën e raportimit, rreziku kreditor për një instrument financiar nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, duhet të matet fondi rezervë për humbjet e pritshme nga kredia për një periudhë 12 mujore.

9.1.3.3. Çështje lidhur me llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë

9.1.3.3.1. Çregjistrimi

Para se të vlerësojë nëse dhe në çfarë mase është i përshtatshëm çregjistrimi, Banka përcakton nëse çregjistrimi duhet të aplikohet për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi të aktiveve të ngjashme financiare) ose një aktivi financiar (ose një grupi të ngjashëm të aktiveve financiare) në tërësi, si më poshtë:

a. Çregjistrimi aplikohet për një pjesë të një aktivi financiar (ose një pjesë të një grupi të aktiveve të ngjashme financiare) nëse dhe vetëm nëse pjesa që konsiderohet për çregjistrim plotëson një nga tre kushtet e mëposhtme.

- Pjesa përfshin vetëm flukset monetare të

identifikuara posaçërisht nga një aktivi financiar (ose një grup i aktiveve të ngjashme financiare).

- Pjesa përfshin vetëm një pjesë proporcionale të fluksit monetare nga një aktivi financiar (ose një grup i aktiveve të ngjashme financiare).
- Pjesa përfshin vetëm një pjesë proporcionale të flukseve monetare të identifikuara posaçërisht nga një aktivi financiar (ose një grup i aktiveve të ngjashme financiare).

b. Në të gjitha rastet e tjera, çregjistrimi zbatohet për aktivin financiar në tërësinë e tij (ose për grupin e aktiveve të ngjashme financiare në tërësinë e tij).

Banka çregjistron një aktivi financiar kur, dhe vetëm kur:

- përfundon afati i të drejtave kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar, ose
- transferon aktivin financiar dhe transferimi kualifikohet për çregjistrim.
- Në çregjistrimin e një aktivi financiar në tërësi, diferenca midis:
- vlerës kontabël (e matur në datën e çregjistrimit) dhe
- shumës së marrë (përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus çdo detyrim të ri të marrë) do të njihet në fitim ose humbje.

Nëse aktivi i transferuar është pjesë e një aktivi financiar më të madh dhe pjesa e transferuar kualifikohet për çregjistrim në tërësinë e tij, vlera kontabël e mëparshme e aktivit më të madh financiar ndahet midis pjesës që vazhdon të njihet dhe pjesës që nuk njihet mbi bazën e vlerave relative të drejta të pjesëve në datën e transferimit. Për këtë qëllim, një aktivi shërbimi i pashpërndarë do të trajtohet si një pjesë që vazhdon të njihet. Diferenca midis:

- vlerës kontabël (e matur në datën e çregjistrimit)

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.3. Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)

9.1.3.3. Çështje lidhur me llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë (vazhdim)

9.1.3.3.1. Çregjistrimi (vazhdim)

- të shpërndarë në pjesën e çregjistruar dhe
- shumës së marrë për pjesën e çregjistruar (duke përfshirë çdo aktiv të ri të marrë minus detyrime të reja të supozuara) do të njihet në fitim ose humbje.

9.1.3.3.2. Instrumente të blerë ose në origjinë të zhvlerësuar të kredisë (POCI)

Për instrumentet e blerë ose të origjinuar nga zhvlerësimi i kredisë, humbjet e pritshme të kredisë do të skontohen duke përdorur normën efektive të interesit të rregulluar, të përcaktuar në momentin e njohjes fillestare.

Në datën e raportimit, Banka do të njohë vetëm ndryshimet kumulative nga humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë që në momentin e njohjes fillestare, si humbje e lejuar nga instrumentet e blerë ose të origjinuara nga zhvlerësimi i kredisë.

Në çdo datë raportimi, Banka do të njohë në fitim ose humbje shumën e ndryshimit në humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë si një fitim ose humbje nga zhvlerësimi. Banka njeh ndryshimet e favorshme në humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë si fitim nga zhvlerësimi, edhe nëse humbjet e pritshme gjatë jetës janë më të vogla se shumata e humbjeve të pritshme të kredisë që janë përfshirë në vlerësimin fillestar të flukseve të pritshme.

9.1.3.3.3. Aktive financiare të zhvlerësuar të kredisë

Një aktiv financiar është i kredituar-zhvlerësuar kur kanë ndodhur një ose më shumë ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset e ardhshme monetare të këtij aktivi financiar. Dëshmia që një aktiv financiar është zhvlerësuar, përfshijnë të dhëna të vëzhguara në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- vështirësi të konsiderueshme financiare e emetuesit ose huamarrësit;
- një shkelje e kontratës, siç është një rast mospagimi ose vonesë në shlyerjen e detyrimit;
- huadhënësi (i) i huamarrësit, për arsye ekonomike ose kontraktuale që kanë të bëjnë me vështirësinë financiare të huamarrësit, i kanë dhënë më pas huamarrësit një lehtësi pagesë (a) që huadhënësi (ët) nuk do ta jepte në kushte të tjera;
- është e mundshme që huamarrësi të hyjë në falimentim ose në një riorganizim tjetër financiar;
- zhdukjen e një tregu aktiv për atë aktiv financiar për shkak të vështirësive financiare; ose
- blerjen ose emetimin e një aktivi financiar me një skonto të madhe që pasqyron humbjet e ndodhura të kredisë.

Mund të mos jetë e mundur të identifikohet një ngjarje e vetme diskrete – përkundrazi, efekti i kombinuar i disa ngjarjeve mund të shkaktojë zhvlerësim-krediti të një aktivi financiar.

9.1.3.3.4. Kolektive përkundrejt individuale

Për të përmbushur objektivin e vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë gjatë gjithë jetëgjatësisë së aktivitetit financiar për rastet me rritje të ndjeshme të rrezikut kreditor nga njohja fillestare, mund të jetë e nevojshme realizimi i vlerësimit mbi baza kolektive,

9. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (vazhdim)

9.1. RREZIKU I KREDISË (vazhdim)

9.1.3. Politikat e zhvlerësimit dhe provigjonimit (vazhdim)

9.1.3.3. Çështje lidhur me llogaritjen e Humbjeve të Pritshme të Kredisë (vazhdim)

9.1.3.3.4. Kolektive përkundrejt individuale (vazhdim)

duke konsideruar informacionin që sinjalizojnë rritje të rrezikut kreditor, për shembull, mbi një grup ose nën-grup instrumentesh financiare. Kjo është për të siguruar që Banka të përmbushë objektivin e vlerësimit të humbjeve të pritshme të kredisë gjatë jetës së aktivitetit, kur ka rritje të ndjeshme në rrezikun kreditor, edhe nëse nuk ka ende sinjale në nivele individuale instrumenti për rritje të tillë të rrezikut kreditor.

